

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 91-të i botimit
Gusht 2023 / Nr.5

FA-të, MISIONI NË MBROJTJE TË JETËS



DREJTOR I QKMBMMFA

ARBEN SKËNDERAJ

Shefe e Sektorit të Botimeve & Kryeredaktore

ANJEZA MUSOLLARI

GAZETARË:

MIMOZA GOLIKJA

GRAPHIC DESIGNER

AFËRDITA HYSAJ

REDAKTORE / KORREKTORE

SUELA HODA

BASHKËPUNËTORË

KOLONËL HYSNI GJERGJI

N/KOL (R) MSC. KANAN HIMAJ

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të përdoren për qëllime përfitimë, pa marrë autorizim nga botuesit e saj.

Botues:

*Qendra e Kulturës, Medias, Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes*

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikimet/revista-mbrojtja>

**Mbrojtja**

- Ministri Peleshi: Përulëm para sakrificës së çdo ushtaraku 4
- Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi pret ministren e Jashtme të Kanadasë, Mélanie Joly 8
- Peleshi: Krenari dhe privilegj, FA-të janë vlerësuar në mënyrën më dinjitoze! 9
- Gjeneralmajor Arben Kingji priti kryekapterin Mark Morgan, përfaqësuesin më të lartë të nënoficerëve nga Komanda Amerikane për Evropën dhe Afrikën (USAREUR-AF) 10
- Zhvillohet ceremonia e përfundimit të Kursit të XIV bazë të Forcave Speciale 12
- Efektivët EOD, angazhim maksimal për sigurinë dhe stabilitetin në rajonin tonë 14
- Kontingjenti "KFOR-3" përfundon me sukses misionin në Pejë, Kosovë 17
- Anija "Butrinti" në detin Egje, në shërbim të Aleancës për shpëtimin e jetëve njerëzore 19
- Anija P-134 "Butrinti" zhvillon stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane "Frankfurt A1412" 20
- KM zhvilloi takimin mbi "Kërkesat buxhetore për Planin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2024-2026, Faza II" 21
- Specialistët EOD të Komandës Mbështetëse asgjësojnë municione të paplasura në bashkinë Sarandë 22
- "Cougar" normalizon situatën në bashkinë e Selenicës 23
- Ekonomia, objektivi i fushë-betejës hibride të luftës 24
- Inteligjenca Artificiale për sistemet e sigurisë dhe mbrojtjes kibernetike 28
- Shtypi ushtarak në vitet e demokracisë 32
- Shërbimi i Transportit në FA, forca lëvizëse e gatishmërisë së lartë operacionale 36
- Kolonel dr. Elton Reso: Është momenti që shërbimi mjekësor të trajtohet si një emergjencë kombëtare 40
- Zbatimi i Agjendës së Sigurisë Klimatike të NATO-s, sfidat dhe rreziqet 46
- "Një ditë takova një fëmijë të verbër. Më kërkoi t'i përshkruaja detin, unë duke e parë ia përshkrova. Pastaj më kërkoi t'i përshkruaja botën, dhe unë duke qarë e gënjeva" 50
- "Një popull që ka harruar të kaluarën e tij është i dënuar të humbasë" 52
- "Të jesh grua në Shqipëri është punë burrash" 54
- Gruaja, liderja e së tashmes dhe së ardhmes 57
- "AbramsX", tanku i ri i ushtrisë amerikane, përbindësh vdekjeprurës 59
- Nga teknologjia e Hollivudit në mjetet ushtarake të së nesërme 60
- Ndikimi negativ i ndryshimit të klimës në modelet e reshjeve dhe në shëndetin tonë 62
- Ditët e Trashëgimisë Evropiane: "Trashëgimia e Gjallë" që feston traditat dhe aftësitë kulturore 64
- Metropoli hyjnor me emrin "Nënë Tereza" 66
- Lufta e Parë Botërore, shkaqet dhe pasojat e makthit që tronditi shekullin 70
- Karta e Atlantikut, principi i platformës së rendit të ri botëror 73
- "Little Boy", hija e tmerrit të Luftës së Dytë Botërore 75
- Nënkolonele Drita Prifti Karoli, zysha emblemë e urtësisë dhe mençurisë 76
- Nevruz (Turku) Sako, komisar i Shkollës së Bashkuar, rrëfen... 78
- Armë shqiptare të shek. XVII-XVII 82
- Armët shqiptare, qëllim, art, identitet 84
- 7 pasuritë e Trashëgimisë Botërore 87
- Arti shqiptar, thesari i vlerë i brigjeve joniane 90
- Vallja Çame flet vetëm shqip 94
- Jeta përtej dallgëve, udhëtimi bibliik i shqiptarëve 96
- Përfundimi i "aventurës shqiptare" 98

24

Ekonomia, objektivi i fushë-betejës hibride të luftës

Shkencëtarët politikë Anastasia Nesvetailova dhe Ronen Palan kanë treguar se lufta dhe sabotimi ekonomik nuk është një anomali e sistemit...

32

Shtypi ushtarak në vitet e demokracisë

04

Ministri Peleshi: Përulem para sakrificës së çdo ushtaraku

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, në vazhdimësi të situatave të zjarreve dhe reshjeve në vend, deklaroi se: "Mekanizmi Kombëtar i Mbrojtjes Civile ka funksionuar këtë vit më mirë se çdo herë tjetër, ku deri më tani janë mundur të menaxhohen me shumë sukses 465 vatra zjarri. Kur them sukses, e kam fjalën që kemi arritur objektivin...

10

Gjeneralmajor Arben Kingji priti kryekapterin Mark Morgan, përfaqësuesin më të lartë të nënoficerëve nga Komanda Amerikane për Evropën dhe Afrikën (USAREUR-AF)



Shërbimi i Transportit në FA, forca lëvizëse e gatishmërisë së lartë operacionale

Transporti ushtarak është pjesë përbërëse e rëndësishme e shërbimit të mbështetjes logjistike, ku logjistika në vetvete përfshin lëvizjen, zinxhirët e furnizimit me sektorët përbërës të saj, si dhe mbështetjen e Forcave...

Faqe 36



Kolonel dr. Elton Reso: Është momenti që shërbimi mjekësor të trajtohet si një emergjencë kombëtare

Mjekësia është një shkencë humane me përmasa shumë të gjëra. Shërbimi Shëndetësor i Forcave të Armatosura plotëson detyrimet në mision të detyrave të mjekësisë ushtarake...

Faqe 40





Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, në vazhdimësi të situatave të zjarreve dhe reshjeve në vend, deklaroi se: “Mekanizmi Kombëtar i Mbrojtjes Civile ka funksionuar këtë vit më mirë se çdo herë tjetër, ku deri më tani janë mundur të menaxhohen me shumë sukses 465 vatra zjarri. Kur them sukses, e kam fjalën që kemi arritur objektivin primar të ruajtjes së jetës së njerëzve, pra nuk kemi asnjë jetë të humbur, madje as të rrezikuar. Nga ana tjetër kemi ruajtur gjithashtu pasurinë e qytetarëve tanë në qytet apo në fshat. Kemi ruajtur dhe kemi shmangur më të keqen në shumë zona pyjore. Përgjithësisht zonat e djegura nga këto zjarre kanë qenë kullota. Kemi shmangur zjarret në pemëtari, pra kemi ruajtur pasurinë e qytetarëve”, - theksoi ministri.

Ministri Peleshi u shpreh se: “Problematikat e shkaktuara nga zjarret në qarqet Fier, Vlorë dhe Dibër, duke filluar nga zonat e Frakullit





në Fier, ku filloi edhe sezoni i zjarreve, kemi pasur situatë të vështirë aty, që me vështirësi, por me shumë seriozitet, me angazhim dhe bashkëpunim u arrit të shmanget. Zjarr kritik ka qenë zjarri mbi Porto Palermo, pranë Qeparoit, gjithashtu pranë zonave të banuara, në një zonë turistike, në pikun e sezonit, u menaxhua në një kohë shumë të shpejtë”.

Më tej ministri u ndal edhe në zjarrin e Shpiragut, ku falë një bashkëpunimi të jashtëzakonshëm është arritur shuarja përfundimtare, duke ditur rëndësinë që ka Shpiragu për shkak dhe të kantierit aty afër.

“Kanë filluar dhe shenjat e para të trokitjes së sezonit të reshjeve. Ka pasur reshje në veri, mund të ketë situata



lokale dhe në orët në vijim ndonjë dalje nga shtrati e ndonjë përroi, ndonjë përmytje lokale, të cilat sado të vogla mund të shkaktojnë rreziqe deri në humbje jete nëse nuk tregohemi të kujdesshëm. U bëj thirrje qytetarëve të bashkëpunojnë për çdo situatë emergjente, bashkive, që janë përgjegjëset kryesore për të përballuar emergjencat. Prefektët kanë bërë punë të jashtëzakonshme. Do na duhet ta mbajmë tempin dhe kjo është arsyeja pse gjykova të dal në komunikim”, - u shpreh z. Peleshi. Referuar shirave, të cilat përfshinë vendin gjatë këtyre ditëve, ministri u bëri thirrje qytetarëve dhe bashkive që të qëndrojnë vigjilentë dhe të bashkëpunojnë për çdo situatë emergjente, përmytje apo rrëshqitje dherash.

Ministri shtoi se Forcat e Armatosura kanë qenë faktor kyç në çdo situatë apo moment kritik. “Dua t’i falënderoj, pasi janë në çdo situatë, në çdo moment kritik, duke sakrifikuar, duke rrezikuar. Kemi mundur të mbrojmë jetën e qytetarëve dhe të mbajmë ushtarakët të pa kërcënuar. Përulëm para sakrificës së çdo ushtaraku. Janë të pa zhurmshëm, por bëjnë punë të madhe”, - përfundoi ministri Peleshi.

U bëj thirrje qytetarëve të bashkëpunojnë për çdo situatë emergjente, bashkive, që janë përgjegjëset kryesore për të përballuar emergjencat. Prefektët kanë bërë punë të jashtëzakonshme. Do na duhet ta mbajmë tempin dhe kjo është arsyeja pse gjykova të dal në komunikim”, - u shpreh z. Peleshi.



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi pret ministren e Jashtme të Kanadasë, Mélanie Joly

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi priti në një takim zyrtar ministren e Jashtme kanadeze, znj. Mélanie Joly. Takimi ishte i një rëndësie të veçantë, pasi si dy vende anëtare të NATO-s, të dy ministrat diskutuan çështje të ndryshme të bashkëpunimit dhe rolin e kontributin e veçantë të Kanadasë në Ballkanin Perëndimor.

Ministri shprehu mirënjohjen e tij për gjithë mbështetjen që Kanadaja i ka dhënë dhe i jep Shqipërisë, por mbi të gjitha për mbështetjen e jashtëzakonshme që kontingjenti kanadez, i cili kryeson misionin e NATO-s “Enhanced Forward Presence”, i jep togës EOD shqiptare të dislokuar në Kamp Adazi të Letonisë.

Nga ana e saj, ministrja e Jashtme e Kanadasë, znj. Mélanie Joly, falënderoi për mikpritjen ministrin Peleshi dhe shprehu gatishmërinë për intensifikimin e këtij bashkëpunimi në kuadër të Aleancës.

Ministrja Joly u ndal në rëndësinë e mbështetjes së Ballkanit Perëndimor, sfidat e sigurisë me të cilat përballen sot e gjithë bota, si për nevojën për të shtuar mbështetjen ndaj vendeve demokratike që përballen ose mund të përballen me ndërhyrje apo fushatat e dizinformimit nga ana e Rusisë.

Ministrat rikonfirmuan vendosmërinë e tyre për të vijuar kontributin në sigurinë ndërkombëtare, duke përfshirë



mbështetjen e vazhdueshme për Ukrainën, si dhe forcimin e lidhjeve diplomatike dhe bashkëpunimit mes Shqipërisë dhe Kanadasë.





Peleshi: Krenari dhe privilegj, FA-të janë vlerësuar në mënyrën më dinjitoze!

Shqipëria merr drejtimin e Brigadës së Europës Juglindore (SEEBRIG).

Drejtimi i SEEBRIG ndodh për herë të dytë, si pjesë e procesit të Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore SEDM.

“Krenari dhe privilegj që Forcat tona të Armatosura janë vlerësuar në mënyrën më dinjitoze në arenën ndërkombëtare”, - do të shprehej Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi me rastin e marrjes së drejtimit të SEEBRIG nga Shqipëria, dhe nën komandën e gjeneral brigade Bilbil Bitrit, për një mandat trevjeçar, të dislokuar në Kumanovë të Maqedonisë së Veriut. “Suksese të përzemërta për gjeneral Bitrin, në këtë rrugëtim sfidues!

Shpresëplotë që ai do vazhdojë të bëjë krenar vendin tonë dhe të përfaqësojë me dinjitet Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, - do të mbyllte urimin e tij ministri Peleshi.



Gjeneralmajor Arben Kingji priti kryekapterin Mark Morgan, përfaqësuesin më të lartë të nënoficerëve nga Komanda Amerikane për Evropën dhe Afrikën (USAREUR-AF)

Një ndër prioritetet e Forcave të Armatosura të RSH është zhvillimi, promovimi dhe fuqizimi i nënoficerëve në të gjitha formacionet ushtarake, me fokus të veçantë tek nënoficerët e rinj (komandant grupi dhe skuadre).

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji, priti në një takim pune kryekapterin Mark Morgan, përfaqësuesin më të lartë të nënoficerëve nga Komanda Amerikane për Evropën dhe Afrikën (USAREUR-AF) dhe atasheun amerikan CDR Eric Cote.

Tema e diskutimit ishte mbi zhvillimin e Konferencës së Nënoficerëve të Ushtrive Evropiane, që pritet të mbahet në vitin 2024 në Shqipëri, në drejtimin e USAREUR-AF. Në këtë aktivitet të rëndësishëm do të diskutohen zhvillimet e reja në interes të trupës së nënoficerëve, në shkëmbimin e ideve, njohurive, eksperiencës, si dhe në ndërtimin e marrëdhënieve të forta mes vendeve pjesëmarrëse në këtë konferencë.

Gjeneralmajor Kingji shprehu mirënjohjen për

bashkëpunimin e ngushtë dhe të frytshëm me Komandën Amerikane për Evropën dhe Afrikën, si dhe vlerësoi profesionalizmin dhe performancën e secilit ekip instruktor e trajnues, përgjatë zhvillimit të stërvitjeve dhe trajnimeve të përbashkëta me qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë dhe gatishmërisë së forcave tona. Një ndër prioritetet e Forcave të Armatosura të RSH është zhvillimi, promovimi dhe fuqizimi i nënoficerëve në të gjitha formacionet ushtarake, me fokus të veçantë tek nënoficerët e rinj (komandant grupi dhe skuadre).

Që nga qershori i vitit 2022 është miratuar "Rregullorja e Nënoficerëve të FARSH", bazuar në dokumentet dhe udhëzimet e NATO-s dhe ushtrisë amerikane për zhvillimin e mëtejshëm të lidershipit dhe pozitave të kësaj trupe.



Zhvillohet analiza 6 - mujore e punës dhe aktiviteteve të Forcave të Armatosura të RSH

Në ambientet e Shtabit të Përgjithshëm, u zhvillua analiza 6 - mujore e punës dhe aktiviteteve të Shtabit të Përgjithshëm, forcave dhe njësive vartëse, nën drejtimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Arben Kingji dhe me pjesëmarrjen e zëvendës-shefit të SHPFA, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, komandantët e forcave, drejtorët e drejtorive në Shtabin e Përgjithshëm dhe komandantët e njësive autonome.

Analiza 6 - mujore u fokusua në diskutimin rreth arritjeve të deritanishme të orientuara nga vizioni i SHSHPFA për vitin 2022 - 2025 mbi: implementimin e ndryshimeve strukturore, hartimin dhe rishikimin e akteve ligjore/VKM për FARSH, menaxhimin e personelit, sigurinë, gatishmërinë, angazhimet në stërvitje dhe misione brenda dhe jashtë vendit, mbështetjen logjistike, përmirësimin e infrastrukturës stërvitore, planifikimin dhe monitorimin e mbrojtjes, mbështetjen shëndetësore, sigurinë kibernetike, si dhe angazhimet dhe prioritetet kryesore për në vijim.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji në fjalën e tij falënderoi çdo komandant njësie dhe drejtues për punën dhe përpjekjet e tyre për realizimin e detyrave gjatë këtij 6-mujori:



“Është momenti të bëjmë një vlerësim të realizimeve më kryesore të kësaj periudhe dhe të diskutojmë mbi detyrat dhe objektivat që i kam vlerësuar të domosdoshme

për përqendrimin e punës dhe aktivitetit të FARSH në vijim...”, - u shpreh shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Arben Kingji.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Arben Kingji vizitoi anijen TCG “Bayraktar” e ankoruar në portin e Durrësit, me ftesë të Ambasadorit të Republikës Turke Sh.T. z. Tayyar Kagan Atay dhe komandës drejtuese të anijes. Ekuipazhi i anijes përbëhet nga studentë të Akademisë Detare të cilët po zhvillojnë stazhin e tyre duke lundruar në vende të ndryshme, ku pjesë e së cilës është dhe një student shqiptar që së shpejti do t'i bashkohet FA-së.

Turqia është një nga bashkëpunëtorët kryesorë në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, duke i dhënë një mbështetje të rëndësishme Forcave të Armatosura në logjistikë, trajnim, stërvitje, edukim ushtarak, si dhe përgjatë emergjencave civile në Shqipëri.



Zhvillohet ceremonia e përfundimit të Kursit të XIV bazë të Forcave Speciale

Në mjediset e Regjimentit të Operacioneve Speciale u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të XIV bazë të Forcave Speciale. Në këtë aktivitet morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, drejtorë nga Shtabi i Përgjithshëm, komandantë të reparteve të vartësisë të FT, përfaqësues nga Operacionet Speciale të Forcës së Sigurisë të Kosovës, si dhe miq dhe familjarë të kursantëve specialë.

Ceremonia filloi me një demonstrim stërvitor të përgatitur nga kursantët, duke kryer veprime taktike si: luftim i afërt, goditje objekti, qitje ndaj objektivave të lëvizshme, qitje me precizion, qitje me pengesa, qitje me snajper etj.

Në fjalën e tij, komandanti i Regjimentit të Operacioneve Speciale nënkolonel Ajet Jata, theksoi ngarkesën e lartë stërvitore në këtë kurs, e cila ka patur si qëllim t'i përgatisë kursantët si operatorë të Forcave Speciale me të gjitha aftësitë taktike dhe psikologjike, si dhe përmirësimin e aftësive profesionale, drejtuese dhe luftarake për të qenë të suksesshëm në të gjithë spektrin e gjerë të operacioneve speciale.

Ceremonia vijoi me fjalimet e dy kursantëve më të mirë, shpërndarjen e certifikatave dhe vendosjen e beretës së kuqe nga kursantët e certifikuar.

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia në fjalën e tij përshëndetëse falënderoi gjithë personelin që mori pjesë në këtë kurs dhe theksoi rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit me Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kursi i XIV bazë i Forcave Speciale u zhvillua për një periudhë 6 - mujore me pjesëmarrjen e kursantëve nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë të Kosovës.



Operatorët e Regjimentit të Operacioneve Speciale përfunduan me sukses në stërvitjen e përbashkët me Forcat Speciale Amerikane "JCET-23", që u zhvillua në Maqedoninë e Veriut. Kjo stërvitje është shumë e rëndësishme për rritjen e nivelit të ndërveprueshmërisë, sinkronizimit të procedurave operacionale dhe zhvillimit të aftësive në realizimin e operacioneve speciale.



ROS, pjesë e stërvitjes "JCET-23"



Regjimenti i Operacioneve Speciale (ROS), i cili në përbërjen e vet ka dy formacionet më të rëndësishme të Forcave të Armatosura, me një histori të gjatë kontributesh dhe suksesi me efektivë të mirë trajnuar, të aftë për të realizuar çdo mision, zhvilluan stërvitjen për të vënë në praktikë njohuritë e tyre planëzuese dhe taktike për rritjen e mëtejshme të aftësive operacionale.



Efektivët EOD, angazhim maksimal për sigurinë dhe stabilitetin në rajonin tonë

Efektivët tanë, pjesë e misionit të NATO-s në Letoni, po tregojnë aftësi të jashtëzakonshme mbi procedurat EOD të demontimit të armëve shpërthyes. Dëshmi e qartë kjo, e përgatitjes dhe angazhimit të tyre të palodhur. Forcat e Armatosura bëjnë një punë të jashtëzakonshme për të mbrojtur dhe siguruar interesat e Aleancës së NATO-s. Efektivët tanë janë shembull frymëzues për të gjithë ne, duke na treguar se sa të rëndësishme janë përpjekjet e përbashkëta për të forcuar sigurinë dhe stabilitetin në rajonin tonë.



Trupat Komando përfunduan me sukses kursin “Lufta në qendrat e banuara”. Nën drejtimin e instruktorëve më të mirë, ata zhvilluan aftësitë taktike në këtë lloj luftimi, i cili konsiderohet si një ndër më të vështirët. Efektivët treguan nivel të lartë të përgatitjes profesionale, duke dëshmuar se jemi në nivelin e forcave homologe të vendeve anëtare të NATO-s. Ky është një tregues i aftësisë së trupave tona dhe gatishmërisë për t'u përballur me sfida më të vështira.





Një tjetër kontingjent i bashkohet misionit të KFOR-it, në Kosovë, duke e shtuar edhe më shumë kontributin e Shqipërisë në Aleancë.

Pjesëmarrja e Forcave të Armatosura në këtë mision të NATO-s, është një tregues i qartë i vendosmërisë së Shqipërisë për të ndihmuar dhe mbrojtur paqen në rajon.

Duke njohur rëndësinë e madhe të KFOR-it, për Kosovën dhe Ballkanin Perëndimor, Forcat tona të Armatosura janë gati të shërbejnë përkrah kolegëve të tyre ndërkombëtarë, duke konfirmuar rolin tonë si eksportues të paqes dhe sigurisë globale.





Në kuadrin e stërvitjes “Cambrian Patrol”, në Wells, Mbretëria e Bashkuar, ku FA-të u përfaqësuan nga ekipi i Forcës Tokësore, u realizua me sukses stërvitja 72-orëshe në rajonin e Mnelës dhe stërvitja “Kalim i pengesave ujore” në rajonin e Bovillës.

Gjatë trajnimit, efektivët e FT-së treguan devotshmëri dhe përkushtim të lartë në realizimin e objektivave të tyre.



Kontingjenti i dytë b3k me mision në Novo Selo, Bullgari, mori pjesë në stërvitjen e përbashkët shumëkombëshe “Platinum Lion - 23” me temë “Kompania e Mekanizuar në mbrojtje në Eskalionin e parë të batalionit”, e cila synonte përmirësimin e aftësive operacionale në kryerjen e veprimeve të përbashkëta luftarake në një mjedis shumëkombësh.

Shtetet pjesëmarrëse në këtë stërvitje ishin Shqipëria, Bullgaria dhe Republika e Maqedonisë së Veriut.

Toga shqiptare e batalionit të tretë të këmbësisë, tregoi profesionalizëm në të gjitha veprimet në fushëbetejë dhe një bashkëpunim të shkëlqyer me trupat e kombeve të tjera pjesëmarrëse.



Kontingjenti “KFOR-3” përfundon me sukses misionin në Pejë, Kosovë

Në ambientet e Forcës Tokësore u zhvillua ceremonia e pritjes së Kontingjentit “KFOR -3”, i cili përfundoi me sukses detyrën gjashtëmujore si pjesë e misionit të NATO-s, në Pejë, Kosovë. Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, shefi i Shtabit i Forcës Tokësore, kolonel Beqir Tafili, komandanti i Batalionit të Dytë të Këmbësisë, major Enerjol Harka, si dhe shefat e degëve të Forcës Tokësore.

Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, pasi i urroi mirëseardhjen në atdhe kontingjentit, ndër të tjera tha: “Ju shpalsët atje një vlerë të lartë të ushtarakut shqiptar. Por, po kaq e rëndësishme, në mos më e vyer, është përvoja e shtuar që ju sollët këtu, një përvojë unike, e cila do të shërbejë për të përgatitur e trajnuar ushtarakët e tjerë të kontingjenteve pasardhëse. Kam kënaqësinë, që në mënyrë të veçantë t’iu shpreh respektin dhe mirënjohjen time, familjarëve të misionarëve, për mbështetjen që iu dhanë bijve dhe familjarëve të tyre, duke ua bërë më të lehtë qëndrimin atje.”

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia e mbylli fjalën e tij me urimet më të ngrohta dhe më të sinqerta për pjesëtarët e kontingjentit dhe familjarët e tyre.

Kontingjenti “KFOR-3”, pjesë Kompanisë së Dytë të Batalionit të Dytë të Këmbësisë, pasi realizoi detyrën për një periudhë 6 - mujore në kuadër të misionit të NATO-s, i dorëzoi autoritetin Kompanisë së Tretë të Batalionit të Dytë të Këmbësisë.



Mbi 2700 vizita dhe konsulta mjekësore janë bërë nga personeli mjekësor i FT-së në qytetet: Tiranë, Shkodër dhe Berat, në kuadër të mbështetjes shëndetësore dhe ofrimit të ndihmës së parë mjekësore ndaj popullsisë civile, për përballimin e situatës së temperaturave të larta.



Komandanti i Forcës Detare priti në takim kortezie Atasheun Ushtarak të Turqisë

Në Komandën e Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, priti në një takim kortezie, Atasheun Ushtarak të Turqisë për Shqipërinë, kolonel Muhamet Kelami Kablay.

Kundëradmiral Agastra e falënderoi Atasheun për bashkëpunimin dhe mbështetjen e madhe që ka dhënë pala turke për Forcën Detare dhe në veçanti anijes tonë përfaqësuese në mision në detin Egje.

Atasheu turk falënderoi gjithashtu, për bashkëpunimin shumë të ngushtë dhe të suksesshëm ndërmjet dy Forcave, si dhe klimën e ngrohtë dhe miqësore që ka gjetur në Shqipëri, duke u shprehur se e njëjta frymë miqësore do të ndiqet dhe nga pasardhësi i tij.

Në përfundim të takimit, kundëradmiral Agastra, falënderoi atasheun për vizitën e tij në Komandën e Forcës Detare dhe i uroi suksese në detyrat e mëtejshme.





Anija “Butrinti”, pjesë e misionit “Sea Guardian” në detin Egje, ka realizuar sërish me sukses tre operacione SAR. 3 gomone me 37 emigrantë të paligjshëm janë shpëtuar nga rreziku, në tentativë për të kaluar në ujërat greke. Fatmirësisht të gjithë personat gëzojnë shëndet të mirë. Kalimi i paligjshëm në detin Egje është një sfidë e madhe, jo

vetëm për Aleancën e NATO-s, por edhe për vendet tranzit që duhet të përballojnë një fluks të vazhdueshëm të emigrantëve të paligjshëm.

Besimplotë, se vetëm përmes bashkëpunimit, mund të adresojmë këtë sfidë dhe të garantojmë jetën dhe sigurinë e të gjithë atyre që përfshihen në situata të tilla.

Anija “Butrinti” në detin Egje, në shërbim të Aleancës për shpëtimin e jetëve njerëzore

Anija P-134 “Butrinti”, pjesë e misionit “Sea Guardian” e grupit të anijeve të SNMG2 TU 01, mori pjesë në një operacion kërkim-shpëtimi (SAR), në bashkëpunim me Rojën Bregdetare të Turqisë dhe Rojën Bregdetare të Greqisë për një gomone me emigrantë, e cila ndodhej në vështirësi.

Operacioni SAR përfundoi me sukses, duke shpëtuar 30 emigrantë midis tyre gra dhe fëmijë.

Emigrantët u morën nga Roja Bregdetare turke në gjendje të mirë shëndetësore dhe vazhduan drejt portit të Çesmes, Turqi për procedurë të mëtejshme. Forca Detare vazhdon detyrën e saj në shërbim të Aleancës, duke kontribuar në shpëtimin e jetëve njerëzore.



Operacioni SAR finalizohet me sukses nga Roja Bregdetare

Pas marrjes së informacionit nga Qendra e Kërkim - Shpëtimit, anija e Rojës Bregdetare P-110 “Shqypnia” u nis për dhënie ndihme ndaj një mjeti tip peshkarexhë, e cila kishte pësuar defekt dhe po rrezikonte të mbytej për shkak të ujit që po merrte në brendësi. Njëkohësisht një gomone me dy persona në bord kanë shfaqur probleme shëndetësore gjatë lundrimit në det dhe kanë kërkuar ndihmë. Efektivët e anijeve të gatshme janë nisur në drejtim të koordinatave të mjeteve në rrezik dhe iu kanë ardhur menjëherë në ndihmë. Të dy operacionet u finalizuan me sukses nga anija e Rojës Bregdetare në bashkëpunim me Guardia di Finanza. Personat në gjendje të rënduar shëndetësore u transportuan të sigurt në Portin e Durrësit nën kujdesin e stafit të ambulancës së Spitalit Durrës për të ndjekur shërbimet e duhura mjekësore.



Anija P-134 “Butrinti” zhvillon stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane “Frankfurt A1412”

Anija P-134 “Butrinti” pjesë e misionit të NATO-s në detin Egje, zhvilloi një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane “Frankfurt A1412” në ujërat ndërkombëtare.

Gjatë stërvitjes në bordin e anijes P-134, zhvilloi një vizitë dhe komandanti i grupit detar të aktivitetit të NATO-s në detin Egje, kapiten i rangut I Mathesius. Gjatë vizitës u dhanë udhëzime në lidhje me ecurinë e misionit, fluksin e emigrantëve në zonën tonë të përgjegjësisë, taktikat e përdorimit të emigrantëve për kalimin e kufirit, si dhe monitorimin e rajonit dhe raportimin te anija flamurtare.

Në një periudhë të shkurtër kohore, për më pak se dy muaj pjesëmarrje në mision, anija Butrinti i ka ardhur në ndihmë 180 personave, të cilët ndodheshin në rrezik për jetën.



KM zhvilloi takimin mbi “Kërkesat buxhetore për Planin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2024-2026, Faza II”

Komanda Mbështetëse, si struktura përgjegjëse për programin “Mbështetja e Luftimit” organizoi një takim, ku morën pjesë komandantët e reparteve, shefat e financës së strukturave buxhetore si njësi shpenzuese të përfshira në këtë program. Qëllimi i këtij takimi është përpunimi i detyrave teknike të buxhetit brenda limiteve përfundimtare të miratuara. Komandanti i KM-së, gjeneral brigade Ferdinand Dima në fjalën e tij theksoi rëndësinë e takimit, ku veçoi se: “Sigurimi i kapaciteteve të nevojshme për mbështetjen me shërbime të trupave të luftimit, të trupave të mbështetjes së luftimit si dhe mbështetja në operacione humanitare dhe misione ndërkombëtare është thelbi i këtij programi dhe, për këtë, duhet një planifikim i detajuar dhe real i buxhetit, duke u mbështetur në legjislacionin në fuqi si dhe kushtet reale të Forcave tona të



Armatores.” Më tej takimi vazhdoi me analizimin e detyrave teknike mbështetur në produktet e këtij programi si: burimet

njerëzore, mallrat e shërbimet që kryejnë mbështetjen logjistike në FA, për fazën e dytë të PBA-së për vitet 2024-2026.

Specialistët EOD eliminuan rrezikun nga municionet e paplasura në bashkitë Dimal e Librazhd

Specialistët EOD të batalionit të xhenios realizuan dy operacione për eliminimin e municioneve të paplasura. Operacionet u kryen në bashkitë Dimal e Librazhd.

Në fshatin Allambres, Njësia Administrative Cukalat, bashkia Dimal, ekipi EOD bëri kontrollin mbitokësor dhe nëntokësor të një sipërfaqeje rreth 185 m². Kontrolli nëntokësor u bë me aparatën Ferex 4032. Në përfundim të kontrollit u zbulua dhe identifikua një municion i paplasur që ishte granatë dore mësymëse e paarmatosur me ndezës të unifikuar. Operacioni tjetër u krye në njësinë administrative Mirakë, bashkia Librazhd. Pas rikonicionit nga grupi EOD u konstatua një predhë morta-



je E-TH. Municionet e zbuluara u konsideruan të prekshëm dhe të lëvizshëm duke



bërë transportimin e sigurt të tyre. Të dy operacionet përfunduan me sukses.

Specialistët EOD të Komandës Mbështetëse asgjësojnë municione të paplasura në bashkinë Sarandë

Një ekip EOD nga Batalioni i Xhenios të Komandës Mbështetëse, ka realizuar asgjësimin e një municioni të paplasur në vendin e quajtur lugu i Dardhës, bashkia Sarandë.

Pas njoftimit të marrë nga organet e pushtetit vendor, grupi i specialistëve EOD ka mbërritur në vend dhe në masa të larta sigurie kanë kryer rikonicionin mbi gjendjen e municionit.

Pas rikonicionit, u konstatua një granatë dore Defensive Kundër Këmbësorisë. Municioni u konsiderua i paprekshëm dhe i palëvizshëm. Duke parë rrezikun e këtij municioni u bë asgjësimi i sigurt i tij në vend. Gjatë operacionit nuk ka pasur probleme. Operacioni u shoqërua nga Policia Ushtarake.



Batalioni i Xhenios ndërton katër ura në qarkun e Korçës dhe një urë në Finiq

Detashmenti i Urave i Batalionit të Xhenios në Komandën Mbështetëse ka realizuar ndërtimin e katër urave metalike tip "Bailey" në qarkun e Korçës, duke bërë që banorët e fshatrave Voskopojë, Voskop, Mborje dhe Melçan të lidheshin me fshatrat e tjerë të zonës. Me 10 forca dhe 6 mjete, ata ndërtuan në katër fshatrat 54 m urë, ku secila nga ato ka një peshëmbajtje deri 40 ton.

Ndërtimi i këtyre urave bëri të mundur lidhjen e lagjeve në fshatin Melçan. Në Voskopojë ura me gjatësi 18 m, mundësoi lidhjen e zonës së bujtinave me pjesën tjetër të fshatit. Në fshatin Mborje u lidhën dy fshatra, duke mundësuar dhe kalimin e mjeteve. Ura me gjatësi 15 m e ndërtuar në fshatin Voskop që në ditët e para të vënies në shfrytëzim mundësoi kalimin e banorëve të zonës me mjetet dhe bagëtitë e tyre për në kullotat dhe tokën bujqësore të zonës. Ura e ndërtuar në fshatin Karroq, bashkia



Finiq ka një gjatësi 24 m, seksion 2/1 dhe peshëmbajtje deri 24 ton. Për këtë urë u angazhuan 10 forca dhe 3 mjete. Kjo urë

shërben për lidhjen e fshatrave Karroq, Zminec, Grazhdan me doganën e Ripsit, duke mundësuar lëvizjen e 1500 banorëve.



Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit të Dytë EOD, niveli III. Në këtë ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Arben Dhuli.

Kursi i Dytë EOD, niveli III u zhvillua nga data 12 qershor 2023 deri më 28 korrik 2023 dhe përfundoi sot me certifikimin e 9 specialistëve EOD.

Objekti i kursit është aftësimi i operatorëve EOD në zhvillimin e procedurave të vënies në Siguresë, si dhe asgjësimi përfundimtar deri në 50 kg NEQ të municioneve eksplozive.

Zhvillimi i mbarëvajtja e këtij kursi u mbikëqyr nga kompania "Golden West"

Zhvillohet ceremonia e përfundimit të Kursit të Dytë EOD, niveli III



dhe përfaqësues të Forcës Ajrore USA.

Shefi i Shtabit të Komandës Mbështetëse, kolonel Dhuli pasi falënderoi palën amerikane për mbështetjen, përgëzoi kursantët për përfundimin me sukses të këtij kursi duke shtuar se: "Përfundimi i këtij kursi ju çon në një nivel të lartë të përgatitjes suaj profesionale gjë që ju krijon mundësinë e realizimit të operacioneve EOD në shkallë më të lartë vështirësie."

Në fund u shpërndanë certifikatat e përfundimit të kursit.

"Cougar" normalizon situatën në bashkinë e Selenicës

Pas një pune të gjatë të trupave të emergjencave civile në bashkëpunim me 30 efektivë të Repartit të Poshnjës, nën koordinimin e Agjencisë së Mbrojtjes Civile është bërë e mundur shuarja e zjarrit në fshatin Treblovë, në bashkinë Selenicë.

Për shkak të terrenit të vështirë dhe përhapjes së vatrave të zjarrit nga era e fortë, u desh ndërhyrja nga ajri e helikopterit "Cougar" për normalizimin deri në shuarjen përfundimtare të tij.



Ekonomia, objektivi i fushë-betejës hibride të luftës



KOLONEL HYSNI GJERGJI



Ekonomia e kundërshtarit nuk shikohet si objekt vetëm për shtetet rivale, por edhe për kompanitë rivale, madje edhe të të njëjtit komb.



hkencëtarët politikë Anastasia Nesvetailova dhe Ronen Palan kanë treguar se lufta dhe sabotimi ekonomik nuk është një anomali e sistemit, por pjesë e modelit të luftës së biznesit dhe të financave - dhe kështu ka qenë gjithmonë. Një shpërthim i fuqishëm u regjistrua para pak ditësh, në një depo në

një port të Turqisë në portin e Derinçes, në bregun verior të Gjirit të Izmirit. Ky shpërthim ka shkaktuar një dëm shumë të madh, pasi janë shkatërruar 8 milionë tonë drithë si dhe janë plagosur 12 persona. Sipas mediave turke, drithi i shkatërruar ishte magazinuar për të shmangur ndikimin e luftës në Ukrainë dhe pezullimin e marrëveshjes së eksportit të grurit nëpërmjet Detit të Zi. Shpërthimi me bombë në tubacionin e gazit që lidh Rusinë me Europën Perëndimore, nxiti spekulime publike se kush ishte fajtori. Ndërsa Moska akuzoi SHBA-në dhe Londrën, Ukraina e drejtoi gishtin nga Kremli. Megjithatë edhe pse kanë kaluar gati 6 muaj nga shpërthimi, autorët mbeten ende mister. Një vlerësim tregoi se kostoja e riparimit të tubacioneve fillon nga rreth 500 milionë dollarë. Gati 40 për qind e rrjetit energjetik të Ukrainës u dëmtua nga sulmet me raketa dhe dronë ruse gjatë dimrit të kaluar, gjë që shkaktoi errësirë në disa qytete dhe mos furnizim me ushqim dhe me ngrohje të shtëpive. Hedhja në erë e depove të drithit në Turqi apo e infrastrukturës së energjisë në Ukrainë janë format e reja të transformimit të fushë betejës, me objektiv ekonominë. Për të gjetur autorët e mundshëm, na ndihmon përgjigjja e pyetjes: Kush përfiton? Ekonomia e kundërshtarit nuk shikohet si objekt vetëm për shtetet rivale, por edhe për kompanitë rivale, madje edhe të të njëjtit komb. Teknologjia e prodhimit të një droni, avioni luftarak apo edhe një tanku është një objektiv i



kuptueshëm i luftës hibride, por ekspertët thonë se tashmë kjo luftë po vë në shënjestër jo vetëm ekonominë dhe industrinë e rëndë, por deri tek stilistët e famshëm apo prodhuesit e lojërave të fëmijëve, prodhuesit e objekteve të çelikut, kompanitë e ushqimit dhe pijeve, fushën e studimeve për energji të pastër dhe prodhuesit e turbinave me erë.

Lufta përmes sabotazhit dhe spiunazhit ekonomik nuk është një shpikje moderne, pasi qysh në mesin e shekullit të 19-të, Kompania Britanike e Indisë Lindore përdori taktika spiunazhi për të zhvilluar plantacionet e saj të çajit. Kompania dërgoi botanistin britanik Robert Fortune në Kinë me një mision për të vjedhur sekretet e hortikulturës dhe prodhimit të çajit, për të sjellë farat e bimëve të çajit në Indi dhe për të punësuar punëtorë për t'u kujdesur për to. Sot, çaji është sinonim i Mbretërisë së Bashkuar pjesërisht edhe falë spiunazhit të Fortune. Sot viktimë e spiunëve industrialë mund të jetë pothuajse çdo organizatë tregtare, e cila zotëron disa informacione që mund të jetë me interes të konkurrentëve të saj.

Lufta në domenin ekonomik nënkupton operacione hibride të ndërmarra nga një kompani kundrejt një kompanie tjetër, me qëllim fitimin e avantazhit konkurrues në tregjet vendase ose globale. Thënë më thjeshtë, është procesi i mbledhjes së informacionit mbi objektivat ekonomike

ose industrialë të një biznesi tjetër për qëllime përfitimi në para. "Vjedhja" e informacionit nga biznesi konkurrent është fenomen i zakonshëm. Mjafton një pajisje e vogël me vlerë rreth 50 euro, mund të çojë në humbjen e një sasie të madhe informacioni konfidencial, që dëmton rëndë fitimet dhe kredibilitetin e kompanisë së shënjestruar.

Në ditët e sotme, spiunazhi industrial, si të gjitha sferat e tjera të veprimtarisë njerëzore, po lulëzon. Përmirësimi i teknikave vjen nga teknologjia. Vjedhja dhe humbja e informacionit konfidencial ka qenë prej kohësh një problem serioz i biznesit. Kjo i detyron shumë korporata që të zhvillojnë më shumë mënyra të reja për të mbrojtur informacionin e tyre teknologjik. Në vitet 1960, kur prodhuesit francezë dhe britanikë të avionëve po punonin në fshehtësi për të zhvilluar aeroplanin e tyre supersonik, një rrjet spiunazhi sovjetik i udhëhequr nga një ekzekutiv i "Aeroflot" arriti të kontrabandonte mikrofilma të planeve të zhvillimit të "Concorde". Sovjetikët e përdorën këtë informacion për të ndërtuar avionin e tyre supersonik, TU-144, i cili ishte në mënyrë të dyshimtë i ngjashëm. Sigurimi i personelit të menaxhmentit nënkupton sigurimin e vlerës së informacionit të vetë kompanisë. Mbledhja e informacionit nga sektorët kyç të një kompanie është qëllimi i çdo spiunazhi industrial nuk duhet të neglizhohet. Mbrojtja më e mirë mbetet qëndrueshmëria e sistemit kompjuterik, që bazohet në kriptimin/fshehjen e komunikimeve, ruajtja e të

dhënave të ndjeshme, rritja e nivelit të sigurisë së brendshme dhe të jashtme, si dhe trajnimi i stafit.

Në marrjen e masave kundër Spiunazhit ekonomik, njohja e fenomenit e ndihmon biznesin ose kompaninë për të zhvilluar dhe vënë në veprim një politikë të sigurisë së brendshme, duke filluar me një rishikim të plotë të normave të sigurisë dhe vlerësim të nivelit aktual të masave të sigurisë. Mbikëqyrja teknike dhe kundërmasat duhet të jenë pjesë përbërëse e politikës së sigurisë së çdo kompanie industriale dhe më së shumti industria duhet të jetë pjesë e paketave të shërbimit, duke shmangur çdo kërcënim potencial për biznesin. Përpjekjet për vjedhjen e sekreteve tregtare nga kompanitë amerikane vazhdojnë me një ritëm të lartë dhe po vënë në shënjestër objektiva të reja, pavarësisht nga përpjekjet për të frenuar një spinuazh të tillë industrial. Vjedhja e sekreteve tregtare dëmton ekonominë pasi shkurajon investimet për punën kërkimore që janë kritike për rritjen ekonomike. Disa elementë të rinj janë përfshirë në këtë aktivitet dhe goditjet e tyre kanë vënë në shënjestër shumë biznese që nga ato të teknologjisë së lartë e deri tek ato të modës. Ekspertja e sigurisë për korporatën Mandient, Laura Galante thotë se një numër kompanish në rritje mendojnë se shkeljet e sigurisë po bëhen të pashmangshme.

Viti 2013 ishte një pikë kthese për kërcënimet kibernetike dhe industrinë e sigurisë kibernetike, sepse kaq shumë lloje të reja kompanish ishin të interesuara të kuptonin se nga do të vinte rreziku i ardhshëm. Ekspertja thekson se disa lojtarë të rinj kanë

goditur kompani perëndimore mediash dhe banka. Sulmet kibernetike ndaj objektivave ekonomikë mesa duket kanë si synim të çojnë përpara interesat politike të forcave në Kinë Rusi dhe Iran. Një ish-prokuror federal, që ka drejtuar shumë çështje kundër spiunazhit industrial dhe ekonomik, thekson se Kina po bën përpjekjet më të shumta për të vjedhur sekrete të kompanive. Por Peter Toren i firmës juridike “Weisbrod Matteis & Copley” thotë se shumë vende janë aktive në këtë drejtim. “Mendoj se të gjitha vendet e Evropës Perëndimore e bëjnë një gjë të tillë, ashtu si edhe Rusia dhe Izraeli”.

Ekspertët thonë se kompanitë mund të shpenzojnë miliona dollarë dhe vite të tëra pune për të krijuar një program më të mirë kompjuterik, një produkt më të lehtë ose më të fortë. Por nëse një kompani tjetër i vjedh këto studime, atëherë rrjedhimisht ajo është në gjendje të krijojë një produkt konkurrues, me një kosto shumë më të ulët dhe të fitojë kështu një avantazh në treg. Spiunazhi i korporatave, i cili përfshin mbikëqyrjen e fshehtë, vjedhjen e dokumenteve dhe hakerimin e kompjuterëve, është një kërcënim për të gjithë sektorët e ekonomisë. Këtu janë disa raste që përfshijnë individë të nxitur nga lakmia dhe hakmarrja, kompani konkurruese, madje edhe qeveri të huaja.

Në 1993, José Ignacio López de Arriortúa, dha dorëheqjen nga pozicioni i tij si ekzekutiv i “General Motors” dhe iu bashkua “Volkswagen”. “General Motors” e akuzoi atë se kishte marrë me vete dokumente konfidenciale dhe se kishte



vjedhur sekrete tregtare. Në vitin 1994, u ngrit një padi ligjore midis dy kompanive amerikane të programeve kompjuterike. “Cadence Design Systems” paditi “Avant”. Korporata u dërgua në gjykatë për vjedhjen e kodit sekret kompjuterik. Disa punonjës u dënuan me burg dhe në vitin 2002, Avant ra dakord të paguante “Cadence” 265 milionë dollarë amerikanë për të zgjidhur çështjen. Kompania japoneze e elektronikës “Hitachi Ltd”. pranoi se kishte spiunuar IBM në fillim të viteve 1980. FBI ngriti një task forcë, me një nga agjentët e saj të fshehtë, duke u paraqitur si informator për t’i siguruar “Hitachi-t” dhe kompanive të tjera japoneze “sekret tregtar” të pavlerë nga gjigandi amerikan i kompjuterëve. Ky operacion u ekspozua nga McAfee në vitin 2011. Hakerat nga Kina, hynë me sukses në kompjuterë dhe vodhën pronën intelektuale në një sulm të gjerë që synonte sektorin e energjisë. Gjigantët e naftës “Exxon”, “Shell” dhe BP mendohet se ishin mes viktimave. Kjo nuk ishte as hera e parë dhe as e fundit që hackerat kinezë do të dyshoheshin për spiunazh kibernetik kundër kompanive private apo organizatave politike.

Në 1997, Steven Davis, një inxhinier tek “Wright Industries”, një kompani që ishte punësuar për të ndihmuar grupin e produkteve të kujdesit personal “Gillette” të zhvillonte një sistem të ri rrualtjeje, i shiti sekretet tregtare “Warner-Lambert Co”, “Bic” si dhe “American Safety Razor Co”. Davis më vonë shpjegoi në seancën gjyqësore se e shiti informacionin si rezultat i grindjes me mbikëqyrësin e tij dhe frikës se mund të pushohej nga puna. Ekzekutivët e korporatës shumëkombëshe “Procter & Gamble” morën në dorë informacione rreth produkteve të kujdesit të flokëve të “Unilever”, pasi u paraqitën si analistë të tregut dhe i kaluan tek materialet e konkurrentëve të tyre. Për pasojë tre punonjës u pushuan nga puna. Të dy kompanitë i dhanë fund çështjes duke arritur një marrëveshje miqësore në 2001.

Në vitin 1997, Harold Worden, një ekspert në pension i “Kodak”, u dënua me një vit burg për vjedhjen e sekrereve tregtare nga ish-kompania e tij dhe dhënien e tyre tek 3M. Ndër informacionet e rrjedhura ishte dizajni i një makinerie shumëmilionëshe që përdorej në prodhimin e filmave. Avery Dennison, një prodhues amerikan i materialeve vetë-ngjitëse dhe furnizimeve të kancelarive të zyrës, u spiunua nga kompania tajvaneze “Four Pillars Enterprise”. Drejtori i “Four Pillars”, P. Y. Yang dhe vajza e tij Yang Hui-Chen u dënuan për vjedhje të sekrereve tregtare në vitin 1999. “Four Pillars” ishte kompania e parë e huaj e ndjekur penalisht në Shtetet e Bashkuara për spiunazh ekonomik.

Në vitin 1998, “Boeing-ut” iu dha një kontratë fitimprurëse për të ndërtuar mjete lëshimi satelitore për Forcat Ajrore të SHBA-së. Më pas doli në dritë se kompania kishte vjedhur mijëra dokumente teknike dhe komerciale nga rivali “Lockheed Martin”, të cilat i lejuan “Boeing-ut” të merrte kontratën me mashttrim. “Lockheed Martin” më vonë paditi për vjedhjen dhe në vitin 2006 “Boeing” arriti një marrëveshje financiare me qeverinë e SHBA-së. Në vitin 2007, Marwan Arbache, një ekzekutiv në “Michelin”, mbreti francez

i gomave u përpoq t’i shiste sekretet industriale kompanisë japoneze “Bridgestone”, por “Bridgestone” informoi konkurrentin e saj. Arbache po përballej me një dënim të mundshëm 10 vjet burg për ofrimin e informacionit për një kompani të huaj që mund të përdorej kundër interesave të vendit, por në fund u dënua me dy vjet me kusht për shkelje të besimit.

Në vitin 2009, zinxhiri i hoteleve “Hilton” dëshironte të zhvillonte një zinxhir të ri hotelesh të stilit të jetesës për t’u kujdesur për klientët e rinj. Për të sjellë në jetë idenë, ata rekrutuan Ross Klein dhe Amar Lalvani, ish-punonjës të “Starwood”, një konkurrent tashmë i vendosur mirë në këtë sektor. Por “Starwood” akuzoi Klein dhe Lalvanin se kishin marrë mijëra dokumente konfidenciale me vete, duke e lejuar “Hilton” të kopjonte konceptet e “Starwood”. Në vitin 2013, dy teknikë gjermanë që punonin për grupin P3, një nënkontraktor i BMW, u paraqitën si punëtorë mirëmbajtjeje për të spiunuar makinat elektrike që po zhvilloheshin nga “Autolib”, një degë e kompanisë franceze “Bolloré”. “Bolloré” më pas akuzoi BMW-në se po përpiqej të vidhte baterinë dhe teknologjinë e saj të vendndodhjes. Në fund, gjykatat vendosën se incidenti përbënte shkelje të besimit dhe jo vjedhje. Në vitin 2005, Li li Whuang po praktikonte për furnizuesin e automobilave “Valeo” kur policia gjeti të dhëna konfidenciale të kompanisë në kompjuterët e mbajtur në shtëpinë e saj. Informacioni kishte të bënte me konceptet e automobilave që nuk ishin ende të disponueshëm në treg.

Ajo u dënua me një vit burg në Francë për “shpërdorim të besimit”. Megjithatë, gjykata nuk e la në fuqi akuzën e spiunazhit industrial. Në vitin 2017, shtetasi kinez Xiang Haitao u përpoq të vidhte algoritmin pas një programi softuerësh për produktivitetin bujqësor të krijuar nga punëdhënësi i tij, “The Climate Corporation”, një degë e “Monsanto”. Ai u arrestua teksa do të fluturonte për në Kinë me një kopje të algoritmit në bagazhin e tij. Xiang u dënua më vonë me 29 muaj burg dhe u gjykoj me 150 000 dollarë amerikanë për spiunazh ekonomik. Një mosmarrëveshje e ashpër midis dy kompanive më të mëdha të softuerëve në botë shpërtheu në vitin 2000, kur u zbulua se “Oracle” kishte punësuar detektivë për të spiunuar “Microsoft-in” dhe për të përgjuar nëpër materialet e tij. Qëllimi ishte zbulimi i detajeve të lidhjeve financiare midis “Microsoft” dhe partnerëve të tij dhe përdorimi i informacionit për të ndërtuar një çështje antitrust kundër “Microsoft”. “Oracle” mbrojti veprimet e saj si një “detyrë qytetare”. Në vitin 2006, punonjësja e “Coca-Cola”, Joya Williams u shiste dokumente konfidenciale dhe një mostër të një produkti të ri sekret “Pepsit”, konkurrenti kryesor i punëdhënësit të saj. Williams, i cili ishte drejtuesi i komplotit, u dënua me tetë vjet burg. Lufta për paranë vazhdon sipas thënies izraelite: “Kush nuk blihet me para, blihet me shumë para”, duke pranuar se çdo gjë është mall dhe ka një çmim në kapitalizëm, dhe nëse ju jepet diçka falas, atëherë malli jeni vetë ju.



INTELIGJENCA ARTIFICIALE PËR SISTEMET E SIGURISË DHE MBROJTJES KIBERNETIKE



N/KOL (R) MSC. KANAN HIMAJ

Sistemet e sigurisë kibernetike në përgjithësi kanë fenomene të mbrojtjes pasive dhe paralajmërimeve të hershme. Duke synuar të njohim problemet e mësipërme, kjo çështje e re për ne vendos në dukje konceptin e paralajmërimit në kohë reale dhe planifikon një strategji mbrojtjeje të AI-së për sistem sigurie dhe mbrojtjes

kibernetike të ndihmuar nga një ontologji e sigurisë. Për të kuptuar atë çka është pjesa e rëndësishme shpjegojmë se: ontologji në sistemet e informacionit është një strukturë e përbërë nga një grup konceptesh dhe kategorish, që lidhen me një fushë të caktuar të njohurive si dhe informacioneve. Në kontekstin e sigurisë së informacionit, mund të flasim për kiberontologji (ka në

bazë fjalën “kibernetike”, shkencë mbi komunikimin mes qenieve të gjalla dhe makinave) ose ontologji të sigurisë kibernetike. Ato nënkuptojnë gjithashtu një strukturë të dhënash, bazat e njohurive mund të mbajnë fakte të pa strukturuara. Nga ana tjetër, një taksonomi (praktika dhe shkenca e klasifikimi) është klasifikimi i objekteve dhe rregullimi i tyre në një hierarki, ndërsa ontologjia përshkruan vetitë dhe marrëdhëniet e tyre.

Së pari, ne parashikojmë një ontologji të mbrojtjes së sigurisë që integron ndërtimet sipas grafikëve të sulmeve, qëllimet e përgjithshme dhe bazat e njohurive specifike për fushën, dhe mbi këtë bazë zhvillojmë një metodë të drejtuar nga ontologjia të paralajmërimeve të hershme të sulmeve në kohë reale që mbështet zbulimin me skanim ndërhyrës, kombinon planifikimin e inteligjencës artificiale dhe racionalitetin e kufizuar për të rekomanduar strategjitë e mbrojtjes në skenarët e mbrojtjes konvencionale. Eksperiencia dhe përvoja nuk mungon, shumë prej vendeve partnerë kanë kryer studime dhe rezultatet tregojnë se metoda e propozuar mund të analizojë shpejt të dhënat e trafikut të rrjetit për paralajmërime në kohë reale të sulmeve. Metoda e propozuar është shumë e realizueshme dhe ka aftësinë për të zbatuar strategjitë e mbrojtjes në mënyrë autonome dhe performon më së miri, me një rritje të efektivitetit të mbrojtjes. Në përgjithësi, kjo metodë ka potencialin për të rritur efektivitetin e mbrojtjes kundër sulmeve kibernetike nën kufizime të larta të burimeve kompjuterike.

Sulmet në hapësirën kibernetike përbëjnë një kërcënim serioz për shkak të pragut të tyre të ulët dhe kohën e rastësishme dhe të shkurtër të sulmit.

Paralajmërimet e hershme dhe të shpejta, zbatimi i strategjive të synuara të mbrojtjes janë çelësi për minimizimin e humbjeve. Sistemi i sigurisë kibernetike zakonisht ndërtohet në mënyrë sinkrone me sistemin e informacionit, dhe është sfiduese për ta përshtatur atë me zhvillimin e shpejtë të metodave të sulmeve.

Modeli i mbrojtjes së sigurisë ka kufizime të dukshme me mbrojtjen pasive të hershëm paralajmërimet për rreziqet. Prandaj, në kushtet e kufizuara të kohës, njohjes dhe informacionit të kibernetikës për skenarët e sigurisë, efektiviteti i mbrojtjes së sigurisë është i vështirë të garantohet.

Krijimi i njohurive të sigurisë dhe mbrojtjes, për ne mbetet shumë e rëndësishme njohja e sistemeve të inteligjencës së kërcënimeve, e cila bëhet bazë për zbatimin e mbrojtjes aktive. Teknologjia aktuale e sigurisë është futur në epokën tonë të inteligjencës dhe arsyetimi i strategjisë së sigurisë kërkon themelimin e shprehjeve të njohurive të formatizuara dhe të standardizuara. Kështu, integrimi i njohurive është thelbësor dhe i përshtatshëm për skenarë specifikë të sigurisë. Midis tyre, duhet më shumë informacion rreth njohurive, të tilla si ato të përgjithshme dhe të përfshirë në dukuritë e sigurisë, të cilat të shërbejnë për t'u përdorur sistemi i njohurive të sigurisë. Prandaj, një teori e fortë themeli për mbrojtjen kibernetike mund të arrihet me përkufizime të sakta të attributeve të sigurisë dhe marrëdhëniet e tyre në sistemin e sigurisë. Këto teori duhet të përpunohen dhe të zhvillohen gjerësisht edhe në sistemin arsimor publik dhe privat, në mënyrë të veçantë në Akademinë e Forcave të Armatosura, ato mund të jenë dhe tema të mirëfillta studimore me theks



sigurinë dhe mbrojtjen e vendit.

Paralajmërimet e hershme të sigurisë janë premisa për mbrojtjen aktive të sigurisë kibernetike dhe themeli për zbatimin e programeve të sigurisë, të cilat synojnë të zbulojnë sulmet kibernetike më herët që të jetë e mundur dhe të japin alarme të hershme përpara se asetet të pësojnë dëme të konsiderueshme. Duke kryer zbulimin në fazën e fillimit të sulmit është çelësi për siguri të optimizuar në strategjitë e mbrojtjes. Dizajni ideal duhet të jetë në gjendje të analizojë dhe të kapë të dhëna bazë (të tilla si trafiku i rrjetit) në fazat e



hershme të sulmeve. Kapja e trafikut të rrjetit dhe analiza e thellë e informacionit është thelbësor për paralajmërimet e hershme të sulmit (siç është skanimi mbi sulmet).

Qëllimi përfundimtar i mbrojtjes aktive është arritja e qëllimeve të sigurisë bazuar në strategjinë e mbrojtjes. Në mënyrë që të parandalohet ndikimi i ndërhyrjes para se të shkaktojë dëmtim të sistemit, është e nevojshme të ndërtohet një sistem mbrojtës elastik dhe të miratohet metoda e mbrojtjes për të zbatuar strategjinë e duhur. Kjo do të ndihmojë në shmangien dhe zvogëlimin e rreziqeve me të cilat përballet sistemi i informacionit. Planifikimi i strategjisë së mbrojtjes fillimisht duhet të përcaktojë masat e sigurisë që kërkohen nga asetet dhe më pas rekomandon përgjegjësitë e mbrojtjes mbi këtë bazë. Prandaj, është e nevojshme të sqarohet siguria e funksioneve të aseteve, në të cilat rëndësia e matjes së tyre, që lidhen ndaj qëllimeve të këqija, të cilat janë premisa, dhe si të rekomandohet një mbrojtje e mirë sipas faktorëve ekzistues të rreziikut. Duke marrë parasysh shumë kushtet e kufizuara dhe të normalizuara të kohës, njohjes dhe informacionit në skenarët e sigurisë, si të zbatohet mbrojtja aktive dhe inteligjente nën kufizime të larta të burimeve kompjuterike dhe kushtet dinamike të mjedisit të aseteve janë një tjetër problem.

Nisur sa më lart mund të sugjerojmë një ide për mbrojtjen kibernetike për një mekanizëm planifikimi AI, bazuar në ontologjitë e sigurisë. Kontributet kryesore të këtij studimi mund të jenë me efekte pozitive si: sipas njohurive tona, propozimi realizon një paralajmërim në kohë reale dhe sistem autonom i mbrojtjes nën kufizime të larta të burimeve kompjuterike dhe kushtet e mjedisit të aseteve, duke përdorur racionalitetin e kufizuar dhe planifikimin e



AI-së. Tjetër, krijohet një ontologji e sigurisë si një sistem njohurish për sigurinë, i cili zyrtarizohet dhe standardizon njohuritë me shumë burime dhe ofron një grafik të njohurive për arsyetimin e strategjisë së mbrojtjes. Ontologjia e sigurisë gjithashtu lehtëson zbulimin e sulmeve të skanimit dhe ofron efikasitet në fillim dhe paralajmërime për mbrojtje aktive në fazën e hershme të sulmeve. Mbrojtja kibernetike paraqet një trend zhvillimi aktiv dhe inteligjent.

Qasjet paralajmëruese, shpesh merret një model sulmi për të zbuluar sjelljet jonormale nga krahasimi me modelet normale sepse: qasjet dhe zgjidhjet praktike ndaj sulmeve mund të zbulohen nga metodat e marrjes së të dhënave për të gjeneruar paralajmërime të hershme sulmi; teknologjitë e rrjeteve algoritmet e përzgjedhjes së veçorive mund të ofrohen për të mësuar modelet sulmuese dhe identifikojnë ndërhyrjet në mënyrë efektive. Gjithashtu ky shkrim nxitet nga punimet e sipërpërmendura, dhe synon të trajtojë çështjet e hapura në fushën e kërkimit të mbrojtjes kibernetike nëpërmjet teknikave të inteligjencës artificiale për paralajmërimet e hershme të sulmit dhe mbrojtjen inteligjente aktive. Veç sa më lartë ai zbulon sulmet e hershme, duke analizuar informacionin origjinal, duke zbatuar strategjitë e mbrojtjes kibernetike të bazuara mbi ontologjinë e sigurisë që lidhet me informacionin heterogjen me shumë burime. Objektivi kryesor i këtij shkrimi është të mundësojë paralajmërime të hershme në kohë reale dhe zbatimin e strategjisë autonome të mbrojtjes nën burime të kufizimeve kompjuterike si kontrast me veprat ekzistuese.

Duke synuar problemin e inteligjencës pasive të mbrojtjes së sigurisë në rrjedhën aktuale në rrjetet për sistemet e sigurisë, shkrimi ka një qasje të planifikimit të AI-së për strategjitë e paralajmërimit dhe mbrojtjes në kohë reale për sistemet e sigurisë kibernetike të ndihmuara nga siguria e ontologjisë. Arsyetimi logjik të sjellë zbatimin në paralajmërimet e hershme të sulmeve në kohë reale nëpërmjet informacionit të paketës së integruar të sigurisë. Planifikimi i AI-së dhe racionaliteti i kufizuar përdoren për të zbatuar mbrojtje aktive dhe inteligjente kibernetike në një kohë shumë të kufizuar, njohja dhe kushtet e informacionit për të lehtësuar problemet e sigurisë të shkaktuara nga të lart, kufizimet në burimet llogaritëse dhe mjediset dinamike të aseteve.

Së fundi, mund të theksojmë se aty ku janë realizuar studimet ka rezultuar se rezultatet eksperimentale



tregojnë analizën e të dhënave të trafikut të rrjetit, i cili është efektiv për paralajmërimet e sulmeve dhe metodat e propozuara janë të realizueshme dhe mund të planifikohen në mënyrë të pavarur për strategjitë e sigurisë dhe mbrojtjes. Në këto kushte edhe pse në hapat e para për sistemin tonë të mbrojtjes, teoritë dhe përvojat e lartpërmendura do të shërbejnë për të rritur ndjeshëm efektivitetin e mbrojtjes kundër sulmeve kibernetike nën kufizime të larta të burimeve kompjuterike.



Shtypi ushtarak
në vitet e demokracisë



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Në fillesat e demokracisë

Numri i parë i gazetës “Ushtria dhe koha” në vitin 1992, doli në formatin A3, me 8 faqe e më pas me 16 faqe. Kjo gazetë vijoi të trajtonte problemet ushtarake, të para në këndvështrimin e ri politik e shoqëror të vendit, mjaft e çliruar politikisht. Gazeta ushtarake trajtonte probleme të ndryshme, që kishin të bënin me jetën ushtarake si dhe me traktatet, aleancat, misionet dhe organizimin e ri të ushtrisë shqiptare, sipas kërkesave të kohës. Vijoi botimin deri në marsin e vitit 1997.

“Ushtria dhe koha” ishte një tjetër revistë që doli në vitin e vështirë ekonomik 1992, pranë Ministrisë së Mbrojtjes, si vijim i revistës “10 korriku”. Paralelisht, po me këtë emër, dilte edhe gazeta e ministrisë. Kjo revistë nuk e pati jetën e gjatë, vetëm një vit e gjysmë dhe nga fillimi i vitit 1993 pushoi së ekzistuari.

“Ushtria”, gazetë ushtarake e dalë në vitin 1997, pas trazirave që ndodhën për shkak të ndryshimeve politike në vend. Stafi drejtues i ri i ndryshoi emrin gazetës, duke e quajtur thjesht “Ushtria”. Misioni i gazetës

ishte pasqyrimi i reformave dhe ndryshimeve në ushtri. Gjatë kësaj periudhe një vend të rëndësishëm zuri Lufta e Kosovës dhe gjithë zhvillimet e saj në faqet e gazetës. Njëherësh kjo gazetë priti dhe shekullin e ri, ku u bë frymëzuese, aspiruese, mbështetëse e objektivave të Ushtrisë Shqiptare për të qenë pjesë e NATO-s, gjë që u arrit me shumë dinjitet. Sot kjo gazetë vijon misionin e saj, me këtë emër, si një organ dinjitoz i një Force të Armatosur

po aq dinjitoze. Kjo gazetë nga marsi i vitit 2014 filloi të botohet elektronikisht në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Në kushtet kur Akademia Ushtarake e Shtabit të Përgjithshëm detyrën kryesore kishte procesin e mësimdhënies, ndërkohë ajo ishte edhe një qendër e rëndësishme shkencore e ushtrisë. Ministri i Mbrojtjes nxori urdhrin nr. 15, datë 18.01.1992 për botimin e “Revistës Ushtarake” si organ teoriko-shkencor në Akademinë Ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm. Objekti kryesor i revistës ishte zbërthimi e trajtimi teoriko-shkencor i problemeve kryesore të artit ushtarak në shkallë të ndryshme, të historisë ushtarake të vendit tonë dhe të shteteve të huaja, si dhe tema të përvojës, të teknikës e armatimit bashkëkohor të ushtrive të huaja dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën politiko-ushtarake. Revista kishte kolegjiun e saj të përbërë prej 21 vetash dhe kryeredaktor ishte nënkolonel Xhemil Çela. Revista Ushtarake pati një jetëgjatësi të shkurtër 3 vjeçare, duke ndërprerë aktivitetin e saj.

“Mbrojtja” ishte një tjetër organ profesional që pa dritën e botimit pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Revista “Mbrojtja” doli në numrin e parë të saj në mesin e vitit 1992. Kjo revistë u formatua nga një staf i ri, me emra të rinj, me vizione të reja dhe shumë shpejt revista u bë pararojë e ndryshimeve të domosdoshme edhe në ushtrinë shqiptare. Revista ishte në shërbim të ushtarëve, të



problemeve të tyre, më e çliuar, më shumë argëtuese, edukative dhe informuese.

Botimet pas ringritjes së ushtrisë në vitin 1997

Revista “Mbrojtja”, organ ushtarak-kulturor i Ministrisë së Mbrojtjes - kështu u quajt nga stafi i ri që erdhi në krye të MM në vitin 1997 në revistën “Mbrojtja”. Kështu në emërtimin e revistës u përfshi dhe fjalën “Revista”. Me këtë emër “Revista Mbrojtja” është bërë një organ i specializuar ushtarak, periodik, në formatin A4, me 54 faqe me ngjyra, duke vijuar traditën e botimit deri më sot. Nga marsi i vitit 2014 kjo revistë botohet elektronikisht. Ndërsa në dhjetor të vitit 2022 kjo revistë pa dritën e botimit dhe arriti të botohej në 100 faqe. Në muajt janar dhe shkurt 2023 revista doli në 52 faqe, ndërsa nga muaji mars 2023 revista del në çdo tre muaj me 100 faqe.

Në vitin 2002 nisën botimin një sërë gazetash dhe revistash të Forcave dhe të Komandave Mbështetëse, për informim të brendshëm të njëjësive dhe reparteve të këtyre njëjësive. Misioni i tyre ishte pasqyrimi i gjithë aktiviteteve të Forcave dhe Komandave Mbështetëse, publikimi i planeve të transformimit dhe modernizimit të tyre, si dhe historikët, veprës së brezave të mëparshëm dhe të dëshmorëve e heronjve të tyre. Të tilla ishin gazeta “Fjala e Tokësorit” e Forcave Tokësore, si dhe revistat “Forcat Ajrore”, “Detari” dhe revista e Komandës Mbështetëse etj.

Me reformimin e ushtrisë dhe konsolidimin e Forcave të Armatosura u krijua Komanda e Doktrinëve dhe e Stërvitjes, ku në përbërje të saj u krijua dhe dega e botimeve, si organizëm më vete, në përbërje të Qendrës së Doktrinëve, Manualeve dhe Botimeve, sot Instituti Kërkimit Shkencor Ushtarak, në Akademinë e Forcave të Armatosura. Një nga detyrat kryesore të saj ishte dhe botimi i Revistës Ushtarake si organ teoriko-shkencor i Komandës së Doktrinëve dhe të Stërvitjes, e cila do të luante rol parësor për shkëmbimin e lirë të mendimeve nga kadri oficer, për trajtimin e materialeve teoriko-shkencor, etj. Qëllimi i saj ishte të kontribuonte në zbatimin e trajtimin sa më shkencor të teorisë e të doktrinëve sonë ushtarake në përputhje me kushtet e zhvillimit bashkëkohor, të ndihmojë kadrin oficer në zgjerimin e njohurive të tyre ushtarake, sidomos atyre të shtabeve e të reparteve, akademistëve e studentëve. Ajo synonte në zhvillimin bashkëkohor të shkencës ushtarake. Revista i parapriu dhe i hapi rrugë mendimit të lirë debatues e në frymë konstruktive, për idetë, mendimet e trajtuara nga autorë të ndryshëm si bashkëpunëtorë të revistës.

Në vitin 2002 revista ushtarake pa dritën e botimit në dy numra të saj. Në to u trajtuan probleme të politikës së sigurimit e të mbrojtjes, koncepte doktrinale e të stërvitjes, probleme të historisë ushtarake e të terminologjisë, probleme të arsimit ushtarak, trajtesa të kolegjit të mbrojtjes etj., me rreth 40 artikuj të shkruar nga gjeneralë, profesorë, pedagogë, kadro, akademistë e studentë. Në vitin 2003 në Revistën Ushtarake janë shkruar artikuj nga Presidenti, Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, si dhe gjeneralë, profesorë, veteranë,





komandantë të llojeve të armëve e shërbimeve e figura të tjera publike të vendit dhe të ushtrisë. Në vitin 2003 Revista Ushtarake pa dritën e botimit në katër numra dhe janë shkruar rreth 80 artikuj. Pas kërkesës së bërë nga ish-komandanti i Komandës së Doktrinës dhe të Stërvitjes, gjeneralmajor Perlat Sula dhe oponencës së bërë nga Prof. Proletar Hasani, Komisioni i Kualifikimit Shkencor pranë Këshillit të Ministrave, e klasifikoi Revistën Ushtarake si revistë shkencore më datë 10 dhjetor 2003. Numri i parë i vitit 2004 i Revistës Ushtarake hyri në histori si numër i klasifikuar shkencor në bazë të ligjeve që veprojnë në Republikën e Shqipërisë dhe si e vetmja revistë shkencore në FA. Kjo revistë doli deri në fund të vitit 2005, për të rivazhduar përsëri nga viti 2008 dhe deri më sot. “Krenaria ushtarake”, gazetë e Shoqatës së Bashkuar të Ushtarakëve në Rezervë që nisi botimin në vitin 2000. Gazeta kishte 16 faqe dhe doli në 28 numra, duke trajtuar kryesisht probleme të ushtarakëve në lirim e në rezervë si dhe probleme të së kaluarës. Vijoi botimin deri në vitin 2008.

“Zëri i ushtarakut” nisi botimin në vitin 2009, si gazetë më vete, pasi më parë dilte si suplement ushtarak i gazetës “Ndryshe”. Gazeta trajtonte problemet e ushtarakëve të liruar, kryesisht. “Aleanca ushtarake” ishte gazeta ushtarake, organ i Aleancës Kombëtare të Ushtarakëve të Shqipërisë dhe filloi botimin në mesin e vitit 2010, si një gazetë periodike me 12 faqe. Gazeta trajtonte edhe kjo probleme të ushtrisë dhe jetës së ushtarakëve si dhe probleme të ndryshme kulturore kombëtare e ndërkombëtare.

Revista “Studime për Historinë Ushtarake”, organ shkencor i Institutit të Studimeve të Historisë Ushtarake, nisi botimin në vitin 2006. Në faqet e kësaj reviste kanë gjetur pasqyrim studimet shkencore në fushën e Historisë Ushtarake Shqiptare, si botime e promovime librash shkencorë, tekste mësimore për shkollat e akademitë ushtarake, monografi, materiale shkencore dhe njohëse për studimin, evidentimin dhe publikimin e dukurive, ngjarjeve dhe të personaliteteve të Historisë Ushtarake Shqiptare e më gjerë (në rajon) etj., organizim seminaresh, sesionesh dhe konferencash për diskutimin dhe bërjen të njohur, të dukurive e risive të ndryshme apo të studimeve me karakter shkencor dhe edukativ nga fusha e Historisë Ushtarake etj.

Kjo ishte një panoramë fragmentare e shtypit ushtarak në 32 vjet jetë, të nisura nga viti 1991. Në këtë shkrim njohës dhe përshkruës shikohet se numri i gazetave dhe revistave ushtarake në kohë të ndryshme ka pasur ngjitje dhe ulje, por kurdoherë ka qenë i vlerësuar dhe i ndjekur me vëmendje nga stafet e tyre, por dhe nga drejtuesit e institucioneve dhe të dikastereve përkatëse. E rëndësishme dhe themelore për këto gazeta dhe revista, ka qenë përkushtimi i madh dhe i vëmendshëm ndaj jetës dhe karrierës së ushtarakut, formimit dhe edukimit të tyre, etj.



*Nënkolonel Durim
Islami, komandant
i Batalionit të
Transportit
në Komandën
Mbështetëse të FA-së*



**Shërbimi i Transportit në FA, forca
lëvizëse e gatishmërisë së lartë operationale**

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

Transporti ushtarak është pjesë përbërëse e rëndësishme e shërbimit të mbështetjes logjistike, ku logjistika në vetvete përfshin lëvizjen, zinxhirët e furnizimit me sektorët përbërës të saj, si dhe mbështetjen e Forcave të Armatosura. Transporti Ushtarak është një nga elementët kryesorë të kësaj mbështetjeje.

Historiku i shërbimit të transportit ushtarak, nis me fillimet e organizimit të transportit ushtarak shqiptar, që pas krijimit të ushtrisë pas vitit 1912 e më tej 1924-1927, por si datë historike, transporti ushtarak lidhet me krijimin e batalionit të parë të transportit, më 13 prill 1945. Në maj 1945 e në vazhdim u krijua batalioni i dytë i transportit. Pas një procesi ristrukturimi që zgjati afërsisht 40 vjet, në 1983 u krijua regjimenti i transportit. Si pasojë e faktit që specialiteti i transportit ishte bërë një nga kompetentët kryesorë të Forcave të Armatosura shqiptare, në vitin 1993 për herë të parë u krijua Brigada e Transportit. Që nga viti 2007 deri më sot, trupat e transportit janë të organizuara në nivel batalioni.

Batalioni i Transportit është komandimi, kontrolli, trajnimi dhe mirëmbajtja e një niveli të lartë gatishmërie dhe operacionale. Ai siguron transport të personelit dhe ngarkesave në mbështetje të operacioneve të FA-së, në ndihmë të komunitetit e në të

gjithë spektrin e operacioneve.

Në drejtimin e Batalionit të Transportit në Komandën Mbështetëse të FA-së, është nënkolonel Durim Islami, të cilin po e sjellim në faqet e shtypit ushtarak nëpërmjet kësaj interviste.

Datat dhe momentet më kryesore të shërbimit të transportit ushtarak

Më 22 prill 1913, doli “Rregullorja për organizimin e Ministrisë së Luftës”. Më 4 maj 1913, u formua Shtabi Madhnuer (Shtabi Madhor). Më 6 maj 1913, formohet shërbimi i parë i prapavijës (i intendencës dhe i transportit). Më 1 shtator 1925, doli “Rregullorja mbi Përdorimin dhe mbajtjen e Automobilitave.” Më 1 nëntor 1926, formohet Batalioni “Vjosa” në Shkodër, i kompletuar me 70 kafshë transporti. Shtator 1926, u ngrit një oficinë e mirëmbajtjes së automjeteve të transportit ushtarak. Më 24 shtator 1944, Shtabi i Përgjithshëm i UNÇSH-së, mori urdhra për krijimin e seksionit të transportit pranë shtabit të Korparmatsë së I, ku theksohej: “Seksioni i transporteve dhe i komunikacioneve kryen të gjitha punët që kanë të bëjnë me mbajtjen dhe me rregullimin e trafikut dhe të komunikacioneve të trafikut, të transporteve ushtarake, materialin ushtarak, ushqimin dhe pajisjen, transportin e të plagosurve dhe të sëmurëve, lidhjet (telefon, telegraf, postë), punimet teknike për qëllime ushtarake dhe organizimin e oficinave”. Po në këtë datë kanë dalë urdhra të tjerë që përcaktojnë strukturën, de-





tyrat si dhe bashkërendimet me seksionet e tjera ushtarake, të seksionit të transportit, i cili në këto dokumente merr formën e plotë të organizimit të tij pranë Shtabit të Përgjithshëm dhe në të gjitha njësitë e repartet e tjera të Ushtrisë. Shefi i parë i këtij seksioni u caktua Thanas Gjoka, i ardhur nga rreshtat partizane. Formohet kështu shërbimi i transportit automobilistik, i cili do të përballonte detyrat e luftës deri në çlirim e plotë të Shqipërisë dhe do të mbante mbi vete peshën kryesore të periudhës së luftës. Batalioni i Parë i Autotransportit në Tiranë, do të formohej me automjetet e rekuizuara në të gjitha qytetet e qarqet e Shqipërisë, në bazë të urdhrin nr. 11, rez., datë 07.04.1945, Batalioni i Dytë i Transportit në Durrës, i krijuar në javën e parë të muajit maj 1945.

Komandant Durim Islami, shërbimi i Transportit Ushtarak është tregues i rëndësishëm logjistik dhe i nivelit të infrastrukturës ushtarake. Batalioni i Transportit që ju drejtoni, çfarë roli luan në FA?

Batalioni i Transportit mbështet me Transport Komandën Mbështetëse dhe Strukturat e FA-së, në kohë paqe, krize dhe lufte, si dhe sigurimin e transportit të personelit dhe ngarkesave në mbështetje të operacioneve të Forcave të Armatosura brenda dhe jashtë vendit. Pra misioni i Batalionit

të Transportit është komandimi, kontrolli, trajnimi dhe mirëmbajtja e një niveli të lartë gatishmërie dhe operacional. Siç e thashë siguron transport të personelit dhe ngarkesave në mbështetje të operacioneve të FA-së, por edhe në ndihmë të komunitetit e në të gjithë spektrin e operacioneve.

Misioni i Batalionit tonë të Transportit realizohet brenda misionit të Komandës së Mbështetjes, i organizuar si një hallkë e rëndësishme e zinxhirit logjistik me pajisjet dhe teknikën e mjeteve të transportit të kohës, në përshtatje me kushtet dhe nivelin teknologjik ku vepron, mbështetur në përvojën më të mirë të shkuar teorike e teknike, kombëtare dhe të vendeve të Aleancës të NATO-s.

Cilat janë detyrat që ka Batalioni i Transportit? Si realizohet mbështetja me transport në strukturat e FA-së?

Detyrat tona, pra të Batalionit të Transportit në Komandën e Mbështetjes, burojnë nga misioni ynë, që lidhet gjithçka me lëvizjen e mjeteve që ne disponojmë. Ne kryejmë një sërë detyrash të rëndësishme në FA. Batalioni i Transportit ka detyrë të transportojë personelin, pajisjet, kontejnerët dhe ngarkesat në mbështetje të operacioneve të Forcave të Armatosura. Të sigurojë kapacitete transporti për personelin dhe pajisjet, për një Batalion Këmbësorie njëherësh të Forcës Tokësore. Ka detyrë të komandojë,

kontrollojë, pajisë, trajnojë dhe të mbajë një nivel të lartë të gatishmërisë operacionale për batalionin. Administrojnë dhe mirëmban infrastrukturën, pajisjet dhe teknikën. Por gjithashtu Batalioni i Transportit ka për detyrë të transportojë, ngarkojë dhe shkarkojë kontejnerë ISO në mbështetje të Operacioneve të Forcave të Armatosura të RSH. Të Transportojë ngarkimin-shkarkimin e pajisjeve kontejnerëve dhe ngarkesave në porte detare dhe aeroporte, kur kemi transport ajror. Por ne kryejmë edhe detyrën e mbështetjes me transport të strukturave të Forcave të Armatosura për përballimin e operacioneve të emergjencave, krizave, fatkeqësive natyrore, ndihmave humanitare dhe operacioneve paqeruajtëse. Kemi detyrë të mirëmbajmë dhe administrojmë infrastrukturën, pajisjet dhe teknikën ushtarake. Batalioni i Transportit ka detyrë të sigurojë mbështetjen me transport për të gjitha klasat e furnizimit (5 Kl.) të strukturave të FA-së, sipas nevojave me miratim të strukturave eprore.

Batalioni ynë merr pjesë në stërvitje të përbashkëta me qëllim realizimin dhe mbështetjen me transport sipas standardeve të NATO-s. Përpunimin e të gjithë procedurave të duhura përfshirë ato ekonomike, infrastrukturës dhe resurseve ushtarake e civile të transportit, për t'iu përgjigjur në kohë situatave të kohës paqes, krizës dhe konfliktit. I gjithë aktiviteti ynë operacional zhvillohet mbi zbatimin e të gjitha kriterëve, procedurave për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e mjeteve.

Komandant, kur daton krijimi i Batalionit të shërbimit të Transportit Ushtarak shqiptar?

Shërbimi i transportit ushtarak zë një vend të posaçëm në historinë e shërbimit të mbështetjes logjistike në Forcat e Armatosura dhe ai është sa rëndësishëm po aq edhe jetik. Transporti ushtarak është një bashkudhëtar aktiv, që shoqëron Forcat e Armatosura dhe Ushtrinë Shqiptare që nga krijimi i tyre. Shërbimi i Transportit ushtarak shqiptar dhe formacionet transportuese të tij kanë evoluar së bashku me

transformimin shekullor të Forcave të Armatosura dhe ushtrisë shqiptare. Në fillimet e organizimit të transportit ushtarak shqiptar, në vitet 1912-1924-1927, faktet historike nxjerrin në dukje një përvojë të pakët organizuese e transportuese në strukturat drejtuese dhe në formacionet ushtarake fillestare, të krijuara me lindjen e shtetit të parë të pavarur shqiptar, si dhe në procesin e organizimit të ushtrisë. Por më tej po ju sjell faktin kur Komanda e Prapavijave, me anën e Qarkores me Nr.484, datë 13 prill 1945, konfirmonte formimin e batalionit të parë të transport-komunikacionit civil, i cili hodhi bazat dhe hapin e parë në fillimin historik të organizimit dhe të aktivitetit të shërbimit me transport ushtarak. Në maj 1945, në Durrës u krijua batalioni i dytë i transportit. Dhe në vitin 1980, në Pezë Helmës, u krijua Batalioni Operativ për transport Trupash.

Afërsisht 40 vjet pas themelimit në vitin 1983, në strukturën e re të FA-së u krijua Regjimenti i Transportit, i cili përbëhej nga Batalioni i Transportit të trupave, Batalioni i Riparimit, Sektori i Teknikës Rezervë, Parku i Veturave të MM.

Në vitin 1993 u krijua Brigada e Transportit në vartësi të KML dhe në korrik 2001 u riorganizua Brigada e Transportit në vartësi të KML. Kurse në mars 2007, në kuadër të ristrukturimit, u kalua nga Brigadë Transporti në Batalion Transporti në vartësi të BrL dhe prej atij viti deri më sot është në vartësi të Komandës Mbështetëse me vendndodhje në Pezë Helmës.

Si është sot shërbimi i mbështetjes me transport i FA-së?

Më vjen mirë të them që Batalioni i Transportit, qëndron në pararojë të shërbimit të mbështetjes me transport të FA-së, si reparti më i madh e i specializuar, me përvojë transportuese në fuqi, kapacitet dhe në organizimin operacional transportues ushtarak. Në këto 78 vite të krijimit të tij, batalioni i transportit ka realizuar detyra të ndryshme.

Në morinë e detyrave mjaft të rëndë-

sishme dhe njëherësh me përgjegjësi të lartë për Transportin Ushtarak, ka qenë pjesëmarrja në paradat ushtarake, të cilën dua ta përmend, pasi në paradën e zhvilluar, më datë 04 dhjetor 2017, me rastin e 95-vjetorit të krijimit të FARSH-së, Batalioni i Transportit u vlerësua me medalje, me urdhër nr. 616 dt. 03.12.2017, "Për dhënie medalje të Rep. Usht. Nr. 4007" nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Bardhyl Kollçaku, i cili i akordoi Btr-së Medalje "Repart i Shquar", me motivacionin: "Për arritje të shquara për mbështetje në transport në Forcat e Armatosura". Ky është jo vetëm një vlerësim për ne, por edhe një krenari dhe përgjegjshmëri për më tej.

Ndër detyra të tjera ndër vite që na bëjnë krenarë, gjithashtu ka spikatur edhe mbështetja në transportimin e personelit, materialeve, të të shpërngulurve gjatë luftës në Kosovë, në vitin 1998-1999.

Kurse në vitin 2007, batalioni ka marrë pjesë në "Projektin për asgjësimin e municioneve të rënda", në bashkëpunim me kompaninë Amerikane SAIC, ku u transportuan dhe asgjësuan rreth 2772 ton municione dhe u reduktuan rreth 11 grup-depo.

Çfarë mjetesh disponon Batalioni i Transportit sot? A janë mjetet dhe teknika e tij sipas standardeve që kërkon koha?

Batalioni i transportit disponon mbi 100

mjete të tipave të ndryshëm, të cilat janë të ndara në kamionë të lehtë, të mesëm, të rëndë dhe mjete speciale. Këto mjete kryejnë shërbimin për Emergjencë Civile (EC), transport municioni në interes të ndërmarrjes "MEICO", zhvendosje municioni për repartet e Komandës Mbështetëse, transport materialesh jashtë vendit, transport materialesh teknike etj. Mbështetja me transport për INSTAT, Mbështetja me transport e të III-ve, Transport skrapit.

Batalioni i Transportit ka kryer dhe kryen detyra në interes të Qendror e Pushtetit Vendor, për transportin dhe shpërndarjen e materialeve logjistike të KQZ-së në të gjithë Territorin e Republikës së Shqipërisë. Megjithatë është teknikë e vjetër në vite, ajo ka përballuar me sukses mbështetjen me transport të mesëm e të rëndë të të gjitha strukturave ushtarake të FA-së në stërvitje të ndryshme, duke realizuar me sukses të gjitha detyrat e ngarkuara nga MM, SHPFA, dhe komandanti i KM-së. Shpresojmë që në kuadrin e Modernizimit të FA-së, brenda viteve 2024-2025, të fillojë zëvendësimi i një pjese të kësaj teknike me teknikë të re, kamionë të mesëm, të rëndë dhe mjete speciale për përballimin e kërkesave në rritje të FA-së në kuadrin e Aleancës së Atlantikut të Veriut. Për të ardhmen pritet modernizimi me ndihmën e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.





Kolonel dr. Elton Reso

**Kolonel dr. Elton Reso: Është
momenti që shërbimi mjekësor të
trajtohet si një emergjencë kombëtare**

INTERVISTOI: MIMOZA GOLIKJA

Mjekësia është një shkencë humane me përmasa shumë të gjëra. Shërbimi Shëndetësor i Forcave të Armatosura plotëson detyrimet në mision të detyrave të mjekësisë ushtarake për mbështetjen mjekësore të efektivëve të FA-së, familjeve të tyre, ushtarakëve në rezervë dhe pension si dhe detyrimet e tjera në kuadër të shërbimit shëndetësor civil dhe detyrimeve që lidhen me NATO-n. Shërbimi Shëndetësor i FA-së siguron ndihmën mjekësore bazë dhe të kualifikuar për efektivat e FA-së, siç e parashikon statusi i ushtarakut dhe ka aktivitetet parandalues, diagnostikues, mjekues dhe trajnues. Ky shërbim siguron mbështetje mjekësore të FA-së në rol 1, 2, dhe 3 të mbështetjes mjekësore si dhe trajnon e përgatit personelin mjekësor të FA-së për rolin 1 dhe 2 të ndihmës mjekësore, parandalimin e sëmundjeve dhe epidemive, trajtimin dhe riaftësimin e forcave në kohë paqe, konflikti e krize. Në bashkëpunim me shërbimin shëndetësor civil, ofron ndihmë mjekësore për popullatën në emergjencë, katastrofa e fatkeqësi.

Drejtori i Inspektoratit Shëndetësor në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, kolonel dr. Elton Reso për shtypin ushtarak do të sillte aktivitetin e këtij institucioni, emocionet dhe vështirësitë e hasura përgjatë rrugëtimit të tij si qenie humane, mjek dhe ushtarak karriere në Forcat e Armatosura.

Dr. Elton Reso: Spitali Ushtarak Qendror Universitar për mua nuk ishte vetëm institucioni mjekësor ku duhet të punoja dhe të rritesha profesionalisht, por mbi të gjitha më mësoi se me

sa përgjegjësi ishte të mbaja dy uniforma, atë ushtarake dhe mbi bluzën e bardhë të mjekut.

Kolonel Elton Reso, intervistën me ju doja ta nisja duke përmendur faktin se ju, duke qenë djali i themeluesit të gazetarisë shqiptare, drejtues i Degës dhe i Katedrës të Gazetarisë profesorit të nderuar, Zihni Reso, jeni diplomuar në mjekësi dhe keni një karrierë të spikatur në mjekësinë ushtarake. Çfarë ju nxiti ju që të bëheshit mjek, por dhe më tej, si u gjendët në mjekësinë ushtarake?

Në radhë të parë përshëndetje dhe faleminderit shtypit ushtarak për intervistën. Ashtu siç dhe ju shprehët me pyetjen tuaj, babai im prof. Zihni Reso, megjithëse historian në formimin e tij profesional, ka qenë iniciuesi, themeluesi dhe shefi fillimisht i degës dhe më vonë katedrës së gazetarisë pranë Universitetit të Tiranës.

Jam rritur në një familje ku sinqeriteti, komunikimi, bashkëbisedimi, kultura ishin pjesë e udhëtimit tonë, dhe megjithëse fëmijë i vetëm, prindërit e mi, por kryesisht babai nuk ndikonte në zgjedhjet e mia personale për jetën dhe zhvillimin tim profesional, por me qetësi e bashkëbisedim më linte të kuptoja që rrugët për të ardhmen ishin të shumta dhe zgjedhja që duhet të bëja duhej të më kënaqte mua fillimisht, pasi ishte e ardhmja ime. Pra kjo kulturë e tij më bëri që kur erdhi momenti i zgjedhjes, pas mbarimit të maturës, për profesionin tim, ndërmjet juridikut dhe mjekësisë të zgjidhja mjekësinë, pasi në vitin që mbarova maturën fakulteti i mjekësisë aplikoi për herë të parë konkursin për të hyrë (të cilin e fitova), ndërsa juridikun e fitova nëpërmjet mesatares, siç ishin rregullat në atë periudhë. Atë vit fakulteti i mjekësisë filloi për herë të parë me sistemin 6-vjeçar.

Me mjekësinë ushtarake dhe fillimisht me Spitalin Qendror





Ushtarak (1998, më vonë Spitali Ushtarak Qendror Universitar) më lidhi specialiteti im, të cilin unë e mora pas mbarimit të fakultetit të mjekësisë. Pra ishte specialiteti që zgjodha që më lidhi me mjekësinë ushtarake dhe Forcat e Armatosura.

Kolonel, sa e rëndësishme ka qenë për ju të jeni nën dy uniforma, nëse mund ta quajmë kështu, bluzën e bardhë të mjekut mbi atë të ushtarakut, por që të dyja në shërbim të jetës?

Shumë e rëndësishme, por dhe shumë me përgjegjësi. Siç u shpreha më lart fillimisht fillova punë më 1998 në ish Spitalin Ushtarak Qendror Universitar. Aty gjeta, përjetova dhe punova me një personel mjekësor, mjekë dhe infermierë ushtarakë dhe civilë të mrekullueshëm, të përkushtuar dhe tepër të përgjegjshëm për jetën e çdokujt që paraqitej për ndihmë në këtë institucion, pasi spitali ushtarak ishte dhe Qendra Kombëtare e Traumës, ku trajtoheshin dhe shumë civilë. Përkushtimin ndaj jetës së ushtarakut, familjarëve të tyre dhe çdo personeli tjetër të forcave të Armatosura e mësova e ngulita mirë pikërisht nga kjo plejadë mjekësh ushtarakë të përsosur e talentuar me të cilët pata nderin të punoja. Spitali Ushtarak për mua nuk ishte vetëm institucioni mjekësor ku duhet të punoja dhe të rritesha profesionalisht, por mbi të gjitha më mësoi se me sa përgjegjësi ishte të mbaja dy uniforma, atë ushtarake dhe mbi atë, bluzën e bardhë të mjekut.

Doktor, a keni pasur ju situata të vështira gjatë karrierës tuaj të gjatë, si mjek dhe si ushtarak njëkohësisht? Cilat

kanë qenë ato?

Po kam patur disa, si fillim duhet ta filloj me ngjarjen e 9 janarit 2004, në Vlorë, ku u mbyt një skaf me disa persona dhe ne atëherë, me t'u dhënë lajmi nga një televizion shqiptar, të cilin e kishte njoftuar një ndër personat që ishte në skafin që po fundosej nga koha e keqe dhe mbingarkesa, jemi mbledhur me urgjencë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe u nisëm menjëherë në drejtim të Vlorës. Anijet e Forcës Detare dhe mos gaboj dhe anijet Guardia di Finanza të Italisë, po kërkonin në mes të errësirës në det për të gjetur të mbijetuar, ndërsa unë me personelin mjekësor ushtarak nga të gjitha Forcat e Armatosura, me 8 autoambulanca prisnim në vendin ku ankororeshin anijet për të ofruar ndihmën mjekësore për të mbijetuar, por për fat të keq ambulancat tona transportuan vetëm trupa të pajetë.

Po kështu do kujtoj ngjarjen e Gërdecit, ku me të dëgjuar njoftimin në TV kam dalë nga shtëpia dhe jam nisur menjëherë drejt Spitalit Ushtarak për të koordinuar në nivel të Drejtorisë së Shëndetësisë punën ndërmjet personelit mjekësor dhe ambulancave të Forcave të Armatosura - të cilat duhet ta cilësoj dhe theksoj që kanë qenë të parët që kanë hyrë në vatrën e shpërthimit dhe me rrezikun më të madh, ku shpërthenin herë pas here mina të pashpërthyer - dhe ish-Spitalit Ushtarak Qendror Universitar. Dhe të vijmë tani së afërmi me tërmetin e ndodhur në Turqi në muajin shkurt 2023, ku kam drejtuar ekipet e kërkimit-shpëtimit dhe ekipet mjekësore shqiptare

për t'u ardhur sado pak në ndihmë popullit mik turk.

Sa efikas është shërbimi mjekësor ushtarak për Forcat e Armatosura, çfarë detyrash ka ai? Si është shërbimi mjekësor ushtarak sot që po flasim, në çfarë niveli?

Shërbimi mjekësor ushtarak ka si mision të tij ruajtjen e shëndetit të efektivave në kohë paqe, krize, lufte si dhe të gjithë ushtarakëve në rezervë, pension dhe familjareve të tyre. Shërbimi shëndetësor ushtarak me kapacitet e veta merr pjesë në të gjitha emergjencat civile që shfaqen në vendin tonë, siç është aktualisht pjesëmarrja jonë në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë për t'u ardhur në ndihmë mjekësore popullatës civile gjatë ditëve të nxehta, ndërmjet hapjes së disa pikave mobile në zona të ndryshme të qyteteve të vendit.

Sot ky shërbim nuk është në ditën e tij më të mirë, megjithëse kryen 100% të gjitha detyrat që i ngarkohen nga Shtabi i Përgjithshëm i FA-së dhe Ministria e Mbrojtjes, pasi ende ka mungesa në kapacitete mjekësore dhe personel. Nga SHPFA dhe Ministria e Mbrojtjes po punohet dita ditës për eliminimin e këtyre mangësive. Këtu vlen të përmend iniciativën direkte të Ministrisë të Mbrojtjes dhe SHSHPFA për hapjen dhe funksionimin e një laboratorit modern biokimik dhe bakteriologjik si dhe të katër kabineteve dentare moderne pranë Njesisë Mjekësore Ushtarake, të cilat do të jenë në shërbim të efektivëve të FA-së, familjarëve të tyre, ushtarakëve në rezervë, pension, si dhe familjeve të tyre. Ambientet e laboratorit dhe ambientet ku do të vendosen kabinetet dentare janë në fazën përfundimtare të rikonstruksionit, si dhe nga Ministria e Mbrojtjes janë zhvilluar të gjitha procedurat e prokurimit për pajisjet laboratorike dhe kabinetet dentare.

Si sigurohet mbështetja mjekësore për FA-të, ku konsiston roli juaj?

Mbështetja mjekësore për efektivët e FA-së sigurohet nëpërmjet qendrave shëndetësore Rol 1 që kemi në të gjitha repartet dhe njësitë e Forcave të Armatosura si dhe nëpërmjet mbështetjes mjekësore më të specializuar që kryhet nga Njësia Mjekësore Ushtarake e integruar me Spitalin Universitar të Traumës.

Si është e integruar trupa e shërbimit mjekësor ushtarak, sa është numri i stafit tuaj, sa i përgjigjet ai sfidave?

Siç e theksova dhe më sipër, megjithëse me një staf mjekësor jo të plotësuar në personel dhe me vështirësi të tjera, deri më sot, Shërbimi Shëndetësor i FA-së i ka realizuar 100% të gjitha detyrat e ngarkuara.

Çfarë marrëdhëniesh ka mjekësia ushtarake me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale?

Me Ministrinë e Shëndetësisë kemi marrëdhënie shumë korrekte dhe pozitive, siç është aktualisht dhe koordinimi dhe bashkëpunimi për ardhjen në ndihmë popullatës gjatë ditëve të nxehta, ku kemi vënë në dispozicion edhe kapacitetet tona. Por kjo është edhe për faktin kryesor që Shërbimi Shëndetësor i FA-së, ndjek dhe zbaton të gjitha rekomandimet, urdhrat dhe politikat e Ministrisë së Shëndetësisë për ruajtjen e shëndetit

të efektivëve të saj si dhe të gjithë personelit që përfiton nga statusi i ushtarakut. Këtu nuk mund të lë pa përmendur punën kolosale që kreu shërbimin shëndetësor ushtarak gjatë ditëve të pandemisë ndaj Covid-19, duke testuar, trajtuar dhe përballuar jo vetëm personelin ushtarak por edhe popullatën civile, si dhe vaksinimi i popullatës së Tiranës në sheshin "Skënderbej", që u krye pothuajse në masën 90% nga personeli mjekësor i Forcave të Armatosura.

Si koordinoheni?

Koordinimi me MSH kryhet nëpërmjet drejtorisë së Inspektoratit Shëndetësor në SHPFA dhe strukturave të tjera në MM.

Po shërbimi i urgjencës si funksionon?

Shërbimi i urgjencës mjekësore për efektivët e FA-së, kur kanë probleme të cilat nuk mund të zgjidhen nga qendrat shëndetësore të reparteve dërgohen në urgjencën e Spitalit Universitar të Traumës ose në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në varësi të problemit shëndetësor që mund të shfaqin, këtu flasim për repartet që gjenden në Tiranë.

Duke u kthyer tek ish-Spitali Ushtarak, sot Spitali i Traumës. Çfarë mendimi keni ju për këtë organizim të mjekësisë ushtarake prej një dekade tashmë, nisur edhe nga eksperiencia dhe karriera juaj e gjatë si mjek ushtarak?

Spitali Ushtarak Qendror Universitar mund të them me bindje të plotë që ishte krenaria e Forcave të Armatosura. Krenari jo thjesht në kuptimin se jam unë mjek ushtarak, por krenari kur të gjithë njerëzit flisnin dhe flasin edhe sot e kësaj dite, "po shkoj të trajtohem në Spitalin Ushtarak, po shkoj të bëj analizat në Spitalin ushtarak, po shkoj të shtrohem në Spitalin ushtarak se atje ka mjekë dhe përkujdesje mjekësore më të mirë". Pra po them ato që vetë populli fliste dhe flet edhe aktualisht për këtë spital dhe për mjekësinë ushtarake.

Edhe sot po të pyesësh njerëzit, të gjithë e njohin me emrin "Spitali Ushtarak" dhe jo "Spitali Universitar i Traumës". Ky fakt për mua thjesht tregon emrin e mirë që ka lënë ky institucion mjekësor jo vetëm për efektivët e FA-së por dhe popullatën civile në vendin tonë.

Dhe konkretisht tani për pyetjen tuaj, nisur nga eksperiencia e deritanishme e funksionimit të integruar të Spitalit Universitar të Traumës, mendimi im si specialist mjekësor është që nuk ka sjellë risi për sa i takon diagnostikimit, trajtimit dhe kurimit mjekësor të efektivëve të Forcave të Armatosura.

Jam i mendimit dhe gjykimit që Forcat e Armatosura duhet të kenë një institucion mjekësor terciar të tyre për diagnostikim, trajtim, dhe kurimin e efektivëve të FA-së si dhe gjithë personelit që përfshin statusi i ushtarakut.

Nga sa po më thoni, a mund të rikthehet edhe njëherë Spitali Ushtarak?

Besoj dhe shpresoj që mund t'i ofrojmë ushtarakëve, familjarëve të tyre, ushtarakëve në rezervë, pension, familjarëve të tyre dhe i personelit të institucioneve të sigurisë dhe mbrojtjes së vendit, një institucion mjekësor terciar ushtarak.



Shpesh kemi dëgjuar për Spitalin Fushor Ballkanik, çfarë është ai?

Spitali fushor ballkanik, është një iniciativë e filluar që në vitin 2009, në kuadër të Kartës së A-5. Ky spital është i ndërtuar bazuar në kapacitetet mjekësore dhe personel që kanë shtetet anëtare të Kartës së A-5. Misioni i tij është ndërhyje dhe ndihma mjekësore në një nga shtetet e Ballkanit ku ka nevojë në rast emergjencash civile. Për shembull këtu mund të përmend që ky spital ishte i gatshëm për të funksionuar dhe në tërmetin që ndodhi në Turqi, në rast se do të kërkohej nga pala turke. Aktualisht ky spital përbëhet nga vende si Shqipëria, Sllovenia, Serbia, Maqedonia e Veriut, Bosnje-Hercegovina dhe Mali i Zi.

Cilat janë Burimet Njerëzore të Shërbimit Mjekësor Ushtarak, si i rekrutoni ju mjekët? Ku studiojnë ata? Si është raporti i mjekëve që vijnë nga universitete të mjekësisë ushtarake me ato civile, a përbën një dallim?

Shërbimi Shëndetësor i FA-së ka një staf mjekësor të përkushtuar dhe të përgatitur. Është një ekip që e ka me pasion profesionin që ka zgjedhur dhe e do punën që bën. Kjo është shumë e rëndësishme në profesionin e mjekut, përveç njohurive dhe aftësive të tua si mjek, apo dhe eksperiencat, përkushtimi dhe humanizmi që të karakterizojnë janë tipare thelbësore, për t'iu gjendur pranë njerëzve dhe jo vetëm për të bërë detyrën. Burimet Njerëzore të Shërbimit Mjekësor Ushtarak dhe rekrutimi i tyre është i njëjtë me atë që bëhet edhe për personelin tjetër ushtarak në FA, por sigurisht me kriteret dhe specifikën e vet që ka profesioni i shëndetësisë. Ne i kemi mjekët tanë të diplomuar nga Universiteti Mjekësor i Tiranës, pra që kanë studiuar në vend, por edhe mjekë që kanë studiuar

në Universitet e Mjekësisë Ushtarake, si në Turqi, Greqi, Itali. Mjekët tanë gjithashtu janë të specializuar në fusha të ndryshme sipas nevojave të FA-së brenda dhe jashtë vendit dhe ajo që bën dallimin është përkushtimi i tyre, gjë e cila nuk iu mungon.

Si është niveli i stafit, specializimi, nivelet e studimit, apo kërkimi shkencor. Sa interes përbën kjo për stafin tuaj? Si është bashkëpunimi rajonal apo me vende të tjera të Aleancës? Çfarë marrëveshesh ka mjekësia jonë ushtarake?

Profesioni ynë të kërkon të jesh i përditësuar me të rejat e shkencës të fushës së mjekësisë, prandaj është e domosdoshme nga i gjithë stafi që ta përafrojnë dhe ta përvetësojnë atë. Pra është në interes të gjithsecilit si individ por dhe të punës në grup, si ekip, që të jemi të përditësuar me të rejat e studimeve të ndryshme, të cilat përbëjnë interes për ne. Siç e thashë dhe më parë personeli ynë ndjek specializimet sipas nevojave që ka FA dhe merr pjesë në trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, sipas programeve dhe projekteve që ne kemi.

Shërbimi ynë mjekësor i FA-së ka bashkëpunim rajonal si dhe më gjerë me vende anëtare të NATO-s në mënyrë të vazhdueshme. Jemi në kontakt të vazhdueshëm edhe sipas programeve por edhe në rast nevojë apo emergjencash. Marrëdhëniet tona janë korrekte, marrim pjesë në simpoziume dhe kongrese që organizohen. Përfaqësimi i mjekësisë ushtarake shqiptare është dinjitoz.

Po lidhur me misionet ushtarake dhe ato paqeruajtëse të FA-së, sa e përfshirë është mjekësia ushtarake? A jeni ju pjesëmarrës në çdo kontingjent?

Sigurisht! Pjesëmarrja jonë është në çdo kontingjent të FA-së, kudo, në çdo mision. Stafi ynë është i trajnuar, ashtu si i çdo

efektivi tjetër, pjesë e kontingjentit si në misionet e paqes, por edhe në Afganistan, Irak, aktualisht në Letoni dhe në Kosovë.

Para disa muajsh, e gjithë bota mbajti frymën për atë që ndodhi në vendin mik Turqinë, lidhur me tërmetin. Përgjigja e menjëhershme dhe shembulli i FA-së shqiptare dhe e stafit tuaj mjekësor për të dhënë ndihmën në nxjerrjen e trupave nga rrënojat, ishte mbresëlënëse dhe jo vetëm. Si ishte eksperiencia juaj në Turqi?

Vendi ynë Shqipëria dhe Forcat e Armatosura iu përgjigjën menjëherë thirrjes për ndihmë, pas tërmetit shkatërrimtar në kufirin mes Turqisë dhe Sirisë që shkaktoi viktima të shumta, të plagosur dhe dëme të konsiderueshme materiale. Ishim pjesë e Misionit të ndihmës nga FA-ja dhe AKKMC, në përbërje të të cilit ne ishim rreth 73 efektiv, personel mjekësor, specialistë të kërkim-shpëtimit, efektiv mbështetës si dhe 7 mjete dhe u vendosëm në Malatya, Turqi. Unë isha njëkohësisht edhe komandanti i efektivëve të misionit të Forcave të Armatosura dhe personelit në ndihmë të popullit turk, ku ekipi shqiptar punoi fort për të shpëtuar njerëz nga rrënojat. Kemi përjetuar emocione të fuqishme në atë mision të cilat ishin të shumta, p.sh. i tillë ishte shpëtimi nga rrënojat i një fëmije 4-vjeçar, kur ekipi shqiptar ndërhyri menjëherë sapo dëgjoji zërin e të miturit, por dhe nëpërmjet çadrës mjekësore Rol 1 të hapur në Malatya, në kampingun tonë ku u kemi ofruar mbështetje dhe ndihmë mjekësore rreth 350 pacientëve turq.

Por përveç këtyre rasteve, kemi parë situata tepër dëshpëruese, që me mbërritjen tonë në Malatya, qytet me shumë ndërtesa të shkatërruara por dhe me shumë jetë të humbura. Operacioni ynë konsistonte në kërkim-shpëtimin. Ekip i FA-së kishte në përbërje të tij efektivë të specializuar në kërkim-shpëtimin, për nxjerrjen e njerëzve nga rrënojat.

Për kontributin e ofruar nga Qeveria Shqiptare, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, vendi dhe ekipi jonë u dekoruan dhe nga Presidenti i Republikës së Turqisë.

Kolonel, lidhur me situatën që po kalon vendi për sa i përket fushës së mjekësisë, burimeve njerëzore, a mund të themi se

jemi në një emergjencë, dhe siguria e jetës, e shëndetit, po cenon sigurinë kombëtare?

Këndvështrim i saktë nga ana juaj, dhe më pëlqen qasja se si e shtroni ju pyetjen. Them se po! Siguria e jetës, e shëndetit për një vend sigurisht që është pjesë e sigurisë kombëtare dhe duhet trajtuar si e tillë. Nëse siguria e jetës, e shëndetit të qytetarëve të vet, një vendi, apo dhe një qeverie “i rrëshqet nga duart”, nëse mund ta shprehim kështu, patjetër që cenohet siguria e kombëtare. Mjafton të kujtojmë këtu vetëm ditët e pandemisë të Covid-19 dhe ta lidhësh këtë me mungesën e

stafit mjekësor, gjë që fatmirësisht ne nuk u kërcënuam nga një mungesë e tillë.

Mendoj se nuk jemi momentalisht në një emergjencë, por ama jemi në prag të një emergjence për sa i përket shërbimit mjekësor në rang vendi. Është momenti që shërbimi mjekësor të trajtohet si një emergjencë kombëtare.

Duke qenë se ju jeni edhe pedagog në Universitetin e Mjekësisë, do ishte me interes mendimi juaj sidomos për mjekët e rinj, të cilët sapo mbarojnë studimet kërkojnë të largohen. Ndërkohë ligji i ri i miratuar së fundmi nga qeveria i detyron ata të japin kontributin e tyre për disa vite në Shqipëri. Cili do të ishte komenti juaj?

Është një vendim i drejtë, sepse kjo lidhet me atë që shpreha në përgjigjen e pyetjes tuaj pak më parë. Është një fushë po aq e rëndësishme, sa siguria dhe mbrojtja për shembull. Dhe për aq sa unë mendoj se mungesa e mjekëve mund të cenojë sigurinë e shëndetit të popullsisë së një vendi, qeveria duhet të marrë masat e saj. Kjo është ajo që po bën qeveria shqiptare, por kjo është edhe ajo që po bëjnë vendet e tjera në Europë e më gjerë teksa tërheqin Burimet tona të kësaj fushe.

Mendoj gjithashtu se është detyrë

sa morale dhe humane që një mjek t'i shërbejë vendit të tij. Ai gjithashtu ka nevojë personale t'i shërbejë vendit të tij, eksperiencës së tij në hapat e mëtejshëm. Sigurisht që sistemi mjekësor nga ana tjetër është një fushë që ka nevojë për shumë përmirësime, por mos harrojmë që janë bërë hapa të fuqishme në këtë sistem si në investimet në infrastrukturë dhe pajisje, por gjithashtu edhe në sistemin e pagave.

*"Spitali Ushtarak Qendror
Universitar mund të them
me bindje të plotë që
ishte krenaria e Forcave
të Armatosura. Krenari jo
thjesht në kuptimin se jam
unë mjek ushtarak, por
krenari kur të gjithë njerëzit
flisnin dhe flasin edhe
sot e kësaj dite, 'po shkoj
të trajtohem në Spitalin
Ushtarak, po shkoj të bëj
analizat në Spitalin ushtarak,
po shkoj të shtrohem në
Spitalin ushtarak se atje ka
mjekë dhe
përkujdesje mjekësore
më të mirë'".*

Zbatimi i Agjendës së Sigurisë Klimatike të NATO-s, sfidat dhe rreziqet

PËRSHTATI: MIMOZA GOLIKJA

Lufta e plotë e agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës nuk është sfida e vetme me të cilën po përballlet NATO. Ndërkohë kur korriku 2023 shënoi muajin më të nxehtë të planetit në histori, vapa rraskapitëse e verës së kaluar shkaktoi 20 000 vdekje vetëm në Evropën Perëndimore, kërcënoi infrastrukturën kritike ushtarake dhe civile dhe shkaktoi vendosje shtesë ushtarake në përgjigje të zjarreve të mëdha në pyje në të gjithë Evropën.

Kjo valë e të nxehtit dhe zjarret mesdhetare që mund të vendosë rekorde të reja të temperaturës dhe të çojë në rritje të thatësisë dhe reshjeve në pjesë të ndryshme të botës, po japin alarmin se pas vitit 2023 mund të jetë edhe më keq. Sipas një sondazhi të fundit të NATO-s, rreth 32% e qytetarëve aleatë e konsiderojnë ndryshimin e klimës si shqetësimin më të madh për sigurinë e tyre, para rrezikut të luftës, terrorizmit, paqëndrueshmërisë politike ose sulmeve kibernetike.

Ndërsa NATO i ka kushtuar vëmendje sfidave mjedisore prej më shumë se 50 vjet, kryesisht përmes një game të gjerë aktiviteteve kërkimore shkencore, deri vonë aleatët ranë dakord të ndërmarrin veprime konkrete. Në Samitin e Brukselit 2021, NATO i vuri vetes synimin për t'u bërë organizata kryesore ndërkombëtare kur bëhet fjalë për të kuptuar dhe përshtatur ndikimin e ndryshimeve klimatike në siguri dhe e mbështeti këtë ambicie me Planin e Veprimit për Ndryshimet Klimatike dhe Sigurinë. Plani i Veprimit identifikon rolin e NATO-s në fushën e ndryshimit të klimës dhe sigurisë përgjatë katër linjave të përpjekjeve: rritja e ndërgjegjësimit të aleatëve për implikimet e sigurisë të ndryshimeve klimatike; promovimi i përshtatjes klimatike në

të gjitha fushat e punës së NATO-s; zbutja e efekteve të saj, duke reduktuar emetimet ushtarake; si dhe rritja e kontaktit me aktorët e tjerë që janë aktivë në hapësirën e sigurisë klimatike.

Prioriteti, fokusi dhe vullneti politik, skepticizmi mbi klimën në personelin e mbrojtjes

Si një Aleancë e 31 vendeve sovraane (32, pas pranimit të Suedisë), NATO punon me konsensus. Në lidhje me adresimin e ndryshimeve klimatike, aleatët kanë këndvështrime të ndryshme. Ndërsa disa anëtarë të NATO-s duan që NATO të demonstrojë lidhshmëri në veprimin klimatik, të tjerët (veçanërisht disa aleatë nga Evropa Qendrore dhe Lindore) kanë shprehur frikë për shpejtësinë e tranzicionit të energjisë, madje edhe jashtë sektorit të mbrojtjes. Me luftën të ndezur në pragun e NATO-s, përmbushja e standardeve më të larta të reduktimit të emetimeve nuk është trajtuar me të njëjtën shkallë urgjence si ofrimi i mjeteve për mbrojtjen e Ukrainës, për forcimin e mbrojtjes kolektive të aleatëve kundër kërcënimit që paraqet Rusia. Ky ndryshim në këndvështrimin midis shteteve anëtare mund të paraqesë sfida për shpejtësinë dhe shtrirjen e përpjekjeve të NATO-s për të adresuar sfidat e sigurisë që lidhen me klimën. Mbajtja e momentit dhe parandalimi i devijimit do të jenë thelbësore. Për të siguruar që siguria klimatike të mbetet në krye të agjendës së NATO-s, është thelbësor fokusi dhe udhëheqja e qëndrueshme, nga stafi i lartë i NATO-s si dhe nga shtetet anëtare.

Nga ana tjetër perceptimet për urgjencën e veprimit klimatik ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme midis personelit ushtarak, nëpunësve civilë dhe ministrave, si dhe sipas vendit. Megjithatë ndërgjegjësimi i përgjithshëm dhe mbështetja për përshtatjen klimatike janë në rritje, disa personel ushtarak ende mbajnë qëndrimin se FA-të duhet të veprojnë të pakufizuar nga

objektivat mjedisore. Perceptimi mbizotërues se ekziston një kompromis midis marrjes së gjelbër dhe mbajtjes së një force të aftë, shoqëruar me frikën se presionet për dekarbonizimin e mbrojtjes mund të rezultojnë në një humbje të efektivitetit operacional, përbën një tjetër frenues për arritjen e ndryshimit organizativ.

Stepja ndaj rrezikut pengon po aq progresin. Përqafimi i inovacionit është thelbësor për përvetësimin, adoptimin dhe shkallëzimin e teknologjive të kursimit të energjisë. Programet e trajnimit dhe edukimit ushtarak, si dhe seminarët dhe prezantimet e synuara mbi përfitimet e iniciativave të qëndrueshmërisë, janë mjete të fuqishme për të përmirësuar njohuritë, ndryshimin e qëndrimeve dhe adoptimin e sjelljeve pozitive mjedisore. NATO tashmë përpaket të integrojë dimensionin e klimës në të gjithë spektrin e trajnimit dhe edukimit civil dhe ushtarak dhe shërben si një platformë ku aleatët mund të shkëmbejnë praktikatat më të mira dhe mësimet e nxjerra mbi përfitimet operationale të zgjidhjeve të gjelbra ushtarake. Ajo gjithashtu mund të përdorë diplomacinë e saj publike dhe mjetet e komunikimit për këtë qëllim.

Sfidat e ndërveprimit

Pothuajse e gjithë energjia e përdorur nga forcat e armatosura aleate sot blihet nga subjektet private dhe shpërndahet përgjatë linjave civile dhe tregtare, infrastrukturës dhe vendeve të depozitimit. Ndërsa shoqëritë e tëra/aktorët civilë largohen nga karburantet fosile, ushtria duhet të jetë e kujdesshme për të mos mbetur i vetmi sektor që vazhdon të mbështetet në naftë

dhe gaz. Vazhdimi i drejtimit të rafinerive dhe mbështetja e infrastrukturës së karburantit vetëm për një sektor mund të bëhet jashtëzakonisht e shtrenjtë, nëse jo e pamundur, dhe do të kërkonte një pjesë më të madhe të burimeve kombëtare. Prandaj, NATO njih rëndësinë që ushtritë aleate të mbajnë ritmin me tranzicionin e energjisë së gjelbër që është duke u zhvilluar në sektorin civil.

Janë ngritur shqetësime edhe për përputhshmërinë e karburanteve për përdorim ushtarak. Forcat e NATO-s aktualisht operojnë sipas një politike të vetme karburanti, e cila është projektuar për të thjeshtuar përpjekjet logjistike dhe për të përmirësuar ndërveprimin e pajisjeve. Sipas kundëradmiral Paul Beattie të Marinës Mbretërore, “ndërveprueshmëria dixhitale ka qenë gjithmonë e vështirë, por ne kurrë nuk na është dashur të shqetësohemi për ndërveprueshmërinë kur bëhet fjalë për karburantet”. Ndërsa disa anëtarë të NATO-s tashmë po investojnë në teknologjitë e gjelbra dhe po rregullojnë standardet e tyre të karburantit, të tjerë vazhdojnë të operojnë pajisje të vjetra. Nëpërmjet vendosjes së standardeve dhe shkëmbimit të praktikave më të mira, NATO është pozicionuar në mënyrë ideale për të ndihmuar në shmangien e divergjencave dhe për të siguruar që aleatët të përparojnë së bashku. Në Samitin e Vilnius, anëtarët e NATO-s ranë dakord të zhvillojnë një plan zbatimi për “Tranzicionin e Energjisë Ushtarake sipas Dizajnit”, kjo nismë do të përpaket të sigurojë që një tranzicion ushtarak larg lëndëve djegëse fosile të mos pengojë ndërveprimin





e forcave ushtarake aleate dhe as të ndikojë negativisht në efektivitetin operacional.

Risi e gjelbër e nxitur nga përpjekjet private

NATO do të ketë nevojë për ndihmën e sektorit privat për të përbushur objektivat e saj të dekarbonizimit. Ndërsa ushtritë nxitën përparimet teknologjike në të kaluarën, është sektori privat ai që kryeson zhvillimin e zgjidhjeve inovative me përdorim të dyfishtë që mund të përfitojnë potencialisht forcat e armatosura aleate sot, duke përfshirë edhe fushën e qëndrueshmërisë. Me përjashtim të kontraktorëve të mëdhenj të mbrojtjes, kompanitë private kanë qenë tradicionalisht të kujdesshme në lidhje me angazhimin ose ndarjen e të dhënave me sektorin e mbrojtjes. Kjo është veçanërisht e vërtetë për fillimet në fazat e hershme dhe ngritjet në shkallë. Procedurat burokratike dhe afatet e gjata kohore të prokurimit kanë qenë gjithashtu një faktor dekurajues. Mendimet besohet se janë zhvendosur pas pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia në vitin 2022, i cili nxiti shumë palë të interesuara private të përdorin burimet, aftësitë dhe ekspertizën e tyre në dobi të sigurisë kombëtare. Lufta ka vënë gjithashtu në pikëpyetje implikimet potencialisht problematike të kapitalit të huaj sipërmarrës në ndërmarrjet fillestare në të gjithë Aleancën, veçanërisht nga vendet që sfidojnë interesin dhe sigurinë e NATO-s, veçanërisht Kina. Fondi i Inovacionit të NATO-s (NIF), së bashku me Përshpejtuesin e Inovacionit të Mbrojtjes të NATO-s për Atlantikun e Veriut (DIANA), synojnë të kapërcejnë hendekun midis inovatorëve dhe ushtrisë, si dhe të zhblokojnë financimin shtesë që nisin, inovatorët e fazave të hershme.

Por në përpjekjet e tyre për t'u larguar nga lëndët djegëse

fosile, aleatët duhet të jenë të kujdesshëm për të mos zëvendësuar një varësi me një tjetër, veçanërisht në mineralet e papërpunuara kritike, të cilat janë thelbësore për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e teknologjive “të pastra”, si panelet diellore dhe qelizat e karburantit, si dhe sistemet moderne të armëve. Kina aktualisht dominon tregun global si në minierat ashtu edhe në përpunimin e tokave të rralla, duke siguruar deri në 98% të furnizimit të Evropës. Ndërsa shumica e anëtarëve të NATO-s ishin në gjendje të gjenin alternativa dhe të largoheshin nga burimet ruse të energjisë relativisht shpejt, shkëputja nga Kina është shumë më e vështirë. Anëtarët e Aleancës duhet të forcojnë qëndrueshmërinë e zinxhirëve të tyre të furnizimit, të përmirësojnë ndërgjegjësimin se ku qëndrojnë dobësitë më të mëdha, të diversifikojnë portofolet e tyre të importit dhe të miratojnë një qasje “6 Rs” për zbutjen e cenueshmërisë së zinxhirit të furnizimit: të rimendojnë, reduktojnë, zëvendësojnë, ridizajnojnë, riciklojnë dhe rishpërndajnë lëndët e para.

Stafi dhe burimet, e ardhmja

Duke pasur parasysh se përpjekjet e NATO-s për t'iu përgjigjur rreziqeve të sigurisë të lidhura me klimën janë relativisht të kohëve të fundit, dhënia e prioritetit ndaj ndryshimit të klimës duhet të shoqërohet me personelin dhe burimet e duhura. Që nga viti 2021, kur plani i veprimit i NATO-s për Ndryshimet Klimatike dhe Sigurinë erdhi në jetë, shtabi i NATO-s punësoi disa anëtarë të rinj të stafit dhe është bërë përparim i rëndësishëm për të rritur njohuritë dhe kapacitetet përkatëse në të gjithë organizatën. Qendra e NATO-s për Kërkimin dhe Eksperimentimin Detar (CMRE), një organ ekzekutiv i Organizatës së Shkencës dhe

Teknologjisë (STO), është gjithashtu në kërkim të shkencëtarëve të klimës. Qendra e ardhshme e Ekselencës për Ndryshimet Klimatike dhe Sigurinë (CASCOE), e cila do të organizohet nga Kanadaja dhe do të bëhet funksionale në vjeshtë të vitit 2023, pritet të përbëhet nga 35 anëtarë të stafit të përhershëm (si civilë ashtu edhe ushtarakë). Ndërsa NATO nuk mund t'i detyrojë aleatët individualë që të rrisin burimet dhe rekrutimin në hapësirën e sigurisë klimatike në nivel kombëtar, fakti tregon që deri në 11 vende sponsorizuese (përveç Kanadasë) nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit për të funksionalizuar CASCOE në Vilnius dhe u zotuan për dërgimin e ekspertëve kombëtarë në Qendër.

Programi Shkencë për Paqe dhe Siguri (SPS), i cili financon veprimtari shkencore bashkëpunuese midis anëtarëve dhe partnerëve të NATO-s, po e drejton gjithnjë e më shumë vëmendjen dhe financimin e tij drejt sigurisë mjedisore. Në vitin 2022, 17 për qind e aktiviteteve të miratuara përqendroheshin në kërkime dhe shkëmbime njohurish në fushën e klimës dhe sigurisë. Në vitin 2023, projekteve që fokusohen në sigurinë mjedisore dhe energjitike iu dha prioritet më i madh për financim. Së fundi, si Fondi i Inovacionit të NATO-s (NIF) ashtu edhe Përsheptuesi i Inovacionit të Mbrojtjes së NATO-s për Atlantikun e Veriut (DIANA) kanë një komponent të gjelbër. DIANA u bë funksionale dhe nisi thirrjen e saj të parë për propozime në qershor 2023, me elasticitetin e energjisë që përbën një nga tre fushat prioritare të fokusit. E gjithë kjo tregon se aleatët, pavarësisht nga pikëpamjet dhe prioritetet konkurruese, vazhdojnë të marrin shumë seriozisht rreziqet mjedisore ndaj aktiviteteve të tyre ushtarake.

Ndërsa do të kërkohet një ndryshim kulturor brenda sektorit të

mbrojtjes, promovimi i njohurive më të mëdha për ndryshimet klimatike është thelbësor në të gjithë sektorët e shoqërisë, jo vetëm në mbrojtje.

Pavarësisht sfidave ekzistuese, NATO, në nivel organizativ, ka bërë shumë përparim që kur miratoi Planin e Veprimit për Ndryshimet Klimatike dhe Sigurinë në vitin 2021. Samiti i Vilnius shënoi një moment historik të rëndësishëm në rrugëtimin e NATO-s drejt bërjes së organizatës ndërkombëtare udhëheqëse kur bëhet fjalë për kuptimi dhe përshtatja ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike në siguri. U publikuan tre raporte kryesore, secili duke trajtuar një shtyllë të veçantë të Planit të Veprimit të NATO-s për Ndryshimet Klimatike dhe Sigurinë. Për sa i përket zbutjes, i cili konsiderohet si elementi më ambicioz i agjendës së sigurisë klimatike të NATO-s, zhvillimi i një metodologjie uniforme për llogaritjen dhe analizimin e emetimeve ushtarake të GHG-ve të Ndërmarrjes së NATO-s, e cila u publikua në Samitin e Vilnius këtë vit, është një hap i rëndësishëm për të ndihmuar NATO-n të arrijë objektivat e saj për reduktimin e emetimeve.

Me tranzicionin e energjisë në lëvizje të plotë (të përshpejtuar nga lufta në vazhdim dhe kriza globale energjetike) përpjekjet rreth vlerësimit të emetimeve ushtarake, shkëmbimit të praktikave më të mira dhe zhvillimit të Tranzicionit të Energjisë të NATO-s sipas Dizajnit tregojnë se NATO po mendon për të ardhmen e dizajnit të forcës mes ndryshimit të klimës dhe objektivat zero neto, që kërkon të ndihmojë në shmangien e divergjencave dhe të sigurojë që aleatët të përparojnë së bashku. Dekarbonizimi ushtarak dhe qëndrueshmëria e secilit aleat individual, dhe kështu qëndrueshmëria e Aleancës në tërësi, janë të ndërthurura tani më shumë se kurrë.



"NJË DITË TAKOVA NJË FËMIJË TË VERBËR. MË KËRKOI T'I PËRSHKRUAJA DETIN, UNË DUKE E PARË IA PËRSHKROVA. PASTAJ MË KËRKOI T'I PËRSHKRUAJA BOTËN, DHE UNË DUKE QARË E GËNJEVA"

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit
të Botimeve



Askush nuk do ta kuptonte këtë jetë nëse nuk do të përballej para saj me realitetin e së vërtetës. E ndërsa bëjmë moral, nga mëngjesi në darkë, nga ana tjetër, rendim si individë me ndërgjegje të frustruar, duke i rrahur krahët imoralit e intrigantit, si të frikur e pa identitet.

Sot po jetojmë mes shumë padrejtësive, mes imoralitetit, mes padijes, mes heronjve shterpë, e heroinave të stilit trojan, mes gënjeshtres, mashtrimit, horrave e hajdutëve, intrigantëve e hipokritëve, histerikëve e të frustruarve, të cilët njëherazi hedhin litarët të të tërheqin në habitatin e tyre, të pistë e të neveritshëm. Vetes - Hija e së shkuarës na ndjek pas, sado të mundohemi të baltosim të tjerët, balta që ka ngjitur prej bëmave ndër vite nuk ç' ngjitet më.

Të ndërtosh kështjella ditën me intrigat e natës, të ndërtosh ide mbi të kundërtën e mendimit, do të thotë të bësh filozofi, mbi bazat e asgjësë dhe për asgjë, por në shërbim të vetes.

Mund t'i shërbejmë në 1001 mënyra, por ajo që do të na shërbente vërtet është që ta ndërtonim veten me ndihmën e vetes, jo duke vënë në shërbim të vetes më të keqen e vetes dhe të të tjerëve.

Ndoshta e gjitha kjo do të ishte e pamundur në një botë si kjo... Ndoshta individë të tillë edhe i shërbejnë botës, na shërbejnë të

gjithëve, ndryshe nuk do të mësonim të keqen, të ligën, nuk do të dinim nga se të mbroheshim dhe si të mbroheshim, ndoshta me specie të tilla duhet të 'luftosh' por jo të mendosh që s' duhet të ekzistojnë, ndoshta ekzistenca e tyre na bën më të fortë, përballë figurës së tyre të mjerë.....

Ndaj bota është e bukur, kur je i pastër, i drejtë, i formuar, i moralshëm ke fuqinë të luftosh me çdo "hienë" që të del para. Kam dashur të besoj se në thellësinë e fundme të Njeriut dhe të Njerëzores ka sidoqoftë një shkëndijë të së Mirës, që si edhe na mësojnë Librat e Shenjtë të çdo feje, e kemi dhuratë Hyjnore që në ngjizjen tonë më të hershme.

E pra, kjo shkëndijë duhet të vendosë një Cak, një tavan, përtej të cilit, pa kuptuar se si, të bërit keq për qytetin, fshatin apo detin tënd, duhet të bërtasë diku në brendësi të këtyre krijesave mëkatore.

Duke respektuar mosbesimtarët, që këtë shkëndijë nuk e njohin, do të doja të besoja se, së paku arsyeja e shëndoshë do të bërtiste edhe ajo.

Në shumë filma hollivudianë, heronj imagjinarë kthehen pas në kohë përmes makinave të kohës të së ardhmes dhe korrigjojnë krimet e së shkuarës, duke dashur të shmangin tragjeditë e të sotmes apo të së nesërme së tyre. Këta personazhe, duke u kthyer pas në kohë, këpusin disa nga hallkat e zinxhirit të së Keqes, që buron kryesisht nga makutëria njerëzore, duke korrigjuar në mënyrë inteligjente dhe të arsyeshme historinë njerëzore të një shekulli më pas.

Mos u nxitoni të më kujtoni që Makina e Kohës nuk është shpikur ende.

Jeta dhe dimensionet e saj

Ndërkohë që arrijmë rekorde historike në të gjitha fushat, në shëndetësi, në përhapjen e informacionit, në afatin e zhvendosjes nëpër botë apo të shfrytëzimit të burimeve të jetësore, Njeriu s'ka njohur kurrë kaq shumë varfëri dhe mjerim.



Jeta e sotme nuk është më e jona. Jetët tona nuk na përkasin më. Kjo e fundit është kthyer në kompeticion. Njeriu nuk formon më një grup që tenton të rrisë nivelin e tij të ndërgjegjes, por përpiket vetëm të përmirësojë të përditshmen, të cilën gabimisht kujton se e kontrollon. Kjo na çon drejt bindjes që nuk është padrejtësia ajo që i bën miliona fëmijë të vdesin nëpër botë, kryesisht në Afrikë, edhe pse ky kontinent është më i madhi dhe më i pasuri nga të gjithë. Jeta e sotme është materiale dhe jo shpirtërore, prona personale e bën poseduesin të dominojë të varfrin dhe hierarkia e vendosur e bën pasurinë, ëndrrën e gjithë atyre që vazhdojnë e besojnë te ky sistem.

Jeta e sotme është sipërfaqësore, vlerat e vërteta kanë humbur dhe bota po bëhet gjithnjë e më pak “njerëzore”. Lehtësitë e komunikimit dhe rrjetet sociale na lejojnë të zgjedhim presidentë, të deklarojmë luftëra, të ndajmë grupet njerëzore dhe komunitetet në minoritete që përpiken të mbrojnë grupin e tyre të vogël, në vend që të grumbullohen aty ku bashkimi i popujve do të ishte e vetmja rrugë. Jeta e sotme është një gënjeshtër dhe kjo gënjeshtër institucionalizohet në formën e edukimit kombëtar, një propagandë e gjerë në shkallë botërore, e cila tenton të përgatisë të ardhmen e brezit të ri, i cili e pranon botën e imponuar. Jo nga vullneti i gjithëfuqishëm i një grupi që pretendon të dominojë, por nga pamundësia e shumicës dërrmuese për të dalë nga dominimi i shëmtuar. Individë të shndërruar në ekuacione ekonomike, të joshur nga përdorimi i teknologjive të reja dhe të paaftë të mendojnë për botën që po vjen apo për jetën që i pret. Ndoshta, këtij shekulli i mungojnë filozofët, ata që do të mund të na ofronin një shteg të ri drejt një jete më të mirë!

Jeta e sotme është forma më e re e skllavërisë, tani skllavërit nuk kanë më ngjyrë. Na thonë se duhet të shkojmë në shkollë

deri në moshën 20-vjeçare, të punojmë 30 vjet për të pajisur shtëpinë, të cilën do të na duhen 15 vjet për ta paguar, të punojmë për makinën, të cilën do të na duhen pesë vjet për ta paguar dhe të përballojmë jetën e përditshme që është gjithnjë e më e shtrenjtë. Dhe kur lodhemi e sëmuremi nga kjo jetë, vijat e përgjithshme të së cilës janë konturuar tashmë, sistemi ka mirësinë të na shpjegojë se vitet e fundit na përkasin dhe mund të vdesim të qetë. Jeta e sotme është e kundërta e asaj që pretendojmë, e kundërta e asaj për të cilën luftojmë. Ajo është një sfidë për t’u përballuar, një faqe të cilën fëmijët tanë ndoshta, do të përpiken ta fshijnë nga kujtesa.

Ne jemi sipërfaqësorë, fodullë, të zhveshur nga çdo lloj qëndrimi kritik, të kushtëzuar gjithandej dhe më e keqja, krenarë për këtë. Të papunin e gjejmë ngaqë nuk punon, atë që ka punë e konsiderojmë të privilegjuar, ndërsa pensionistin e shohim si dikë që është mënjeluar herët nga shoqëria.

Jeta jonë, është gjithashtu e vetmja shpresë e jona: trashëgimia që na kanë dhuruar shekuj të tërë histori dhe që së bashku po e përmirësojmë, në këtë botë globale e të kushtëzuar dhe mjetet që ne disponojmë për të komunikuar e për t’u organizuar janë më të fuqishme se çdo lloj arme. S’na mbetet tjetër, veç të mësojmë t’i përdorim me zgjuarsiri.

“Një ditë takova një fëmijë të verbër. Më kërkoi t’i përshkruaja detin, unë duke e parë ia përshkrova. Pastaj më kërkoi t’i përshkruaja botën, dhe unë duke qarë e gënjeva”, mes lotësh dhe dhimbjes që e vërteta e hidhur lë pas, një buzëqeshje e bukur me kaploi fytyrën teksa pashë fëmijën me dritën e syve të fikur, por atë të shpirtit gati të shpërthente lumturie prej ‘Përrallës’ së bukur që dëgjoi për inekzistencën jetë reale!

Kjo është bota e një të verbri! A nuk është e bukur!?...

“Një popull që ka harruar të kaluarën e tij është i DËNUAR TË HUMBASË”

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit
të Botimeve

Lufta përmes syve të fëmijëve modernë

Kujtim i çuditshëm njerëzor, shqiptarët e moshës 40 vjeç e lart janë të fundit për të cilët fjala “luftë” do të thotë një luftë shumë specifike.

Në fund të fundit, është fare e qartë se lidhja e kohërave është prishur. Se kodet kulturore të përbashkëta për të gjithë njerëzit e moshës dyzet e më shumë (dhe prindërit e tyre që tashmë kanë vdekur) po vjetërsohen para syve tanë, duke vdekur si një bisht atavist. Kështu funksionon evolucioni, e panevojshmja zhduket. Përveç kësaj, ne duhet të jemi realistë, nuk ka gjasa që gjatë luftës së ardhshme patriotike, nëse ndodh një e tillë, ne do të jemi në gjendje të godasim armikun me një bajonetë, të hedhim veten mbi tank me një granatë ose të ngrijmë si një shtyllë e gjallë, akull nga fakti që armiqtë do të na derdhin ujë të ftohtë në të ftohtë të hidhur. Lufta botërore e së ardhmes do të jetë krejtësisht ndryshe, më teknologjike, ose postmoderne. Nëse do të jetë...

“Por, megjithatë, diçka më shqetëson...”



Është fare e qartë se lidhja e kohërave është prishur. Se kodet kulturore të përbashkëta për të gjithë njerëzit e moshës dyzet e më shumë (dhe prindërit e tyre që tashmë kanë vdekur) po vjetërsohen para syve tanë, duke vdekur si një bisht atavist.

Kur ishim duke u rritur, ne dinim shumë për luftën që nga kopshti, lexuam shumë, dhe vazhdimisht shfaqnin filma për luftën në TV, shpesh kishte shfaqje në radio, luanim luftë, vizatuam luftën, na vinin veteranët në shkollë... Dhe gjyshërit tanë na tregonin për luftën, për bllokadën, dhe fëmijët tanë, më duket, ata disi janë larg nesh pafundësisht në këtë drejtim. Ndoshta ne vetë jemi fajtorë për këtë, ose ndoshta jo vetëm ne...”. Ndoshta, për ta, këto janë ngjarje afërsisht po aq të largëta...

Epo, fëmijët e sotëm do të dinë diçka tjetër, dhe më pas... A e nderon njëri prej nesh kujtimin e të rënëve në betejat e përgjakshme? Kjo është!

Është e trishtueshme, por e natyrshme.

Por sa janë gjallë veteranët, ne kemi mundësinë t'u shpjegojmë fëmijëve se çfarë është “lufta”.

A është e mundur që kaq shumë të ketë ndryshuar, sepse në Shqipëri “nuk ka familje të tillë, ku heroi i saj nuk mbahet mend...”.

Teorikisht e di temën, por ato nuk mund të përballojnë të gjithë globalitetin e asaj tragjedie, natyrisht.

Gjithçka varet nga familja, se si familja ua përcjell fëmijëve kujtimin e luftës.

Djali im 17 vjeç, është gjithashtu shumë i interesuar për luftën. Përpiqem t'i shpjegoj, i them, ai shpesh shikon filma lufte, dëgjon historitë e stërgjyshërve të tij...

Ndoshta, pas disa dekadash, fëmijët do të



dinë fare pak për këtë luftë.

Kjo, më duket, do të jetë një parakusht i drejtpërdrejtë për fillimin e një lufte të re, edhe më të tmerrshme...

Po, mjerisht, kujtesa zbehet në të kaluarën...

A jemi në rrezik të amnezisë masive?

Një popull që ka harruar të kaluarën e tij është i dënuar të humbasë!

Nuk e di, ndoshta është gjaku që të bën të perceptosh me kaq dhimbje gjithçka që lidhet me luftën, por edhe me revolucionin. Unë jam e qetë për fëmijët e mi, ata do të dinë shumë për luftën. Këtu, unë thjesht dua që ata të mos jenë në mesin e bashkëmoshatarëve të tyre "korba të bardhë"... Për mendimin tim, nuk ka rrugë tjetër. Dhe si mund të harrohet kjo në vendin tonë, nuk e kuptoj këtë! Është e pamundur ta harrosh!

Dhe unë mendoj se Lufta duhet marrë seriozisht.

"Pse ky Hitleri hoqi çatinë e tij dhe shpërtheu gjithë botën?"

Këtu është gabimi ynë kryesor prindëror, ne nuk dimë se çfarë të përgjigjemi, por është e mundur dhe shumë, shumë e nevojshme t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje. Do të jetë e vështirë, në mënyrë që pa lodhje, gradualisht të fillojë të njihet me historinë, konceptin e ideve nacionaliste dhe veçoritë e zhvillimit të tyre, etj.

Dhe çfarë dinë nxënësit e shkollës për luftën? Çfarë dinë ata për stërgjyshet dhe stërgjyshërit e tyre, si shkoi lufta në jetën e tyre?

Unë mendoj se njerëzit e sotëm, rinia moderne nuk janë si ata që luftuan në Luftën e Madhe Patriotike. Tani të rinjtë mendojnë në një mënyrë krejtësisht tjetër, tani ka një jetë krejtësisht të ndryshme, hobe të tjera, teknologji të tjera... Por nëse një luftë ndodh papritur, rinia do të shkojë në luftë në të njëjtën mënyrë dhe do të mbrojë vendin në të njëjtën mënyrë, si brezi që luftoi kundër fashistëve. Edhe pse, nëse fillon lufta, do të jetë krejtësisht ndryshe. Do të ishte më mirë, sigurisht, nuk ishte. Por,

gjithçka varet nga politikanët.

Por, i jam shumë mirënjohëse të gjithë veteranëve, gjithë brezit të vjetër që e mbrojtën vendin tonë.

Mendoj se edhe sot njerëzit nuk kanë më pak patriotizëm se sa kishte populli atëherë.

Respekt dhe mirënjohje për veprën tuaj, Veteranë të LANÇ.

Gëzuar 66-vjetorin e krijimit të Organizatës së Veteranëve dhe Pasardhësve të LANÇ-it, të popullit shqiptar "Nderi i Kombit"!

Krenohemi me gjithë kontributorët që morën pjesë aktive në formacionet partizane në mal.

Krenohemi me të gjithë atdhetarët që i shndërruan shtëpitë e tyre në spitale partizane dhe vetë shërbyen me të gjithë dashurinë dhe kujdesin njerëzor si personel ndihmës i mjekëve të LANÇ-it.

Uroj të gjithë Pasardhësit e Veteranëve të LANÇ-it, Gëzuar Ditën e Veteranëve! Qoftë i Paharruar 20 korriku në Brezë!

“Të jesh grua në Shqipëri është punë burrash”

Fisnikja, e bukura, forca, kanë një emër: “Grua”

“Të jesh grua në Shqipëri është punë burrash”, teksa në hulumtimet e mija mes qindra opinionesh të ndryshme mbi femrën shqiptare, por jo vetëm, hasa këtë shprehje, “e bukur, e trishtë por e vërtetë!”, - mendova.

Por si shihet femra, qeliza që lind jetën?

Gruaja, kjo qenie e brishtë, hyjnia e bukurisë së lashtësisë (Afërdita e grekëve të lashtë apo Venera e romakëve) në këtë gen duhet të jetë njeriu që përballët gjithëherët me tragjiken.

Historia e këtij kombi të dhunshëm e agresiv, të cilit i përkasim, gjithmonë femrën e ka pasur kultin e mundimeve, të punës dhe të fljimeve.

Është pjella që nuk trashëgon prej trungut të saj familjar të drejtën e pronësisë së mbiemrit të lindjes. (Madje as të drejtën e pronës që nga Kanuni i Lekë Dukagjinit: “Gruaja shqiptare farë trashëgimit s’ka tek prindja, as më plang, as në shpi - kanuja e xen gruen si një tepçicë në shpi”). Shprehje të tilla si: “vajza është derë e huaj”, “djali i saj është i huaj, nuk trashëgon si djali i djalit mbiemrin e trungut familjar të nënës”, “vajza sjell një derr në shtëpi (dhëndrin) e shqyrr zotit që e martuam”, etj., janë shprehje të hapura të një racizmi të trashëguar nga patri-



GRUAJA, FIGURA MË TRAGJIKE E FAMILJES, KISHTE E KA PRIVIME TË VAZHDUESHME NGA TË DREJTAT E SAJ. SHPREHJE TË TILLA SI: “GRUAJA ËSHTË ME SHPATULLA PAS MURIT”, “MBYLL GOJËN SE ËSHTË TURP, JE FEMËR”, NËSE NUK TREGOJNË DISKRIMINIM SOCIAL DHE DHUNË PSIKOLOGJIKE MBI FEMRËN, ÇFARË TJETËR TREGOJNË?

arkaliteti që himnizon mashkullin.

Pra, qenia e saj e mbyt familjen që lindjen e vet. Një karakteristikë që shpreh psikologjinë e pritjes së një fëmije të sapolindur është zakoni i të shkrepurit të pushkës me lindjen e djalit dhe heshtja totale me lindjen e vajzës në të kaluarën e ndofta edhe sot në një pjesë të madhe të shqiptarëve.

Në kohën e Komunizmit në Shqipëri shumë baballarë nuk i afroreshin maternitetit kur gruaja e vet lindi vajzë. Ndër kohëra të vjetra e deri më sot për shqiptarin ndryshe përjetohet lindja e një djalit për pushkë dhe ndryshe lindja e një vajze për punë.

Sa tragjike ardhja e një gruaje në jetë!

“Mjerë ti o e shkretë, që lindi femër!”, - vajtonin nënat tona të sunduara nga pushteti i patriarkalitetit.

Gruaja, figura më tragjike e familjes, kishte e ka privime të vazhdueshme nga të drejtat e saj. Shprehje të tilla si: “Gruaja është me shpatulla pas murit”, “Mbyll gojën se është turp, je femër”, nëse nuk tregojnë diskriminim social dhe dhunë psikologjike mbi femrën, çfarë tjetër tregojnë?

Të lindësh grua në Shqipëri ku një në tre femra dhunohen fizikisht dhe dy në tre psikologjikisht është vërtetë tragjike. Të lindësh grua në Shqipëri do të thotë të mos mundesh të jetosh pa çatinë e një mashkulli babës, vëllait, burrit.

Pa një çati të tillë gruaja është lëneshë,



e padenjë, e pamoralshme, e fëlliqur, e mjerë, qyqare e ku di unë, gjithfarë epitetesh fyese, përulëse e keqardhëse, një klasë shoqërore në moshë të mesme ndër më të përçmuarat, më të përbuzurat nga shqiptari.

Pothuajse asnjë shqiptar akoma edhe sot në shek. XXI nuk mund të konceptojë një grua të vetme në shtëpi larg babait, vëllait e të afërmve nëse është e pamartuar, ose nuk bashkëjeton me dikë.

Të gjitha vajzat shqiptare të pamartuara në Shqipëri edhe për shkak të mungesës së të mirave materiale, pasi gruaja paguhet minimalisht në Shqipëri për të përballuar e vetme jetën, jetojnë me prindërit nën klimën e nënshtrimit të pretendimeve prindërore për shërbim dhe privimit të lirive të saj jetësore.

Ashpërsia dhe vrazhdësia tragjike mbi femrën e konsoliduar prej shekujsh në ndërgjegjen shqiptare gjen mishërimin e vet në figura të grave që shndërrohen në burra për të shpallur pavarësinë e tyre të fortë ndaj kësaj shoqërie që edhe sot e kësaj dite kërkon të shndërrojë identitetin e saj të ëmbël në fortësi me fjalën “burrneshë” në Veri e “kapedane” në Jug.

Gra, që shfaqeshin përkrah burrave me kobure në brez edhe në kohë paqeje, pinin duhan e uleshin këmbëkryq në Kuvende (të drejta këto që nuk i gëzonte asnjë grua me burrë), duke hequr dorë përfundimisht nga të qenit grua. Gra-burra për nga forca dhe vrazhdësia, ndofta edhe më arrogante se edhe vetë burrat, si disa prej femrave të sotme në Kuvendin e Shqipërisë. Një lloj i shëmtuar njerëzor, i larguar nga e natyrshmja për shkak të instinktit të vetëmbrojtjes në këtë mjedis agresiv.

Kultura e të qenit femër në Shqipëri është ajo e një dhune psikologjike dhe sociale, që mjedisin e mbush me mllef, nëse i duhet dikur të rebelojë (pasi ku mungon reforma nis revolucionin), nëse nuk pranon kuadrin e përgjithshëm në të cilin kjo shoqëri kërkon ta vendosë dhunshëm. Një rebelim i tillë është divorci.

Pasoja që sjell, përveç “vdekjes së vogël”

të jetës së kaluar, shpesh për t'i dhënë fund një stresi të vazhdueshëm që pjell çrregullime psikologjike e në raste ekstreme edhe psikike, sjell edhe një jetë të konsideruar si të pasuksesshme në vazhdim, pra një diskriminim të ri social ndaj femrës. “E la burri të shkretën. Kush dreqin e di ç’i ka bërë qyqarit!” Një tjetër tragjedi sociale nis. Një femër për t’u treguar me gisht, për t’u sulmuar prej të gjithë aventurierëve të një ndërgjegjeje të pashpirt. Një tjetër viktimitë-femër që duhet të shndërrohet në burrë për të mbijetuar...

Kultura e të qenit femër në Shqipëri sot lidhet me një stereotip të ri njerëzor që duhet të kapërdijë hidhërimin e tradhtive të bashkëshortit bashkëkohor me “dinjitet”. I duhet të mos ulërijë, pasi ky është mashkulli i suksesshëm për shqiptarin që ka nisur të mëkëmbet ekonomikisht përballë një femre, që nëse do ta tradhtonte të shoqin, shoqëria e “moralit” në Shqipëri do ta dënonte tmerrësisht ashpër, nën gjykimin “e drejtë” si të përdalë, të pamoralshme, të pandershme e gjithçka vulgare. Për të njëjtin mëkat qëndrimi social sigurisht që do të ishte edhe këtu diferencial. Burri, kjo qenie kaq e adhuruar prej vetvetes në jetën shqiptare do të quhej i zoti, ndërsa gruaja e ndyrë dhe e pështirë.

Shpesh qëndrimet mohuese e ndëshkuese ndaj femrës arrijnë deri në hakmarrje. Sa krime për “motive të dobëta” realizohen në Shqipëri për tradhtinë bashkëshortore! Madje nga burra që kanë tradhtuar kush e di sa herë gruan e tyre. Pa analizuar aspak arsyet dhe pasojat, shqiptari kalon përherë në ekstrem me “krenarinë” mashkullore dhe “fëlliqësinë” femërore. Sa marrëdhënie të dyfishta e shpesh të shumëfishta?!

Dukuri të reja sociale, ndofta edhe të vjetra, por tashmë tepër të shfaqura haptazi. Në gjithë këtë absurditet mentaliteti të ashpër, dënues e brutal vlen

të përmendet koncepti i flijimit femëror bazuar mbi konceptin nder dhe krenari në Shqipëri.

E ndershme për ndërgjegjen sociale është femra që nuk bën dashuri, krenar është mashkulli që ka një listë të gjatë femrash në triumfet e veta. Por, të dyja këto raste janë profile psikologjike të sëmurura në jetën seksuale të njeriut, nëse mungesa e seksit është absolute për femrën dhe poligamia qëllim në vetvete për mashkullin.

Eja dhe shuaja shqiptarit absurd e agresiv tabunë sociale të seksit, pa ekuilibrimin shpirtëror. Eja dhe thuaj shqiptarit se koncepti i “burneshës” apo “kapedanes” e shndërron femrën në mashkull e pasoja e parë dhe më e rrezikshmja është lindja dhe rritja e një mashkulli të pasigurt, frikacak e të dobët në shpirt që vishet me petkun e një agresori të dhunshëm social. Si t’i thërrmosh këto koncepte sociale të rrënjosura tashmë në ndërgjegje të sëmurë?

Padyshim koncepti i gruas si një qenie sublimë, e cila duhet respektuar me brishtësinë e saj, me bukurinë dhe mirësinë e saj, pasi është pikërisht ajo që i jep kuptimin e forcës dhe lumturinë një mashkulli, është pikërisht terapia sociale.

Shqiptari i sotëm ndodhet përballë një femre të lirë e të pavarur, e cila ka nisur të çlirohet prej mbetjeve patriarkale të së shkuarës. Kjo barazi e huton disi mashkullin shqiptar, i cili vjen prej një piedestali të rrënuar të një mbetjeje patriarkale të lodhur.

Dominuesi, i plotfuqishmi, kryelarti tashmë ndihet inferiori që nuk mund të vendosë pa pushtetin dhe dominimin, nuk mund të bashkë-vendosë. Dhe këtu ai përdor dhunën fizike apo psikologjike.

Gruaja, që sipas Kanunit në martesë kishte për detyrë: “me i ruejt nderën burrit, me i rrogue pa zhibla, me i nde-

jtë nën sundim, m’u përgjegj detyrve të kunorës, me rritë e me mkambë fmin me nderë, me i ndejë gadi me të veshmen e të mathmen, mos me iu përzie në fejes të të bijve e bijave”, sot është qenia sublimë që i jep kuptim jetës së tij dhe kërkon respekt e vlerësim.

Martesa, që deri dje ishte “m’u ba shpi, me ia shtue shpisë një rob ma tepër, sa për krah t’punvet, sa për t’shtuem t’fmivet”, sot është bashkë-udhëtim i ëmbël dhe paqësor, cilësor dhe sublim, të paktën teorikisht për një marrëdhënie të shëndetshme. Nëse nuk është i tillë, nuk zgjat për gjithë jetën dhe detyrimisht është traumatik. Pa dyshim që janë tronditur themelet e tij të ekzistencës në këtë kohë të re dhe si në çdo tranzicion udhët janë të paqëndrueshme. Si adoleshent social mrekullohet e mahnitet me ndryshimet e femrës shqiptare, por përsëri luhetet në pasigurinë e gjetjes së vetvetes në të ardhmen.

T’ju them të drejtën, më dhimbset kjo qenie e brishtë që në dukje është kaq e ashpër, e egër dhe agresive që përpëllitet për të gjetur ekuilibrin shpesh me dhunë, shpesh me pendime...

Nuk është aspak e lehtë të tejkalohet vetvetja, por jo edhe e pamundur! Mjafton të jetë i duruar, i dhembshur, tolerant e mendje hapur. Të mos shohë si kërcënim për humbjen e pushtetit një femër që ka të drejtë të jetë përkrah tij me dinjitetin që i takon dhe jo me antagonizëm.

Gruaja nuk mund të jetë kurrë fatkeqësi e domosdoshme e realitet tragjik. Ajo, e bukura, e mira, lozonjarja, e duruara, e dhembshura është bekim për shoqërinë.

Prej saj nis jeta, prej saj nis edhe një shoqëri më e mirë, sepse është ajo që ka në duar të ardhmen e fëmijëve të vet, e këta të fundit të ardhmen e këtij vendi duke pasur nevojën jetike për mirëkuptim ndaj njëri-tjetrit.

GRUAJA,

liderja e së tashmes dhe së ardhmes

Gratë kanë shërbyer në ushtri në shumë role të ndryshme në juridiksione të ndryshme gjatë historisë.

Gratë në shumë vende nuk janë më, të përjashtuara nga disa lloje të misionëve luftarake si pilotimi, mekanika dhe oficerët e këmbësorisë.

Që nga viti 1914, në ushtritë perëndimore, gratë kanë shërbyer në numër më të madh dhe role më të ndryshme se më parë. Në vitet 1970, shumica e ushtrive perëndimore filluan t'i lejonin gratë të shërbenin në detyrë aktive në të gjitha degët ushtarake. Në vitin 2006, tetë vende si (Kina, Eritrea, Izraeli, Libia, Malajzia, Koreja e Veriut, Peruja dhe Tajvani) rekrutuan gratë në shërbimin ushtarak. Në vitin 2013, Norvegjia u bë vendi i parë i NATO-s që dërgoi gra, si dhe vendi i parë në botë që rekrutoi gratë me të njëjtat kushte formale si burrat.

Në vitin 2017, Suedia ndoqi shembullin dhe në vitin 2018, Holanda iu bashkua këtij formacioni (megjithëse në Holandë nuk ka rekrutim aktiv në kohë paqeje).

Që nga viti 2022, vetëm tre vende rekrutuan gra dhe burra me të njëjtat kushte formale: Norvegjia, Suedia dhe Holanda.

Disa vende të tjera kanë ligje që lejojnë rekrutimin e grave në forcat e tyre të armatosura, megjithatë me disa dallime të tilla si përjashtimet nga shërbimi, kohëzgjatja e shërbimit, etj.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, Shtetet e Bashkuara ishin në përpjekje të përgjithshme luftarake.

Çdo person duhej të kontribuonte në përpjekjet e luftës, megjithatë, kjo nuk do të thoshte domosdoshmërisht se të gjithë duhej të luftonin. Vendi duhej të vazhdonte të financonte trupat e tij dhe të mbështeste luftën financiarisht ndërsa ushtarët



po luftonin. Për këtë qëllim, Shtetet e Bashkuara u mbështetën në organizata të ndryshme që merreshin me mbështetje.

Gratë iu bashkuan organizatave të tilla si Komiteti për Informim Publik për të edukuar njerëzit për luftën. Ky komitet promovoi edhe nacionalizmin.

Përveç punës në komisione që kanë të bëjnë me arsimin, gratë kanë punuar në të gjitha llojet e pozitave. Shumë gra u bënë anëtare të YWCA dhe shkuan jashtë shtetit për të ndihmuar ushtarët. Kjo ishte hera e parë në histori që gratë e të gjitha klasave po punonin së bashku për të ndihmuar përpjekjet e luftës. Gratë e shtresës

së lartë themeluan shumë organizata vullnetare të luftës, ndërsa gratë e klasës së mesme dhe të ulët punonin në këto organizata duke punuar si infermiere ose duke plotësuar punët e burrave.

I vetmi komb që vendosi trupa luftarake femra në një numër të konsiderueshëm ishte Rusia.

Që nga fillimi, rekrutet femra ose iu bashkuan ushtrisë të maskuara ose pranoreshin në heshtje nga njësitë e tyre.

Ndoshta më e shquara ishte, një kontingjent i kalorësisë së lehtë të vijës së parë në një regjiment kozak të komanduar nga një kolonel femër, Alexandra Kudasheva.

Zonja Kolonele, Alexandra Kudasheva ishte komandantja e një regjimenti të kalorësisë së lehtë ruse nga 1915 - 1917, gjatë Luftës së Parë Botërore dhe gjithashtu gjatë Revolucionit Rus. Ky regjiment kalorësie mund të ketë qenë regjimenti i parë i integruar gjinor në historinë ruse. Ajo u shqua gjithashtu për bëmat e saj të kalërimit të qëndrueshmërisë.

Maria Bochkareva, e cila u dekorua tre herë dhe u gradua në gradën e nënoficerit të lartë. Në vitin 1917, Qeveria e Përkohshme ngriti një numër "Batalionesh të Grave", me komandën e një komisioni oficerësh me në krye Maria Bochkarevan. Ato u shpërndanë para fundit të vitit. Në Luftën e mëvonshme Civile Ruse, ato luftuan si për bolshevikët (këmbësorinë) ashtu edhe për Gardën e Bardhë.

Në Serbi, disa gra individuale luajtën role kryesore ushtarake. Mjekja skoceze Elsie Ingles koordinoi një tërheqje prej rreth 8 000 trupash serbe përmes Rumanisë dhe Rusisë revolucionare, deri në Skandinavi dhe më në fund në anije transporti për në Angli.

Një grua tjetër, Milunka Saviq, u regjistrua në ushtrinë serbe në vend të vëllait të saj. Ajo luftoi gjatë gjithë luftës, duke u bërë ndoshta gruaja më e dekoruar në historinë ushtarake.

Në vitin 1918 Loretta Walsh u bë gruaja e parë që u regjistrua si grua. Një ligj i vitit 1948 i bëri gratë pjesë të përhershme të shërbimeve ushtarake. Në vitin 1976, grupi i parë i grave u pranuan në një akademi ushtarake të SHBA-së.

Përafërsisht 16% e klasës së "West Point", 2013, përbëhej nga gra. Në Luftën Civile Finlandeze të vitit 1918, më shumë se 2000 gra luftuan në Gardën e Kuqe të Grave.



Betejë

Gjatë Luftës Civile Spanjolle, mijëra gra luftuan në njësitë luftarake dhe praparoje me gjini të përzier, ose si pjesë e milicisë. Disa vende lejojnë ushtarët femra të shërbejnë në pozicione të caktuara të armëve luftarake.

Të tjerët i përjashtojnë ato për arsye të ndryshme, duke përfshirë kërkesat fizike dhe politikat e privatësisë.

Shtetet e Bashkuara, Mbretëria e Bashkuar dhe Kanadaja janë vendet ku u arrit niveli më i lartë i pranisë ushtarake të femrave. Kanadaja është shënuar si veçanërisht progresive në zbatimin e hershëm të praktikave të barazisë gjinore.

Një rritje e thirrjes për mundësi të barabarta, e shoqëruar me rënien e burrave të aftë

për punë, të gatshëm për të hyrë në shërbimin ushtarak, nxiti vendet të reformojnë politikat drejt përfshirjes së grave.

Me hapjen e shërbimit të nëndetësive në vitin 2000, gratë tani kishin lirinë për t'u regjistruar në çdo lloj shërbimi ushtarak.

Forca Ajrore në Shtetet e Bashkuara, më 8 korrik të vitit 1948, kishte pranuar rekrutet e para femra nëpërmjet një programi të quajtur "Gratë në Forcat Ajrore" (WAF).

WAF ishte formuar në vitin 1948, kur presidenti Truman kishte nënshkruar Aktin për integrimin e grave në Forcat e Armatosura. Programi WAF kishte përfunduar në vitin 1976, kur gratë kishin filluar të pranoheshin në Forcat Ajrore në mënyrë të barabartë me burrat, pa ndihmën e ndonjë programi të veçantë.

Edhe Shqipëria nuk ka mbetur pas në rritjen e numrin të aderimit të grave në Forcat e Armatosura, si dhe fuqizimi dhe roli i tyre në përgjegjësi të reja dhe detyra të larta.

Ne krenohemi për gratë tona të guximshme në uniformë, për kontributin e tyre të shkëlqyer. Shqipëria ka mbështetur plotësisht rëndësinë e rolit të gruas në forcimin e paqes dhe sigurisë. Sidomos gjatë viteve të fundit, për shkak të prioritetit të lartë që i është kushtuar fuqizimit të grave dhe arrijtes së barazisë gjinore, Shqipëria ka bërë progres të dukshëm në rritjen e kuotave të grave në parlament, administratë publike, ushtri, polici dhe gjyqsor. Në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin Kombëtar të Veprimit 1325, Ministria e Mbrojtjes ka përfshirë perspektivën gjinore në politikat dhe procedurat e saj të rekrutimit.



“AbramsX”, tanku i ri i ushtrisë amerikane, përbindësh vdekjeprurës

Ndërsa shumica e pjesëve të pajisjeve ushtarake brenda forcave të armatosura të SHBA-së janë zëvendësuar me kalimin e kohës nga teknologji më të reja dhe më të avancuara, tanku kryesor i betejës “M1-Abrams” i ushtrisë amerikane bën përjashtim. Për gati katër dekada, ushtria amerikane ka vënë në terren familjen e tankeve “Abrams”, duke përmirësuar çdo automjet të blinduar të njëpasnjëshëm me aftësitë dhe teknologjitë më të fundit. Kohët e fundit, prodhuesi i tankeve “General Dynamics Land Systems” po përpaket të zhvillojë një variant tjetër më të avancuar dhe inovativ të familjes “Abrams - AbramsX”.

Në vitin 2022, një demonstrim u zbulua në Simpoziumin Vjetor të Shoqatës së Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara. Përsëritja e fundit e tankut të frikshëm pritet të ngacmojë edhe konkurrentët.

Automjeti i blinduar prezantoi teknologji të ndryshme të reja në ushtri, duke përfshirë një armaturë të përparuar, një sistem kompjuteri kontrolli zjarri dhe një motor turbinë me shumë karburant.

Me kalimin e viteve, ndërsa niveli i kërcënimit ndryshoi, “Abrams” iu nënshtrua disa modifikimeve të mëdha. Për shkak të historisë së tij të shkëlqyer në operacionet luftarake, Ushtria gjithmonë qëndronte me modelin “Abrams”. Së fundmi, “SepV4” është varianti më i fundit i “Abrams” për të arritur fazën e testimit. Sipas Ushtrisë, teknologjitë e reja të inkuorporuara në përsëritjen e 4-të të tankut do t’u mundësojnë ekuipazheve të identifikojnë objektivat e armikut më shpejt se kurrë më parë. Për më tepër, “Abrams-i” i ri “do të integrojë një kamerë me ngjyra, gjetësin e rrezeve lazer të sigurt për sytë dhe një tregues lazer ndër-platformë për të lehtësuar betejën me shumë domene në sytë e komandantit.

Përveç një përmirësimi të vdekshmërisë, varianti më i ri i tankut do të përfshijë trajnime të integruara të plota për të maksimizuar aftësinë e ekuipazhit të sistemit. Ky program filloi mjaft herët për të futur në bordin e çdo teknologjie që Ushtria e konsideron kritike për fushën e betejës së ardhshme, duke përfshirë inteligjencën artificiale, autonominë, APS ose sensorë të avancuar.


Në fjalimin e Çurçillit në Konferencën e Jaltës para Rusvelt ai citon thënien e kushtetutës së pashkruar britanike se “Kjo ishte si Karta e Atlantikut – dokument që nuk ekziston, por gjithë bota e dinte në lidhje me këtë thënie. Ndër letrat e tij ai kishte gjetur një kopje të nënshkruar nga Rusvelti, por e çuditshme është se për të thonë se të dy nënshkrimet janë të dorëshkrimit të tij. ”

Reagimet

Aleatët e mëvonshëm të Anglisë u mbledhën në Londër, më 24 shtator 1941, përfaqësues të lartë qeveritare nga Belgjika, Çekosllovakia, Greqia, Luksemburgu, Holanda, Norvegjia, Polonia, Bashkimi Sovjetik, Jugosllavia, dhe përfaqësues të përgjithshëm, Carl De Gol, kreu i Francës, ku miratuan njëzëri aderimin në parimet e politikës së përbashkët të përcaktuara në Kartën e Atlantikut.

Aksi Tokio-Berlin-Romë e interpretuan këtë marrëveshje diplomatike si një aleancë të mundshme kundrejt tyre.

Marrëveshja dëshmoi për kohën që u miratua se qe një nga hapat e parë drejt formimit të Kombeve të Bashkuara. Opinioni publik në Britani të Madhe dhe Komonuelthi ishte i kënaqur me parimet e takimeve, por të zhgënjyer në faktin se SHBA-të nuk hyjnë në luftë. Çurçilli vetë pranoi se ai kishte shpresuar se SHBA-ja do të vendosë në fund për të ingranuar në këtë front kundër aksit nazi-fashist.

Në anën tjetër opinioni publik amerikan ishte i kënaqur me parimet, por i shqetësuar në lidhje me faktin se ata duket të jenë influencuar për t'u hedhur në frontin e luftës kundër Gjermanisë. Përkrahësit dhe kundërshtarët shfaqën të njëjtat pikëpamje. Ishte një mirënjohje për të gjithë popujt që kanë të drejtë për vetëvendosje, kjo i dha shpresë liderëve të shteteve për pavarësi në kolonitë britanike (p.sh., Indi dhe vende të tjera (p.sh., Ho Shi Minh në Indo-Kinë prej Francës, nga ata mund të pritet një përparim në kërkesat e tyre për autonomi kombëtare.

"Little Boy", hija e tmerrit të Luftës së Dytë Botërore

Më 6 gusht të vitit 1945, gjatë Luftës së Dytë Botërore është hedhur bomba e parë atomike mbi qytetin e Hiroshimës në Japoni, e cila është pasuar nga një tjetër më 9 gusht në Nagasaki.

Bomba "Little Boy" është hedhur nga avioni B-29 "Enola Gay" i Flotës Ajrore të Shteteve të Bashkuara. Bomba me uranium, me forcën e 13 mijë TNT ka shkatërruar 70 për qind të Hiroshimës, duke krijuar nxehtësi prej 3.000 centigradësh.

Bomba atomike ka rrafshuar me tokën çdo gjë në një diametër prej 1.5 kilometrash, ndërsa ka shkatërruar 80 mijë të vdekur vetëm në fazën e parë dhe 140 mijë deri në fund të vitit 1945 nga djegiet dhe helmimet.

Kodrat përreth qytetit kanë kufizuar përhapjen e forcës shkatërruese nga rrezatimi, të bombës me fuqi 22 mijë TNT të hedhur nga një lartësi 500 metra, megjithatë rreth 70 mijë persona kanë humbur jetën në fazën e parë dhe gjysma e qytetit është shkatërruar. Perandori i atëhershëm i Japonisë, Michinomiya Hirohito në mesazhin e tij, më 15 gusht, ka deklaruar dorëzimin e vendit të tij pa kushte, duke thënë se "vazhdimi i luftës do ta shkatërronte popullin japonez".

Hiroshima është vënë në shënjestër për shkak të bazave ushtarake, kurse Nagasaki për shkak të industrisë së rëndë.

Hedhja e bombës në Nagasaki i ka dhënë fund zyrtarisht betejave që kanë vazhduar në Paqësor.

Sipas japonezëve numri i të vdekurve është gjysmë milion

Sipas shifrave zyrtare të Komitetit të Projektit Manhattan, të themeluar për të zhvilluar armë bërthamore për SHBA-të, para bombardimit në Hiroshima jetonin 255.000 njerëz.

Në fazë të parë në Hiroshima humbën jetën 66.000 persona dhe u plagosën 69.000 të tjerë.

Ndërsa në Nagasaki ku jetonin 195.000 njerëz humbën jetën 39.000 dhe u plagosën 25.000 të tjerë.

Deri në fund të vitit numri total i të vdekurve është rritur në 135.000, ndërsa në Nagasaki 75.000.

Por japonezët njoftuan se vdekja në dy qytetet është afër 500.000.

Hibakusha. Të dëmtuarit nga katastrofa atomike, të njohur si "Hibakusha", u përballën me plagë të tmerrshme.

Bombat atomike përveç ndikimit shkatërrues si bombat konvencionale, zgjeruan edhe më tej diametrin e efektit si rezultat i reaksioneve të nxehtësisë dhe rrezatimit.

Këto bomba shkatërruan deformime dhe sëmundje të cilat vështirë të trajtohen përfshirë edhe kancer tek shumë njerëz.



Depresioni psikologjik dhe plagët e viktimave vazhdojnë edhe në ditët e sotme.

Mosha mesatare e Hibakushave ka arritur në 82 ndërsa numri i tyre zvogëlohet gjithnjë e më tepër. Ata shprehin mesazhin e tyre për heqjen dorë nga armët bërthamore çdo gusht.

Bota nën hijen e luftës bërthamore

Krahas dorëzimit të Japonisë, bombat atomike, të cilët përbënin një pikë kthese të luftës, shkatërruan edhe transformimin e marrëdhënieve ndërkombëtare. SHBA dhe Bashkimi Sovjetik formuluan mënyrën e montimit të bombave të fuqishme me hidrogjen në raketa balistike ndërkontinentale (ICBM), me çka hodhën hapin drejt epokës së "përdorimit të forcës ekstreme".

Mes viteve 1960 dhe 1990, bota hyri në periudhën e "Luftës së Ftohtë" që u kaloi nën hijen e luftës bërthamore, por gjatë së cilës dy fuqitë bërthamore asnjëherë nuk morën guximin t'i hapin luftë "të drejtpërdrejtë" njëra-tjetrës.



Nënkolonele Drita Prifti Karoli, zysha emblemë e urtësisë dhe mençurisë

Ashtu si dritë dielli, erdhi Drita në familjen e saj, në Tiranë, më 16 dhjetor të vitit 1949. Vitet e para të fëmijërisë në ndryshim nga shumë moshatarë të saj, Drita Karoli (Prifti) do t'i kalonte jashtë vendit, në Bashkimin Sovjetik, ku babai i saj, i nderuari Mihal Prifti, kryente detyrën e ambasadorit shqiptar, ndërsa më pas dhe ambasador në Kinë. Në atdhe do të kthehej në klasën e pestë dhe fillimisht do të ndiqte shkollën ruse ku shkonin fëmijët e diplomatëve të huaj, kështu që gjuha bazë me të cilën do të shkollohej do të ishte rusishtja. Pas përfundimit të shërbimit diplomatik, familja e saj vendoset me banim në Shkodër.

Ishte vetëm 18 vjeçe, e sapo kishte përfunduar shkollën e mesme. Midis shumë mundësive u shfaq pikërisht edhe shkollimi në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve. Në fakt në qytetin ku jetonte kjo erdhi si një çudi. Askush nuk mund ta imagjinonte një vajzë të bukur si ajo, një vajzë e cila ndryshe nga të tjerat kishte pasur mundësi të njihje edhe botën përtej Shqipërisë, të bëhej ushtarake. Kurse sa për prindërit, ata e konsideruar më se normale zgjedhjen që vajza e tyre bëri. Bashkë me të, nga qyteti i Shkodrës vendosën të vazhdonin shkollën ushtarake edhe dy vajza të tjera. E vetmja gjë që iu tha fillimisht në lidhje me shkollën, ishte fakti se, krahas programit të studimit ushtarak, do të kishin mundësi të ndiqnin edhe një program civil, që mund të ishte inxhinieri, financë etj. Pra i vetmi ndryshim që do të kishte nga shoqet e tjera do të ishte mbajtja e uniformës. Por kur mbërriti në oborrin e madh të Shkollës së Bashkuar, gjërat nuk ishin më kaq të thjeshta sa ishin dukur në fillim. I pari që e "pësoi" për shkak të disiplinës dhe rregullave ushtarake ishte gërsheti i bukur i Dritës. Në shkollën ushtarake nuk lejoheshin flokët e gjatë. Drita kujton momentin kur me nënën e saj, Sofien, u gjendën në një floktore në fillim të 'Rrugës së Dibrës' dhe gërshërët e mëdha që ia prenë pamëshirë gërshetin e trashë e të gjatë. Ky ishte privimi i parë i jetës së re prej ushtarakeje. Por në fakt ashtu si në këngën e njohur "Nënë moj do të pres gërshetin" vajza e imët, e druajtur, vendosi t'i hyjë një rruge të re, të panjohur, e bindur se do t'ia dilte. Në shtatorin e vitit 1967, Drita Karoli, nis studimet në shkollën ushtarake, në specialitetin e financës. Nuk u pendua



për asnjë moment gjatë dy viteve shkollim për zgjedhjen e bërë. Madje, ashtu si ndodh natyrshëm në të gjitha mjediset studentore, ajo do të gjente aty edhe shokun e jetës, Kostaq Karolin, që në atë kohë ishte pedagog i taktikës në shkollë. Edhe ai ushtarak si ajo. Me Kostaqin u fejua zyrtarisht në përfundim të vitit të parë dhe martesë do të vinte po kaq shpejt. Një martesë modeste pa shumë bujë. Të qenit të dy ushtarakë e bëri edhe më të fortë familjen tyre. Kur njëri mungonte, detyrat i merrte përsipër bashkëshorti tjetër. Edhe djemtë që iu erdhën në jetë, pavarësisht se nuk e ndoqën karrierën ushtarake, që në fillim u mësuan me disiplinë dhe të

qenit bashkëpunues.

Në përfundim të shkollimit ushtarak Drita, u emërua në Ministrinë e Mbrojtjes, në Drejtorinë e Ekonomisë.

Volumi i punës ishte i madh, pasi i duhej të shqyrtonte dosje të tëra, që lidheshin me importet ushtarake. Edhe pse tashmë Drita ishte bërë oficerë, nuk kishte hequr dorë nga një shkollim me profil civil, jo sepse kishte në mendje ndonjë plan për t'u larguar nga ushtria. Edhe të shoqit as që i shkonte në mend një gjë e tillë. Por ajo dëshira e hershme për të studiuar në një fakultet si ai i Shkencave Shoqërore ngelej një "ëndërr e fjetur". Kështu që fati e ndihmoi ta ndjekë për katër vite rresht këtë fakultet ditën, me shkëputje nga puna, por jo nga mbajtja e uniformës, apo fakti se në rast gatishmërie, ajo duhet të paraqitej në detyrë. Në përfundim të studimeve, u emërua pedagoge në Shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej". Këtu do e priste edhe surpriza e parë. Fillimisht do ta emëronin mësuese në maturë. Ishte një klasë e mbushur plot me djem, të cilët edhe për shkak të zhvillimit moshor ishin shtatlartë e tepër të gjallë. Kërkoj të ndryshonte klasat me një koleg të sajën dhe e nisi punën si mësuese e vitit të parë. Por kjo ndodhi vetëm në fillim, pasi për shumë vite me radhë ajo do të jepte mësim rregullisht në të gjitha klasat, në lëndët e saj të preferuara Histori, Filozofi, Ekonomi Politike etj. Nga koha e punës si pedagoge mbart mbresa të gjalla, pasi kanë qenë një numër i madh oficerësh që u ka dhënë mësim. Kujton se ata vinin nga shtresa të ndryshme shoqërore, me formime të ndryshme dhe detyra e tyre si pedagogë merrte një rëndësi të veçantë. Aq më tepër kur bëhej fjalë për një pedagogë ushtarake, pasi ajo ishte njëkohësisht pjesë e stafit pedagogjik, por edhe pjesë e komandës së shkollës. Për shkollën e mesme "Skënderbej", ajo ruan shumë nostalgji dhe e ka të vështirë të pranojë se ajo u mbyll për të mos u hapur më. Kujton ditën kur u gjendën papritur, pa i lajmëruar askush përballë dyerve të mbyllura të saj. Bashkë me mbylljen e asaj porte, Drita mbylli edhe një karrierë të gjatë si edukatore, por që sot vjen përmes mirënjohjes së shumë ushtarakëve të karrierës, që për "zysh Dritën" flasin si për një perëndi urtësie e mençurie njëkohësisht. Ushtarakja e dy epokave, me ndryshimet



e ndodhura në Shqipëri pas vitit 1992, ku ushtria do të ishte më e prekura, edhe Drita do të përballej me dilemën nëse duhet ta vazhdonte karrierën e saj ushtarake.

E gjendur në krah të një bashkëshorti që gjithmonë ka qenë një ushtarak karriere deri në hierarkinë më të lartë ushtarake, atë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe me gradën gjeneralmajor, ajo asnjëherë nuk kërkoi të privilegjohej. Kështu që pranoi pa ngurrim të bëhej instruktore në Degën Ushtarake të qytetit të Tiranës, ku punoi deri në vitin 1996. Në vitin 1996 pasi u lirua nga ushtria me gradën "nënkolonel", ajo rifilloi punë si civile në Ministrinë e Mbrojtjes. Vitin e fundit të karrierës do ta mbyllte si shefe e personelit në Akademinë Ushtarake "Skënderbej" e më pas pranë Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, që shënojnë dhe fundin e karrierës 27-vjeçare me uniformë.



Nevruz (Turku) Sako, komisar i Shkollës së Bashkuar, rrëfen...

sh-skënderbegasi dhe komisar i Shkollës së Bashkuar, kolonel Nevruz (Turku) Sako, vjen në rrëfimin e jetës së ushtarakut, mes mallit të shokëve të sfidave të përbashkëta dhe kujtimeve të ditës së parë në garnizonin ushtarak, i cili do të bëhej shtëpia e tij e dytë: Gjatë verës isha në hall se si do të bëhet për të vazhduar shkollën në shtator. Por, diku nga mesi i korrikut, në një mbrëmje kur mbledheshim të gjithë në shtëpi, babai më thotë: “bëhu gati se do të shkosh në shkollë në shtator, në Tiranë, në shkollën ushtarake ‘Skënderbej’, për oficer”. Unë, nëna, vëllezërit dhe motrat mbetëm të habitur, të surprizuar dhe nuk po flisnim. Këto ishin momente disa sekonda... por mendja e njeriut është shumë e shpejtë dhe nuk e llogarit dot se sa mendime kalojnë si vetëtimë. Në këto çaste më erdhën shumë pyetje e mendime, por më kryesoret që më kanë mbetur: “Unë jam gati të shkoj në çdo shkollë, kudo që të jetë ajo, dhe çdo profil a zanat, vetëm të shkollohem!”. Në fakt, as e kisha menduar ndonjëherë shkollën ushtarake, gjithmonë ëndërroja për t’u bërë doktor dhe për të shëruar nënën se ishte e sëmurë, por edhe më pëlqente kur i shikoja me bluza të bardha e të pastra, por edhe ndonjë degë si mekanik apo inxhinier. Mendimi që më mundonte më shumë ishte se doja shkollë, që të mos shpenzoja prindërit dhe të ngarkoja të ardhurat e familjes. Pas një pauze, babai vazhdoi duke thënë: “Sot na thirri gjeneral Spiro Moisiu dhe na tha që djemtë do t’i dërgoni në shkollën ushtarake. Do t’i bëjmë oficerë të ushtrisë, sepse Komandanti i Përgjithshëm ka thënë që nuk ia dorëzojmë “të deklasuarve” ushtrinë dhe shtetin, por klasës punëtore dhe fshatarësisë punonjëse, prandaj bijtë e tyre do të bëhen oficerë!”. Pastaj vazhdoi të argumentojë pse duhet të shkoja: “Ajo është shkollë e mirë dhe me leverdi për ne, sepse nuk kërkon para për studime, nuk duhet as për ushqimin dhe as për t’u veshur, të gjitha i paguan shteti. Dhe ti mëson e siguron jetën tënde. Unë kam dhënë fjalën dhe ti do të shkosh atje”. Kështu ishte rregull, edukata, tradita, që fjala e prindërve nuk diskutohet dhe ata as të pyesin shumë për dëshirat e tua. Kuptohet që gëzimi im ishte shumë i madh, sepse do të vazhdoja shkollën. Nuk dija gjë për shkollën ushtarake dhe për ushtrinë e oficerët, sepse as në lagje, as në fis apo të njohur nuk kishim ndonjë ushtarak. Megjithatë, atë moment më dolën para syve uniforma dhe figurat e Vlash Arapit



dhe Faik Gumës, skënderbegas me uniformë, që i kisha parë kur kishin ardhur me leje për Vitin e Ri.

Periodha e fillimit, gusht-dhjetor 1959, në “Skënderbej”

Përgatitja dhe përfytyrimi im për shkollën “Skënderbej” ishte shumë i pa përcaktuar. Isha si i çoroditur, sepse nuk dija asgjë

për shkollën, për njerëzit, mësimet e jetën dhe veprimtarinë e tyre. Por e kaloja me mendimin që më ka shoqëruar gjithë jetën aktive (shkolla e karriera): “Unë do të bëj dhe do të sillem si e di unë!” dhe më tej: “Po ata që ia dalin, çfarë kanë më shumë se sa unë?”. Isha i bindur në vetvete se unë do të veproj si e gjykoj, duke parë dhe duke mësuar edhe nga të tjerët, pavarësisht ç’do mendojnë të tjerët, pse duhet të trembem e të tërhiqem, ose pse duhet të kem frikë e të hutohem, si i thonë, frika e skenës, frika apo emocionet kur del para një publiku të madh, apo njerëzve me pushtet, etj. Unë do të jem vetvetja, pa u shtirur, duke u dhënë përgjigje gjërave aq dhe ashtu siç i di dhe ato që nuk di do t’i mësoj!”.

Unë isha gati për shkollën, kisha një palë pantallona doku, një këmbishë dhe një bluzë, kisha dhe sandalet me rripa që shkoja në shkollë, sandale me rripa gjysmë të këputura dhe asgjë tjetër. Ishte data 15 gusht 1958. U nisa pasi takova njerëzit e familjes. Më shoqëroi nëna deri tek Dega Ushtarake, ku na priste një makinë ushtarake “Zis”. Oficeri bëri apelin dhe ne hipëm në makinë rreth 5-6 veta nga Lushnja, të cilët nuk i njihja. Njihja vetëm Vangjel Mertirin, që ishte aty nga qyteti dhe ishim shokë të klasës së shtatë. Të tjerët vinin nga fshatrat e Lushnjës, nga Berati, Qyteti Stalin dhe Fieri. U nis makina dhe ne shumica, rrinim në këmbë në karroceri, mbështetur në spondet që ishin të larta dhe shikonim arat, vreshtat dhe qytetet; teksa kaluam Rrogozhinën, Kavajën, Plepat te plazhi dhe nga rruga e Ndroqit, arritëm në Tiranë. Nuk kisha qenë në Tiranë (atëherë nuk kishte TV, as radio, as gazetën “Zëri i Popullit” nuk e blinin, që mund të shikonim ndonjë fotografi të Tiranës) dhe shikoja pallatet, që më dukeshin të larta (4-5) kate dhe shumë qytet i madh. Arritëm në shkollë pasdite dhe sapo u futëm në territorin e saj, pushuan bisedat dhe shikonim rreth e rrotull me habi dhe kuriozitet. Menjëherë na çuan te berberët, Hamdiu dhe Bedriu na qethën zero, dhe pastaj në dush, na dhanë rrobat, u veshëm me uniformën ushtarake dhe filluan rreshtimet. Në fjetore morëm çarçafët, rregulluam krevatët dhe filloi ushtria, orari, komandat, rreshti etj... Fillimisht rrinim me grupe 2-3 e më shumë veta, sipas njohjes fillestare nga vinim dhe pasi kaluan disa ditë, filluam të shpërbëheshin grupet që u krijuan në fillim. Unë shoqërohesha me Bardhyl Mezinin, Çlirim Pulajn nga Tirana, Ilmi Fudullin (Qazimi), Myslim Pashaj, Kujtim Basha, Nebi Shkëmbi, Petrit Aliaj nga Berati- Skrapari, Patriot Aliaj, Sulo Beqiri, Feti Licaj, Selam Haskaj, Luftar Muçaj nga Vlora, Pjetër Shkreli, Bajram Muja, Mit’hat Cufi, Pajtim Ajazi nga Shkodra, Arben Piso, Proletar Doraci, i ndjeri Vilson nga Gjirokastra, Spiro Karavella, Hasan Shabani dhe Maksut Callo nga Saranda, i ndjeri Petrit Kovaci, Llambi Angjellari nga Pogradeci, Emnor Bardhi, Gaqo Demiri, Viktor Kolaneci nga Korça, Muharrem Shehu nga Elbasani, etj. Tremujori i parë, sidomos muaji i parë, disi edhe i dyti, ishin të vështirë, kishte shumë shokë që mërzhiteshin dhe donin të largoheshin nga shkolla, qanin e rrinin të vetmuar. Edhe unë mërzhitesha shumë, por kur mendoja për t’u larguar nga shkolla, menjëherë më dilte përpara puna në kooperativë, gjendja dhe jetesa në familje, të ardhurat që siguronim, që asnjëherë nuk kishim sa duhet, shokët që vazhdonin shkollën, pastaj vitet pa shkollë dhe gjithë ato mendime, ëndërrime e dëshira për të vazhduar me çdo kusht shkollën. Kështu që mendimin për të

lënë shkollën, e kisha fiksuar që nuk do të largohem, sikur ç’të bëhej. Unë do të largohesha i fundit nëse do të ndodhte kjo gjë. Në këto kushte, unë filloja moralin me shokët që mërzhiteshin dhe qanin e donin të largoheshin. U jepja kurajë, se ja do të kalojë shpejt, se ne këtu jemi bashkë dhe duke i pyetur se nga ishin e ç’ njerëz kishin, si jetonin etj. Gjeja shumë argumente për t’u thënë: “Ky është rasti që ti ta ndryshosh gjendjen e familjes dhe tënden”, “...po ja që edhe ata të viteve të dyta e të treta si kanë ndenjur? Pse ata më të zotë se ti e se në janë?”, “...po kur të shkosh në shtëpi gjithë fshati, apo lagja do të tallen me ty se shkove në shkollë dhe nuk ishe i zoti të qëndroje”, etj. Megjithatë, disa edhe u larguan. Por shumica filluan të mësohen dhe përshtaten me regjimin e jetesës dhe veprimeve në shkollë, që për të qenë të sinqertë është regjim i vështirë, madje shumë i vështirë për mosha të njoma e të pamësuar (këto të krahasuara me shkollat e tjera dhe mjediset familjare). Pasi kaluan muajt e parë dhe filluan të shkonin me leje e liralidje, ata që ishin afër Tiranës, dhe sidomos për Vitin e Ri që kishim pushime, (me përjashtim të Tropojës e Kukësit, e ndonjë tjetër që rrugët ishin të bllokuara nga dëbora, të gjithë të tjerët shkuan pranë familjeve), sikur u ambientuam mirë.

Tremujori i parë u mbyll dhe secili mori edhe vlerësimin e mësimave. Ata që nuk kaluan klasën dhe mbetën në tre e më shumë lëndë i larguan nga shkolla dhe shkuan në shtëpi. Unë isha në grupin e më të mirëve me mësim, por edhe me disiplinën e aktivitetet që zhvilloheshin atje. Ishin bërë zgjedhjet në rini dhe unë isha zgjedhur sekretar i rinisë. Ngjarja më e veçantë e kësaj periudhe, ishte vizita në Krujë, i një grupi skënderbegasish nga çdo vit mësimor (ata me rezultate më të larta). Nga viti i parë, u caktova unë, mbaj mend edhe Pajtim Ajazin, Vasil Nanushin, Vladimir Tira (kaq më kujtohen nga fotografia me Enver Hoxhën). Nga vitet e mëparshme, Bashkim Kozelin, ndërsa të tjerët nuk i kishim njohur akoma. Kjo vizitë bëhej në kuadrin e festave të Nëntorit, 15-vjetori i Çlirimit të Atdheut, ku erdhën Enver Hoxha dhe disa anëtarë të tjerë të Byrosë Politike, si Mehmet Shehu, Beqir Balluku, Petrit Dume, Manush Myftiu etj. Pasi pamë Kalanë e Krujës, Mehmeti i thotë Enverit: “Shoku Enver bëjmë një fotografi me këta stërnipat e Skënderbeut”, dhe Enveri u tregua i gatshëm dhe na ftoi të gjithëve për një fotografi. Kjo fotografi (është në dy variante) është retushuar më vonë kur dolën “grupet armiqësore” dhe po ta shohësh fotografia ime është retushuar. Ne krahun tim të majtë ishte Bashkim Kozeli, që e kanë hequr, ai nuk ishte “armik”, por pse? Nuk e di pse, por prapa ka qenë edhe Manush Myftiu, në një foto me ne dhe më vonë është hequr?!

Në dhjetor para Vitit të Ri, dilnin dhe rezultatet e semestrit të parë dhe të gjithë shkuam me pushime. Ne, grupi nga Lushnja, Fieri dhe Berati, po edhe Vlora e më tej, shkonim me tren deri në Rrogozhinë dhe pastaj me makina të rastit në karroceri të “Gazit”, “Zisit”, apo të “Skodës”, por që nuk na merrnin lekë shoferët sepse ishim ushtarë. Gjatë vitit të parë, mua më mori me ekipin e gjimnastikës, mësuesi i fizikulturës, mjeshtër i merituar i sportit dhe kampion kombëtar për gjimnastikën në vegla, Bujar Bujari. Bënim stërvitje pasditeve në kohën e kulturës masive disa herë në javë, në palestrën e shkollës, ku kishim të gjitha veglat. Me mua morën edhe Mëhill Mirashin dhe Arben Pison. Kjo vazhdoi deri në fund të vitit të parë. Atë vit, u praktikua që

viti i fundit i shkollës, të shkonin një muaj në repartet ushtarake, në praktikë, në rolin e ushtarit. Profesori më mori edhe mua me ekipin e gjimnastikës me skënderbegasit që shkuan në praktikë, në Durrës tek Plepat. Në atë vit mbaj mend që Divid Ibrahim, Andrea Rrenza, Arqivadih Dede, Ilia Kongo dhe Nasi Gjergo, ishin ekipi i gjimnastëve të shkollës dhe të rinjtë e “Partizanit”. Aty ndenja rreth dy javë a më shumë dhe u largova me lejen e profesorit dhe nuk u ktheva deri në fund të pushimeve. Pushime bënim rreth dy muaj gjatë të cilave unë punoja në fermën bujqësore “29 Nëntori” të Lushnjës dhe, vetëm një 15-ditësh bëja pushim. Nga tre 15-ditësha pune, merrja me vete lekët e pesëmbëdhjetëditëshit të fundit, të tjerët ia dorëzoja babait.

Me fillimin e vitit të dytë unë fillova me futbollin, u largova nga gjimnastika. Nga skuadra e futbollit dua të përmend disa gjëra. Fillova me skuadrën e futbollit të shkollës, që në fakt ishte skuadra e të rinjve të “Partizanit”. Stërvitjen e bënim me mjeshttrin e sportit Fadil Voglin, i cili kishte qenë lojtar titullar i “Partizanit” dhe tani merrej me stërvitjen e të rinjve. Fadili e kombinonte stërvitjen fizike e atletike me lojën me top, kishte njohuri dhe përvojë, sepse i kishte stërvitur mjeshtri i madh Loro Boriçi.

Ndeshjen e parë të kampionatit e kemi zhvilluar me “Korabin” e Peshkopisë. Pas një viti largohet si trajner dhe e zëvendëson mjeshtri i sportit, Sllave Llambi. Sllave Llambi ishte më i vjetër, ai kishte qenë me “Partizanin” dhe me Kombëtaren pas viteve 1945. Para 1945, ai kishte luajtur edhe në Itali. Ishte shumë praktik, fliste thjeshtë dhe të mësonte shumë gjëra që të duheshin në lojë. Kombinonte me mjeshtri teorinë me praktikën, duke u përqendruar më shumë në skema të thjeshta e konkrete. Më vonë, na bente stërvitje Simon Deda, të cilin e kisha parë edhe kur luante me “Partizanin” e kombëtaren, sulmues i majtë. Lëvizte shpejt gjatë vijës anësore dhe gjithmonë e përfundonte me kros të topit në zonën e gjashtëmbëdhjetëshes, ashtu siç bënte edhe Kolec Kraja, sulmuesi i djathtë. Në Shkollën e Bashkuar, trajner kemi pasur edhe mjeshttrin Refik Resmja, gjysmë sulmues i majtë, i “Partizanit” dhe Kombëtares. Ai kishte përdorim të mirë topit dhe nga anësorja, futej në qendër ku me rrotullim në vend gjuante portën me të majtën, ose priste krosimin nga anët dhe gjuante me rafishatë, që në të shumtën e herës bënte gol. Nëse do të bëja ndonjë dallim mes trajnerëve do të thosha: Sllavja ishte shumë konkret, me fjalë pak dhe i saktë, të tregonte me shembuj dhe raste ku gabohej. Simoni ishte shumë energjik, kishte njohuri teorike shumë, mbante shënime për çdo praktikë dhe sidomos në ndeshje. Në stërvitje bënte shumë përgatitje atletike dhe fizike, rreth 70% të kohës, dhe në fund të jepte topin kur ishte “telikosur”. Ndryshonte stërvitja e Simonit, sepse kur ne bënim ndeshje, nuk lodheshim deri sa mbaronte sfida, edhe sikur të kishte akoma lojë, ne luanim pa e ndjerë. Kjo bënte që edhe në qoftë se ndonjë skuadër na bënte gola, apo na mundte në pjesën e parë, ne duke qenë të freskët dhe plot energji në pjesën e dytë, e mundnim kundërshtarin me lojë dhe me gola. Ndërsa Refiku na bënte 20-30% lëvizje të lehta, pastaj na praktikonte me topin dhe lojë deri në fund të stërvitjes. Kjo bënte që në ndeshje ne të fitonim në pjesën e parë dhe në të dytën nuk kishim me fuqi të luanim. Shumë herë ne e bënim stërvitjen te klubi “Partizani”, në Laprakë dhe luanim me skuadrën e parë. Edhe kur ishim

me rezervat e “Partizanit”, po e njëjta gjë. Ndeshjet më të forta bëheshin kur luanim me skuadrat e të rinjve të “17 Nëntorit” dhe “Dinamon”. “Partizani”, lojtarët e mirë të skuadrave të të rinjve i mernte ushtarë dhe kështu plotësohej skuadra e rezervave që një nga një futeshin në skuadrën e parë. Kështu ndodhi me Mexhit Haxhiun e Vlorës, Bukovikun, Xuxin e Tiranës, etj. Shpesh stërvitjet i bënim tek fusha e “Partizanit” në Laprakë dhe këto koordinoheshin që të zhvillonim ndeshje stërvitore me skuadrën e parë të Partizanit, ose ndeshje kontrolli siç quheshin. Dhe këto i drejtonte mjeshtri i madh Loro Boriçi, ashtu si edhe sot, të bënte të njohur me shumë sportdashës, kështu që unë dhe gjithë ata që luanin me skuadrën e shkollës dhe jo vetëm, njiheshin nga e gjithë shkolla, përfshi edhe pedagogët dhe oficerët që në mësimet nuk kishin lidhje me ne. Me skuadrën e futbollit kam luajtur në Peshkopi, Shkodër, Durrës, Berat, Vlorë edhe në Lushnje, me rezervat e Partizanit.

Në marshimet që bëheshin në fundjavë, në fushime dimërore, në aksionet kombëtare në ndihmë të ekonomisë, si në bujqësi për korrije e mbledhje të misrit, drithërave, në hapjen e rrugëve kombëtare në malësi, në hekurudhë etj., që ka bërë shkolla, unë dhe shokët pjesëmarrës në skuadrat e “Partizanit”, nuk kemi shkuar, sepse kishim ndeshjet dhe aktivitetet sipas kalendarit sportiv vjetor. Edhe në verë kur mbaronin mësimet në Shkollën “Skënderbej” bëhej kampionati ushtarak, ku merrnim pjesë unë, Selam Haskaj, Viktor Seiti, Fiqiri Doda nga futbollit; Patriot Aliaj, Gaqo Demiri, Petrit Zotaj, Sulo Beqiri e Luftar Muço, në basketboll; Arben Piso, Mëhill Mirashi, Petrit Bebeci, Roland Paluka dhe Bilal Koci në gjimnastikë; Ali Cena, Agim Guma dhe Pavlo Vangjeli në voleyboll etj.. Të gjithëve na inkudronin në skuadrat e Shkollës së Bashkuar si pjesëmarrës në kampionatin ushtarak. Shkolla e Bashkuar ishte ndër ekipet pretendente për të fituar titullin kampion dhe në shumë sporte ajo e fitonte pa diskutim.

Për katër vitet e shkollës, ka shumë për të shkruar dhe unë nuk do të ndalem në hollësi të jetës së përditshme, por do të shkruaj shumë shkurt, duke paraqitur mendimet dhe vlerësimet e mia, ç’më kujtohet nga ajo kohë tani në moshën 70 e ca vjeçare.

Shkolla “Skënderbej”, për mua, ishte një shkollë e veçantë që qëndronte mbi të gjitha shkollat e tjera të Shqipërisë, për gjithë periudhën që ajo ekzistoi në vendin tonë deri sa banda e çetnikëve, e politikanëve antikombëtarë, hajdutë dhe servilë e agjentë të të huajve që kanë marrë për detyrë ta shkatërronin Shqipërinë dhe ushtarinë e saj, e mbyllën shkollën “Skënderbej”. Megjithatë, përsëri përgatiten nxënës dhe studentë për oficerë, por jo në Shqipëri. Si i thonë një fjale që ata “mbyllën fushën se lojtarët i shpërndanë nëpër botë”. Për mua, të rinjtë që do të bëhen oficerë, më parë duhet të bëhen oficerë shqiptarë, ushtarakë shqiptarë dhe këtë drejtim e marrin këtu në shkollën e vendit të tyre me mësues, edukatorë dhe oficerë shqiptarë, me traditën shqiptare të shkollave ushtarake, të ushtresë shqiptare, pastaj le të shkojnë në çdo vend të botës për të mësuar dhe specializuar.

Shkolla “Skënderbej” ishte e veçantë, sepse ajo dallonte në të gjithë parametrat shkencorë, pedagogjikë dhe edukativë të institucioneve arsimore të Shqipërisë. Disa nga çështjet që unë

do të trajtojë këtu janë të njëjta si në të gjithë shkollat e mesme të përgjithshme të Republikës të asaj kohe dhe unë do të ndalem me theks në disa prej tyre që i kam vlerësuar dhe gjykuar më të mirat e kohës.

Programet dhe planet mësimore të shkollës kishin nivel të lartë shkencor. Ato bëheshin me grupe studimi, me mësues dhe specialistë me përvojë dhe diskutoheshin me masën e mësuesve. Baza e programeve mësimore ishte e zërthyer në elementët përbërës thelbësorë të shkencës përkatëse të çdo lënde mësimore. Nxënësit i jepeshin ato tema dhe probleme që përbënin njohuritë bazë, që ishin të nivelit të lartë për kohën dhe nivelin e intelektit përthithës të nxënësve, që e gjëje vazhdimësinë në klasat më lart dhe në shkollën që vinte më pas, të lartën, në institutet dhe universitetet. Programet atëherë bëheshin të studiuar dhe të diskutuara nga specialistët më të mirë të lëndës, shkencës dhe pedagogjisë në shkallë vendi, plus përvoja dhe konsultat me vendet e tjera të lindjes. Ndërsa programet dhe lëndët e sotme duket sikur janë më “shkencore”, sepse pasqyrojnë edhe zhvillimin e shkencave përkatëse deri në ditët e sotme, gjë që nga sa i njoh unë nuk është reale, pasi programet janë marrë kopje dhe nga njerëz që nuk janë specialistë të mëimit, shkencave përkatëse dhe pedagogë me përvojë. Këto programe janë marrë nga vendet e perëndimit dhe pa i shqipëruar, pa marrë parasysh traditën e arsimit shqiptar, nivelin e nxënësve dhe të mësuesve, nivelin dhe kompletimin e mjeteve mësimore didaktike, etj. Më e keqja është se programet dhe planet mësimore bëhen sipas shkollave të ndryshme, ku kanë studiuar ata që merren me to në një vit, pastaj vitin tjetër merret një që ka studiuar në vend tjetër dhe bën ato programe që ai njeh. Pra njëri kopjon ato të shkollës franceze, tjetri ato gjermane, një tjetër ato italiane. Jo vetëm kaq, por tekstet bëhen nga njerëz jo kompetent dhe që nuk kanë lidhje fare me programet e planet mësimore. Shumë gjëra bëhen biznes dhe tenderin e fiton ai që ka lidhje apo paguan për ta marrë e për të fituar. Tekstet dhe librat mësimore sipas lëndëve ishin të përgatitura me kujdes që zbërthenin njohuritë shkencore të lëndës dhe mësuesit e zotëronin lëndën në perfeksion, kurse sot i ndërrojnë sipas përkatësisë partiake, të atij që ka pushtetin dhe më keq kur i punësojnë sa për të marrë rrogën, që nuk ka mësuar mirë lëndën dhe aq më pak pedagogjinë e mësimdhënies.

Trupa Pedagogjike: Mund të hartosh programe, plane e tekste mësimore shkencore, por ato mbeten të vdekura, pa vlera ose gjysmake, në qoftë se nuk ke mësues e pedagogë të përgatitur me nivel të lartë shkencor e pedagogjik. Mësuesit e shkollës “Skënderbej” ishin më të mirët e kohës, ata zgjidheshin me përparësi nga gjithë trupa pedagogjike e kohës. Për mua ata kishin këto veçori e karakteristikë:

Ata e donin, “e dashuronin profesionin” e tyre, ishin të përkushtuar dhe të motivuar në maksimum dhe secili e bënte detyrën me ndërgjegje të lartë shoqërore dhe profesionale. Mësuesit ishin kompetent për lëndët që jepnin, e njihnin atë me themel.

Metoda e dhënies së mëimit ishte rezultative në përvetësimin e lëndës. Ata e zotëronin vëmendjen e nxënësve dhe e kishin nën kontroll klasën, nuk mund të lëvizje apo të flisje e të mos e kishe mendjen në mësim, sepse mësuesi të vëzhgonte e të kontrollonte, të tërhiqte vëmendjen duke të pyetur dhe aktivizuar

gjatë shpjegimit të mëimit. Vetë sistemi, struktura dhe hierarkia e shkollës i siguronte mësuesit e pedagogut një autoritet, jo vetëm nga njohuritë dhe intelektualiteti i tij, por edhe shkolla e shoqëria, vendi që zinte mësuesi ishte i padiskutueshëm dhe autoritar. Kontrolli i njohurive bëhej në mënyrë rigorozë dhe vlerësimi me notë bëhej me përgjegjësi dhe realisht mbi bazën e nivelit të përvetësimit të lëndës. Duke krahasuar me shkollën e ditëve të sotme, unë them se ka disa ndryshime. Në parim dhe në qëllim mund t’i quaj pozitive, por në realitet dhe në zbatim jo. Edhe atëherë bëhej përpjekje për të nxitur të mësuarit kreativë dhe nxënësi të mendonte me mendjen e tij, por brenda kornizës së përmbajtjes së lëndës, brenda njohurive që të kishte dhënë mësuesi, ato që kishte libri e literaturë e rekomanduar. Ndërsa shkolla sot e ka të lirë dhe i jepet nxënësit, përveç literaturës bazë, edhe literaturë e kundërt, me shumë ndryshime e kundërshti dhe nxënësi të diskutojë e të mësojë atë që mendon. Pra, shtrohen probleme edhe që nuk i ka dhënë mësuesi për t’u diskutuar... Kjo e nxit mendimin krijues, vlerësues dhe debatin shkencor, por nuk realizohet me cilësi, sepse roli i mësuesit këtu nuk është të japë konkluzionin, por të diskutojë dhe me nivelin e tij, të tërheqë nxënësit drejt mendimit shkencor, kjo bëhet nga mësues që e zotërojnë lëndën, shkencën që trajtojnë. Por sot kemi mësues që punojnë se nuk ka punë dhe, bën mësim sa të marrë një rrogë. Ndërsa në kohën tonë do të vije në konkluzionet e dhëna, të librit, të mësuesit apo të shoqërisë... Por, duke parë që shumë mësues në ditët e sotme e kanë mësuesinë si punë që nuk kanë ku të shkojnë se mbeten pa punë, apo nuk e “dashurojnë” profesionin e mësuesit dhe nuk e duan librin, nuk studiojnë dhe nuk kanë përgatitje metodike e pedagogjike për mësimdhënie, por rrinë gjithë kohën në lokale. Në këto, kushte alterteksi, më shumë i shpërndan dhe i hallakat mendimet. Dhe së fundi që e detyronte çdo nxënës të mësonte sa më shumë, ishte kërkesa e llogarisë, detyrimi për të studiuar. Atëherë kishte shumë mekanizma, prej të cilëve shigjetoheshin nga kërkesa për të mësuar. I pari ishte mësuesi dhe pas tij në klase ishin shokët, organizata e rinisë se klasës, patronazhi, rinia e shkollës, pastaj vinte linja e komanduesve- edukatorëve, deri te komanda e shkollës. Për ne ishin edhe familjarët që çdo telefonatë e çdo kontakt, të parin merak kishin mësimet dhe disiplinën. Ndërsa për bashkëmoshatarët tanë në shkollat civile, kishin organizatën e rinisë në shkollë, që nuk kishte forcën e asaj të shkollës sonë, organizata e frontit në lagje, qendra e punës, organizata e partisë, që u kërkonte llogari prindërve për mbarëvajtjen e fëmijëve në shkollë.

Ndërsa shkollat e sotme nuk i kanë këto mekanizma e struktura detyruese ndaj nxënësve, për të mësuar. Kush të dojë të mësojë. Ky është edhe ndryshimi i metodës së shkollës perëndimore të sotme nga ajo e metodës së lindjes së atëhershme. Atëherë detyroheshin që deri në shkollën e mesme të mësonin të gjithë, ndërsa në Universitet shkonin ata që mësonin, merrnin nota të mira dhe shumë të mira, ata që kanë talent. Pra nëse do të kesh një brez të mësuar, një popull të arsimuar masivisht në një nivel të caktuar, zbato metodën e detyrimit, metodën e parë, nëse do një elitë të zgjedhur të mësuar zbato metodën perëndimore dhe pjesën tjetër e ke analfabete, ose gjysmë të mësuar.

Skënderbegas ndër vite....



Armë shqiptare të shek. XVII-XVIII

Koburet serme punoheshin nga armëtarët dhe argjendarët shkodranë. Dorezën e kishin si kokë gjarpri, të veshur me pafta argjendi...

Si nga ana funksionale, ashtu edhe nga paraqitja e jashtme prodhimi i armëve tregonte për një nivel të lartë tekniko-mjeshtëror të arritur në vendin tonë.

Shqiptarët e Shkodrës, të Gjakovës dhe të Prizrenit janë mjeshtër të famshëm në punimin e armëve dhe të objekteve të tjera prej metali.

Këto armë janë pishqolla dhe shpata shqiptare e Marko Boçarit në Muzeun e Armëve në Paris. Koburja e përdorur nga Marko Boçari është e tipit gjarpërushe e zbukuruar me argjend, ndërsa shpata është e llojit sabre që përdorej nga kavalëritë europiane të kohës. Koburet serme punoheshin nga armëtarët dhe argjendarët

shkodranë. Dorezën e kishin si kokë gjarpri, të veshur me pafta argjendi. Ato qenë skalitur me motive bimore të stilizuara, në reliev. Tyta dhe çarku bëheshin prej hekuri. Gjatësia e tyre arrinte rreth 59cm, ndërsa kalibri 20 mm. Koburet serme qenë prodhim i viteve 1780-1800. Ato janë përdorur si armë brezi nga suljotët.

Shpata e llojit sabre është një shpatë e kavalerisë së lehtë e përdorur në luftërat e Napoleonit në Europë. Ajo përbëhej nga një dorezë që mbronte dorën, një teh të gjatë më dy presa dhe në fund me një përthyerje të fortë. Marko Boçari ka të ngjarë ta ketë përfutur në kohën kur shërbente në Ishujt Jonianë në regjimentin shqiptar "Gjuajtësit e Orientit" të formuar nga francezët e të përbërë nga shqiptarë.

Regjimenti "Gjuajtësit e Orientit" ishte një regjiment i formuar kryesisht nga suljotët dhe nga shqiptarët e tjerë nga kontinenti

që ofronin shërbimin tradicional të mercenarisë por edhe kishin braktisur vendet e tyre si rezultat i armiqësive që kishin pasur me pushtetin e centralizuar të Ali Pashë Tepelenës.

Në armatimin personal, qoftë të ushtarit të ushtrive feudale shqiptare, apo të çdo banori të armatosur, në shek. XVII-XIX, bënin pjesë: pushka e gjatë (karajfilja) ose pushka e shkurtër (karabina), dy pistoleta (kobure), jatagani, dy vezme, vajmbajtësja, thupra (harbia) dhe brezi i mbajtjes së armëve (silahu). Pushka e gjatë shqiptare, e cila prodhohej e zbukurohej edhe në vend, të cilën tek shumë autorë të tjerë të huaj e gjejmë të emërtuar thjesht “amautka” apo “paftalia”. Kjo armë, në fakt, ka qenë përmirësimi i mëtejshëm i pushkës me fitil, i mushkëtës dhe i arkebuzit, të përdorura në vendin tonë gjatë shek. XV-XVII. Me spikatjen e çarkut me goditje dhe gur stralli, rreth vitit 1630, pushka e gjatë filloi dhe vazhdoi të prodhohej nga armëtarët shqiptarë gjatë shek. XVII-XIX.

Ka të dhëna se Shkodra, si qendër e madhe tregtare dhe zejtare, qendër sanxhaku, vilajeti dhe pashallëku, me tytat e vendit dhe të jashtme, plotësonte jo vetëm nevojat e veta, por me to furnizonte edhe Prizrenin, Gjakovën, Tetovën, Elbasanin, madje ato shiteshin në Delvinë, në Grabovën e Gramshit deri në Bonila të Janinës.

Si nga ana funksionale, ashtu edhe nga paraqitja e jashtme prodhimi i armëve tregonte për një nivel të lartë tekniko-mjeshtëror të arritur në vendin tonë. Shqiptarët e Shkodrës, të Gjakovës dhe të Prizrenit janë mjeshtër të famshëm në punimin e armëve dhe të objekteve të tjera prej metali. Në Ekspozitën



Universale të Parisit (1854), nga objektet që tërhoqën vëmendjen e vizitorëve të huaj ishin edhe koburet shqiptare të Janinës.

Në konkursin e Londrës (1866) po këto armë morën tituj nderi. Në Ekspozitën Universale të Parisit (1867) figuronin armë dhe disa punime filigrani të prodhuara nga punishtet e Prizrenit, të cilat nuk qëndronin më poshtë nga ato të punonjësve më të kualifikuar të Evropës.

Ndërsa në Ekspozitën Universale të Cikagos (1894) ishte vendosur edhe një martinë e punuar me mjeshtëri të hollë nga dora e një armëtari të talentuar nga Tetova.



Armët shqiptare, qëllim, art, identitet

Periudhat më të hershme historike shpeshherë flasin me objekte, monumente dhe artefakte të ngjarjeve apo dhe personave të rëndësishëm historikë. Historisë së Ali Pashë Tepelenës, edhe pse e dokumentuar mirë përmes udhë-përshkrimeve apo tanimë së fundi edhe nga dokumentacioni i botuar, i mungojnë objekte të veçanta të Pashait Tepelenas që do të mund të përshkruanin dhe rrëfenin më mirë epokën kur ai jetoi dhe veproi.

Në këtë drejtim Muzeu i Ali Pashës në ishullin e Janinës, ku ndodhen disa objekte origjinale të epokës së Pashallëkut të Janinës, por edhe të Ali Pashës, është një muze i rëndësishëm i trashëgimisë kulturore, politike e sociale të pranisë së shqiptarëve në Epir.

Në tetor 2015, Muzeu i Ali Pashës në ishullin e Janinës, u pasurua me një pushkë origjinale të Ali Pashë Tepelenës, e cila është e larë në ar dhe ka të gdhendur, emrin e Ali Pashës dhe vitin 1804. Arma kishte qenë në zotërimin e një familjeje të vjetër fisnike nga Janina, që në vitin 1930 ishte shpërngulur në Athinë. Në fund të jetës, zotëria posedues që dëshiroi të mbetet anonim vendosi që t'ia dhuronte Muzeut të Ali Pashës, edhe pse për këtë objekt original mund të kishte marrë oferta nga shumë muze të botës. Arma e ekspozuar tashmë në muzeun e Ali Pashës në Janinë



është e tipit karajfile. Pushka karajfil/e, është një dyfek i gjatë, që mbushej nga gryka dhe shkrehej me strall. Ajo kishte një tytë të gjatë dhe të hollë, shkrehej vetëm një herë dhe pjesën e pasme e kishte në formën e një koni. Kishte një namlli (tytë) 1,20-1.50cm të gjatë, brenda e jashtë të lëmuar dhe një çark që në pamjen e jashtme paraqet një grehës me strall (gurë xixash), përballë ngrehësit ndodhet një masat çeliku dhe nën të ndodhej kupëza e barutit. Qyta që mbështetej në sup të krahut në rast qitjeje quhej dipçik. Namllia mbërthehej në kondak me rripa teneqeje të verdhë. Nëpërmjet tytës dhe drurit futej harbia, e cila është





një shufër hekuri e gjatë sa tyta dhe shërben për të mbushur pushkën. Pushka karajfile përdorej gjerësisht në kohët e vjetra, por sidomos gjatë kohës së pashallëkut të Ali Pashë Tepelenës dhe në momentet e shpërthimit të Revolucionit Grek në vitin 1821. Dyfeku karajfile dallohet për stolisjet e shumta të bronzit por në armët që ishin në zotërim të elitës ushtarake dhe fisnike vendase, zbukurimet i kanë edhe me ar. Dyfeku karajfile ishte me origjinë dhe prodhim venecian dhe u përdor në Perëndim, kryesisht në fillimet e shekullit XVII deri nga mesi i shekullit XVIII. Preferohej për tytat e gjera, të cilat mbusheshin kollaj nga të quajturat “plumba” ose “fishekët”. Megjithëse arma karajfile, ishte e panevojshme në ushtritë e rregullta të Perëndimit, në duart e gjuajtësve dhe nishanllive të Lindjes, ishte shumë e çmuar. Pjesa e saj e pasme, kondaku, përdorej me efikasitet si çomange në raste nevojë. Pushka e krahut (karajfilja) ka qenë një nga llojet më të përdorura të armëve të zjarrit të shqiptarit. Në dallim nga qendrat e tjera të prodhimit të pushkëve, si Berati, Elbasani dhe Janina në qytetin e Shkodrës, janë prodhuar karajfile me shumicë dhe të zbukuruara në teknikën e filigranit. Armët e zbukuruara në argjend, kushtonin shtrenjtë dhe janë përdorur kryesisht prej shtresave të pasura. Në vitin 1875, në Shkodër filloi të prodhohej edhe martina. Motivet e zbukurimit në armët e krahut janë në relief dhe spikasin mbi sipërfaqen e armës. Teknika e realizimit është e ndryshme, si: e derdhjes, e rrahjes dhe e filigranit. Karajfilet shpeshherë janë zbukuruar edhe me sedef. Armët e gjata takohen të zbukuruara në material argjendi, bronz, si dhe thjesht prej llamarine, duke shprehur kështu pozitën ekonomike të

bartësit. Ka raste që këto zbukurime bëheshin edhe prej ari. Fundi i tytës së armës është realizuar me teknikën e derdhjes. Zbukurimet në argjend pasuroheshin edhe me fildish, në formë drejtkëndëshi, me sedef ose me savat. Në zbukurimin e armëve të krahut me material bronz është përdorur zakonisht teknika e rrahjes dhe pak mbipunim, ndërsa në armët me zbukurime të thjeshta llamarine, ku veshja realizonte vetëm ruajtjen e drurit janë përdorur skalitje.

Veshja e karajfileve është realizuar me paftë argjendi të rrahur, vende-vende të skalitur dhe të zbukuruar me copa në formë drejtkëndëshi, shpeshherë sedefi, ndarja e copëzave të të cilit kryhej nëpërmjet një puje. Në faqet anësore të dorezës ishin të vendosura pesë puja të mëdha, ndërsa punimi në paftë realizohej në tërë gjatësinë e saj, që prej fundit të dorezës e deri në majën e tytës. Lidhja e pjesës së drurit me tytën kryhej nëpërmjet fashetave, të cilat në pjesën ballore ishin të zbukuruara me incizime motivesh vegjetale.

Për prejardhjen e emrit të pushkës karajfile ekzistojnë tre versione. Varianti i parë është se e kishte marrë këtë emër ngaqë tyta e saj kishte formë karafil, si trombonet e mëvonshme. Varianti i dytë është se, sipas zakonit të kohës, ngaqë ishte si emblema e dyqanit të armëve një karafil, dhe varianti i tretë, ngaqë kishte të gdhendur, ngjitur me ujkun si shenjë dalluese firmën e prodhuesit nga shtëpia veneciane e Carlo e Figli. (Karli dhe të bijtë), çka ishte shtrembëruar në kariofil në greqisht ose karajfile në shqip. Raste të tilla të shtrembërimit të emrave të firmave prodhuese kanë ekzistuar deri vonë në gjuhën shqipe. Kujtojmë këtu fjalën “mauzer”, për një lloj pushke që përdorte ushtria e rregullt greke, çka

në të vërtetë ishte mauzer, emri i firmës në Gjermani apo fjala “belgjik” sërish për pushkë që korrespondonin me pushkët prodhuar në Belgjikë.

Përveç karafilës së prodhuar në Venecia, kishte dhe armë të këtij tipi prodhuar në vende të tjera të Europës, të quajtura, si karafilë prift dhe karafilë maxhar. Emri i këtyre armëve të krahut mendohet se lidhet me emrin e fabrikantit apo firmës “Carlo Figli”. Ato kishin të njëjtin konstruksion njësoj si kërraballiu por të parat kishin namlliat më të shkurtra dhe me nga një stemë. Karafilë prift kushtonte afro 700-900 grosh. Ai që kishte stemën si kurorë, që ngjasonte me mitrën e një episkopi quhej karafil prift dhe ai që mbante një stemë tjetër që ka ardhur nga Hungaria quhej karafil maxhar.

Ali Pashë Tepelena ishte një adhurues i madh i armëve dhe nga shënimet e udhëtimit që kanë lënë shumë udhëtarë dhe diplomatë që vizituan pashallëkun e Janinës, njohim se ai mbante shumë prej tyre të varura në mur si objekte zbukurimi, si duket në tablonë e Joseph Cartwright (1789-1829), pikturuar në mars 1819 dhe publikuar në 1822 (CARTWRIGHT). Joseph Pukëvili në veprën e vet “Historia e ringjalljes së Greqisë” (1825), kur rrëfen rrethimin e Ali Pashës në Janinë, përmend armët që Pashai Tepelena përdori në një rast kur kundërsulmoi ndaj ushtrisë së Pasho Beut. Avxhibashi i solli armët e nishanit, me famë në Epir, ku shqiptarët luftëtarë u kanë ngritur dhe këngë siç këndonin dikur grekët në shekujt homerikë, mburojës së Akilit. E para armë ishte një pushkë gjatoshë fabrikuar në Versajë, e veshur me damask blu dhe e qëndisur me yje ari, të cilën ia pati dërguar dikur Xhezarit në Shën Gjon të Akrës nganjëllyesi i piramidave. Si vdiq ky pasha, arma i kaloi fatziut Selim III që ia dha si shpërblim trimërie Jusuf Qorr Pashës, tri herë vezir-azem sajë fatit; ky

kur ishte në Negropont në fund të karrierës së tij të gjatë, ia la me testament Ali Tepelenës. Ky ia besoi më pas Akatit të tij gjakatar, Thanas Vajës; njërit prej shatërve i kaloi pastaj një karabinë që ia kishin dhuruar më 1806 me emrin e Napoelonit; në qemerët e shalës vari mushqetën e Karlit XII të Suedisë, armë me vlerë të paçmuar kundrejt personit që e mbante. E kish pas marrë dikur dhuratë nga Gustav Adolfi, në kohën kur ky monark i tradhtuar prej fatit preku tokën në Prevezë, rrugës që pat ndërmarrë për në Varrin e Shenjtë, shtegtim që i dështoi nga një intrigë diplomatike.

Që në fillim kur u bë i njohur dorëzimi i armës u shkrua se mbishkrimi mbi armë është në greqisht, por një vështirësi më e saktë duket se germa S në fjalën Pasha nuk është e alfabetit grek, por një C, që nënkupton germën sigma në greqisht. Prania e kësaj shkronje në pushkë, na shtyn të mendojmë se gdhendësi është një njohës i greqishtes që është shkruar Bibla. Germa C përdoret për në epigrafi Σ dhe në shkrimin majuscule biblik deri në shek. VI dhe përdorimi i saj në tekste në kohën e pashallëkut të Ali pashë Tepelenës do të ishte diçka e pazakontë, por nëpër epigrafi apo vula ajo gjendet edhe gjatë kësaj kohe, çka na shtyn të mendojmë se mjeshtri skalitës dhe zbukurues i pushkës duhet të jetë nga Janina, ku gjuha greke shërbente si pikë kontakti kulturor midis popullsisë të ndryshme që banonin në Pashallëkun e Janinës.

Identifikimi i sa më tepër objekteve që lidhen me historinë e shqiptarëve, qoftë dhe në muze jashtë Shqipërisë, shpjegimi dhe saktësimi i të dhënave rreth tyre, e pasuron kulturën shqiptare dhe i jep mundësi historisë të shkruhet më mirë, për vendin dhe rolin e shqiptarëve në rajon.

Materiali referuar studiuesit, historianit Dorian Koçi.





7 PASURITË E TRASHËGIMISË BOTËRORE

Ky mikrokozmosi i rrallë i historisë së Mesdheut u shpall si Vend i Trashëgimisë Botërore nga UNESCO në vitin 1992 dhe kryeson çdo listë ndërkombëtare të atraksioneve që duhen parë në Shqipëri! Rrënojat 2500-vjeçare të Butrintit, brenda një parku madhështor të gjelbër e me një hapësirë prej 30 km, janë disa nga më të bukurat e të mirëmbajturat në Evropë. Teatri i shekullit III para Krishtit, Tempullit i Eskulapit

(shek.. I – II), perëndisë antike të shëndetit dhe mozaiku me 69 medaljone kishtarë, janë vetëm tre prej kryeveprave të Butrintit. Liqeni i Butrintit, kanali i Vivarit që lidh luginën e Butrintit me detin Jon, Kalaja trekëndore e ndërtuar aty pranë, si dhe pyjet e dendura që veshin gjithë peizazhin janë disa nga arsyet pse Buthrotum-i i lashtë përmendet në poemën epike të Virgjilit, Eneidi!



Gjirokastra

I njohur si një nga vendet e shpallura Trashëgimi Botërore e UNESCO-s, ky qytet i veçantë është ndërtuar në shpatet e pjerrëta, me shtëpitë prej guri që duket sikur janë ngritur mbi njëra-tjetrën. Bashkë me shtëpitë më të famshme në vend, si ajo e fëmijërisë së Ismail Kadaresë apo Enver Hoxhës, por edhe të familjeve të tjera vendase të shquara, në rrugët me kalldrëm të këtij qyteti gjendet pazari dhe kalaja më e vjetër e gjithë Ballkanit.

Qyteti i gurtë njihet jo më pak edhe për panoramën e tij malore, e cila e rrethon Gjirokastrën në tërësi.

Në rrethinat e Gjirokastrës gjenden qytetet e bukura antike të Antigonesë dhe Adrianopolit si edhe disa bukuri të rralla natyrore si Liqeni i Viroit dhe Kanioni i Lengaricës ndër shumë të tjera.



Berat

Është arkitektura e veçantë e qytetit që e ka pozicionuar Beratin si një nga vendet e Trashëgimisë Botërore UNESCO në Shqipëri. I ndarë në dy lagje historike, Mangalemin dhe Goricën, nga lumi Osum, qyteti bashkohet përmes urës së gurtë të Goricës. Ky qytet, një herë e një kohë i quajtur Antipatrea, është i rrethuar nga Tomori dhe Shpiragu, dy nga malet më mitike të Shqipërisë. E kështu Berati zë vend të veçantë dhe në hartën e adhuruesve të natyrës. Ngjitje mali, çiklizëm, rafting apo kayaking janë vetëm disa nga aktivitetet në natyrë që mund të realizoni përreth këtij qyteti. Kalaja mesjetare e Beratit bashkë me Muzeun Kombëtar të Onufrit ofrojnë gjithashtu një udhëtim të rrallë.

Për mos t'u harruar janë edhe Qendra Mesjetare në Berat e kuzhina e famshme e këtij qyteti!



Kodikët e Beratit

Vlen të përmenden këtu këto dorëshkrime me rëndësi të veçantë historike për fillimet e letërsisë biblike të cilat quhen zyrtarisht "Kodiku i Purpurit i Beratit."

Kodiku u regjistrua në listën e veprave më të rëndësishme të njerëzimit, të ashtuquajturën Kujtesën e Botës të UNESCO-s, në vitin 2005. Dy kodikët e Beratit, të botuar në vitin 1887, janë pjesë e grupit të "shtatë kodikëve të purpurit" të shkruar në 13 vende të ndryshme në Europë midis shekullit VI dhe VIII.

Një herë e një kohë dy kodikët, të shkruar në greqishten e lashtë, mbaheshin në kishën e Shën Gjergjit në Berat por sot ata gjenden në Arkivin Kombëtar të Shqipërisë.



Liqeni i Ohrit

Me një thellësi prej 285 m, Liqeni i Ohrit është më i thelli në Ballkan dhe lag në pjesën më të madhe të tij Maqedoninë (Ohër, Strugë), dhe Pogradecin në Shqipëri. "Liqeni i dritës" u shpall pasuri natyrore nga UNESCO në vitin 1980 dhe, që prej korrikut të vitit 2019, është pjesë e listës së UNESCO-s edhe pjesa shqiptare e liqenit.

Plot 4 milionë vjet janë dashur që të krijohet një liqen i

këtyre përmasave dhe gjithçka filloi kur nisi të shembej toka në pjesën perëndimore të Alpeve Dinarike. Sot, ky liqen i bukur i mjellmave është një ekosistem që përmban më shumë se 200 specie, duke përfshirë koranin, peshkun e shijshëm i cili noton vetëm në këto ujëra. Ka shumë vende të bukura, si Pogradeci, fshati Lin apo edhe shumë fshatra të tjerë në këtë zonë të cilët rrethohen nga pamja qetësuese e këtij liqeni e ku kjo e fundit mund të shijohet më së miri.



Lumi i Gashit

Lumi i Gashit është një prej dy rezervateve natyrore shqiptare të përfshirë në listën e trashëgimisë botërore të natyrës të UNESCO-s. Me një sipërfaqe prej 3000 ha, lugina e Gashit gjendet në pellgun e parkut kombëtar të Valbonës, në verilindje të Alpeve, në rrethin e Tropojës, shumë larg zonës së banuar.

Një pjesë e madhe e sipërfaqes së Lumit të Gashit mbulohet me pyje të virgjëra ahu e këto pyje të lashta janë arsyeja pse Shqipëria i është bashkuar 12 vendeve të tjerë në listën e UNESCO-s.

Kjo mrekulli natyrore ruan një nga natyrat më të paprekura në Shqipëri! Në afërsi të Lumit të Gashit ndodhen liqenet akullnajorë të Dobërdolit dhe Sylbicës, të cilët i dhurojnë gjithë zonës një pamje përrallore.



Rrajca

E dyta në listën e trashëgimisë botërore të natyrës të UNESCO-s është Rrajca, pjesë e "European Green Belt" (Brezi i Gjellbër European) të pyjeve të ahut si edhe një prej vendeve të pakta ku gjendet rrëqebulli ballkanik. Pranë zonës së Përrenjasit apo Librazhdit, kjo hapësirë prej 4700 ha, përfshin katër liqene të mahnitshme akullnajorë. Rrajca është pjesë e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanica, i cili është ende relativisht i panjohur sepse ka qenë zonë e ndaluar kufitare gjatë gjysmë shekulli të diktaturës komuniste. Ishte pikërisht kjo mbyllje, që sot përbën dhe një nga asetet më të mëdha të tij, pasi rreth 34 mijë ha sipërfaqe plot me pyje, livadhe e lule shumëgjyreshe, janë tejet të paprekura.

Iso-polifonia

Kjo mënyrë të kënduari e trashëguar në breza, njihet dhe si pasuri e të gjithë botës.

Arti i iso-polifonisë është shpallur nga UNESCO në vitin 2005 si trashëgimi gojore dhe shpirtërore e njerëzimit si edhe përfshihet në 50 atraksionet më tërheqëse të popujve në botë. Edhe poeti i njohur britanik Bajroni, i sugjestionuar nga magjia e iso-polifonisë, i ka dedikuar disa vargje asaj. Koha e shpërbleu këtë trashëgimi të shqiptarëve nga shekulli në shekull, e ajo mbetet një nga më të mbrojturat e të paharruarat në vend. Kjo këngë po aq e qetë sa edhe tronditëse mund të këndohet ose, më saktë, isoja të mbahet, prej dy, tre apo katër zërave, të cilët bashkohen për të arritur harmoninë e vërtetë. Iso-polifonia mbahet si një praktikë komuniste që ka mbërritur në ditët tona që nga periudha e Homerit!



ARTI SHQIPTAR, thesari i vlerë i brigjeve joniane

*Arti në Shqipëri është influencuar nga ngjarjet
e ndryshme gjatë periudhës historike, ka
gjurmë të hershme, dhe vazhdon të zhvillohet*

Gjurmët më të hershme

Fillimet e artit figurativ në truallin e Shqipërisë janë të hershme. Gjurmët e para i përkasin periudhës së neolitit. Nëpërmjet zbulumëve të shumta arkeologjike, në zona të ndryshme të vendit, janë gjetur qindra e mijëra qeramika, terakota, zbukurime në metal etj., që u përkisnin fiseve ilire, paraardhësve të drejtpërdrejtë të shqiptarëve të sotëm.

Prodhimet më të hershme janë të thjeshta, për përdorim praktik, por në to shfaqen edhe vlera artistike si në format zoomorfe të enëve ashtu edhe në dekoracionin, gdhendjet dhe elemente të tjerë. Nga shekulli i gjashtë deri në shekullin e tretë p.e.s. në qeramika vizatohen linja dhe figura gjeometrike, forma ndërtohet me siluete më elegante dhe pasurohet me elementë plastikë. Shumë enë të kësaj periudhe, që ruhen sot në muzetë e Shqipërisë,

kanë vlera të mirëfillta artistike dalluese vendase, që nuk i ndeshim në artin e fqinjëve të tjerë po aq të lashtë si Helenët, Maqedonasit apo Romakët.

Nga ato enë të lashta, të zbukuruara me dekoracione e fraktura plastike, nis rruga e skulpturës në truallin e Shqipërisë, duke u bërë kështu bashkudhëtare me artin e popujve më të hershëm të Evropës.

Tipare më të qarta u dukën sidomos me formimin e qyteteve ilire.

Në qytetet ilire mori zhvillim më të madh skulptura e rrumbullakët si dhe relievi që lidhej me ndërtimin e monumenteve. Në fillim skulptura u zhvillua duke përvetësuar elementë të artit helen, sidomos nga tradita korintike dhe korkyrase.



Më vonë, nga shekulli VI p.e.s., krahas lidhjes me traditën helene, arti ilir fiton veçori të reja, të dallueshme, brenda kuadrit helenistik. Apolonia dhe Durrahu që u bënë qendrat më të rëndësishme të artit në ato vite, kishin mjeshtrit e shquar vendas që gdhendnin dhe skalisnin në një stil me tipare të veçanta kundrejt veprave të importuara prej qytetërimit helen. Në muzeun e sotëm të Durrësit janë ekspozuar disa skulptura të papërfunduara, të gjetura në atë trevë. Ato dëshmojnë për gdhendjet që janë bërë në truallin shqiptar. Janë zbuluar gjithashtu edhe gjurmë të punishteve të hershme të qeramikës në Apoloni dhe Dyrrah. Aty u prodhuan shumë nga enët dhe vazot e bukura të stilit antik që ruhen në muzetë tona. Figurat e pikturuara paraqesin skena të ndryshme mitologjike, pamje nga garat atletike, skena luftimesh etj. Përgjithësisht janë me figura të zeza mbi sfond të kuq (shek.



Galeria e artit ilir

VI-V p.e.s.) dhe me figura të kuqe mbi sfond të zi (shek. IV deri në periudhën helenistike). Pikturimi i figurave është në lëvizje, plot harmoni dhe plasticitet. Në këtë periudhë realizohen edhe shumë statuja të vogla prej bronzit si dhe terakota, ku paraqiten edhe motive laike si dhe figura fëmijësh, barinjsh etj.

Figura me vlerë artistike ndeshim edhe në monedhat e shumta të kësaj periudhe që u realizuan në Apoloni, Dyrrah dhe Orik. Lulëzimi i disa qyteteve ilire dhe i kolonive helene solli një zhvillim të madh të artit që u pasua edhe me shumëllojshmëri formash e teknikash që nga afresket e deri te mozaikët e bukur monokrom dhe polikrom.

Në shekullin I u ngadalësua gjithë ai hov zhvillimi. Pushtimi romak që shkaktoi rënien ekonomike të qyteteve ilire, la gjurmë të dukshme edhe në art. Ndonëse Roma pushtuese u pushtua vetë prej artit helen, përsëri

ndikoi në qytetet ilire me tipare të kulturës së saj provinciale romake. U duk më qartë ndikimi në skulpturë, ku përgjithësisht u ndoq realizmi tipik i kohës, por ndjehet gjithashtu fryma klasike që mbështetet në traditën qindrvjeçare. Qendrat kryesore të veprimtarisë artistike mbeten përsëri Apolonia, Dyrrahu, Butrinti etj.

Në vitet e pushtimit romak prej artit zyrtar shkëputet arti i trevave fshatare, ku pasqyrohen motive nga jeta e përditshme. Me praninë e elementëve të thjeshtë artistikë, që dallojnë nga veprat e mëparshme, si dhe me skalitjen e veshjeve dhe emrave ilire, veprimtaria e këtyre viteve mund të vlerësohet edhe si një qëndresë ndaj asimilimit prej pushtuesve më të fuqishëm të kohës.

Zhvillimi i Mozaikut

Në të njëjtën periudhë me artin e trevave fshatare, në truallin e Shqipërisë arriti zhvillimin më të madh edhe arti i mozaikut. Më i hershmi është gjetur në Durrës. I përket shekullit IV p.e.s. dhe është i punuar me gurë zalli shumëngjyrësh. Ka vlera të rralla artistike që shquhen në gjithë veprimtarinë e kësaj gjinie. Quhet “Bukuroshja e Durrësit” dhe mund të cilësohet si bukuroshja e gjithë mozaikëve që janë zbuluar deri tani në truallin shqiptar, për hijeshinë e figurës dhe mjeshtërinë e realizimit artistik. Në shekullin I, siç përmendëm, u arrit lulëzimi i këtij arti dhe nga gurët e zallit u kalua në kubikë të prerë prej guri, qelqi, mermeri apo balte të pjekur. Mozaikë të tillë janë zbuluar në Apoloni, Dyrrah dhe Butrint. Zhvillimi i mëvonshëm i mozaikëve lidhet kryesisht me monumentet paleokristiane. Pas

Galeria e mozaikëve të gjetur në Durrës



shekullit V motivet e mozaikut ndryshojnë nga modelet e pikturave të hershme, siç është amazonamania në Apoloni, duke u zëvendësuar me figura simetrike që qëndrojnë të shkëputura në sipërfaqe dhe që paraqesin figura kafshësh, shpendësh, pemë frutore, lule e të tjerë simbole të artit paleobizantin. Ruhen edhe sot në gjendje të mirë disa vepra të tilla, siç janë Pagëzorja në Butrint, mozaikët e Linit dhe të Antigonës. Nga gërmimet e deritanishme, është gjetur vetëm një mozaik paretial në Durrës, brenda Amfiteatrit të qytetit, që i përket shekullit VI-VII.

Arti bizantin

Në periudhën e kalimit nga antikiteti i vonë në mesjetën e hershme, skulptura vjen duke u zbehur deri në mohim të plotë nga estetika bizantine, ndërsa arti i pikturës gjeti shprehjen më të lartë artistike. Zhvillim më të madh mori sidomos piktura murale brenda tempujve e krishterë. Kishat u mbushën me afreske dhe ikona që u nënshtroheshin plotësisht kanuneve të rrepta të metropolit. Autorët nuk i firmosnin veprat në atë periudhë, prandaj gjithë ajo veprimtari mbetet ende anonime. Tani në Shqipëri ruhen pak gjurmë nga veprimtaria e më hershme, vetëm disa fragmente. Fatkeqësisht një pjesë e tyre u dëmtua gjatë luftës kundër fesë që u bë në regjimin komunist (1967), duke zhdukur kështu vepra me vlera të rralla për kulturën dhe historinë kombëtare.

Në ato pak fragmente që ruhen ndihen ndikime të stileve perëndimore (Kisha e Rubikut, 1272), si dhe lindore (Vau i Dejës, shek. XIV) të artit bizantin.

Ikonat e shumta si dhe miniaturat në kodikët e Beratit dhe të Vlorës (shek. XI-XIV) janë me vlera artistike dhe i përkasin periudhës së zhvillimit të artit bizantin në Shqipëri.

Në Kishën “Fjetja e Shën Marisë” në Lubonjë të Korçës, ekziston një pikturë murale e Dyfishtë. Kisha është ndërtuar në vitin 1015.


Sipas Theofan Popës “Kjo pikturë, ndonëse mjaft e dëmtuar, paraqet shumë interes për ne, si një nga dokumentet e pikturës tonë më të vjetër, që dokumenton historinë e traditave të arteve figurative të vendit tonë”.

Arti pas bizantin

Gjatë shekullit XVI, ndonëse ende nën pushtimin osman, u realizuan vepra të reja artistike në pikturë, në stilin pas bizantin. Personaliteti më i shquar i kësaj periudhe është Onufri (shekulli XVI). Pikturat e tij dallohen për ngjyra të pasura dhe nuanca dekorative, për realizimin e tipave interesantë me gjendje tragjike, si dhe për futjen e disa elementëve etnografikë kombëtarë që do t'i shohim më qartë edhe te pasardhësit e tij; i biri Nikolla (shek. XVI) si dhe te piktorët e shquar David Selanicas (shek. XVIII), Kostantin Shpataraku (shek. XVIII), dhe te të mëvonshmit vëllezërit Kostandin dhe Athanas Zografi (shek. XVIII), familja Katro (shek. XVIII) etj., që



Piktura murale (afresket)



zbukuruan mjaft kisha në Shqipëri dhe në vendet fqinj. Në Shqipëri është bërë edhe vazhdon të bëhet një punë e kujdesshme për veprat e artit pas bizantin, pasi ato çmohen si pjesë e rëndësishme e trashëgimisë më të pasur kombëtare. Vazhdojnë ende hulumtimet për zbulimin e autorëve të tjerë si dhe restaurimi i veprave të dëmtuara gjatë shekujve. Deri tani janë hapur disa ekspozita me vepra të këtij arti si në Paris (1975), Romë (1985), Nice (1993) etj., të cilat kanë ngjallur interes të

shumtë të specialistët e artit. Ekspozitat janë shoqëruar me botime të ilustruara dhe me komente të shumta nga shtypi i huaj. Veprat më të çmuara të këtij arti ruhen në Muzeun e Artit Mesjetar në Korçë, Muzeun “Onufri” Berat, Muzeun Historik Kombëtar, Galerinë Kombëtare të Arteve si dhe në muze të tjerë në Tiranë dhe qytete të tjerë të vendit. Në Korçë është ngritur edhe një muze privat, i vetmi deri tani në Shqipëri, që ruan një koleksion të pasur me vepra të artit pas bizantin.



Vallja Çame flet vetëm shqip

Ndjenja, mbështjellësja e qenies sonë... misteri dhe burimi i gjithë energjive rrezonuse, e sakaq njeriu përpiqet të shkarkojë energjitë e akumuluar nëpërmjet ngjarjeve të cilat e shoqërojnë ngado.

Vetë natyra jonë humane absorbon e çliron në evenimente dhe ceremoni të ndryshme, gëzime, hare, hidhërime, momente krenarie dhe kuraje, aty ku forca njerëzore dizenjon ndërtimin e karakterit dhe personalitetit të saj. Diku brenda kësaj krijese misterioze zhvillohet një betejë e dualizëm midis ndenjë, pra (shpirtit) dhe trupit (materies). Por ne vërejmë vetëm njërën anë të medaljes, ndërsa ana tjetër është ndërthurja midis dy të kundërtave, pra trupit dhe shpirtit.

Sa bukur lëvizjet harmonizohen mes njëra tjetrës, ku krijojnë efektin marramendës, i cili me fuqinë e tij shpërthen si një vullkan, mimika sinkronizohet me gjithë gjymtyrët, e kështu duken sikur valë deti pasuese së njëra tjetrës...!

Shputat e këmbëve trokasin e përplasen fort mbi tokë, elektrizohen e më pas shkarkojnë energji kumbuese, ashtu njësoj siç shkarkon rrufeja përmbi kreshtat e maleve, kjo pra është vallja jonë e bukur, ngjason me lisat e gjatë e të fortë, e teksa rrënjët e saj zgjaten e kacavirren rreth motit të shkuar e të largët...e moçme, e amshueshme, ashtu si vetë ndjenja jonë.

Mendja brilante dhe syri nuk mund të rrinë pa eksploruar zanafillën e kësaj perle të shoqëruar me lëvizje akrobatike, elegante, që mahnitin vështrimin e kureshtarit.

Veçse banorët e atyre maleve të lartë mund ta përsosnin kaq ëmbël dhe bukur artin e kërcimit... çudi, vërtet çudi...!!! Vallë kush ua mësoi..?!

Disa të dhëna dhe rrëfime na vijnë nga lashtësia, ato rrëfejnë se vallet e njohura e më të spikatura ishin vallet e burrave trima të (Mollosisë) pra malësorët e Epirit të cilët mbështeteshin tek njëri-tjetri si një forcë e vetme në formacionet e tyre ushtarake dhe kështu u jepnin besën njëri-tjetrit, duke shtrënguar duart fort, dhe nëse formacioni çahet apo shthuret, beteja ishte e humbur. Kështu në të njëjtën mënyrë valltaret mbanin fort njëri-tjetrin

duke sjellë në valle elementë të lëvizjeve ushtarake në beteja të ndryshme, ata kërcenin dhe hidhnin valle me shpatat e mprehta si gladiatorë të vërtetë. Përmgjante si një magji, ku pajiseshin me fuqi të mbinatyrshme dhe u shtohet forca përballë armikut, pikërisht këtu fillon gjenealogjia ku merr emrin "VALLE PIRRIKE", e cila daton prej kohës së Pirros Epirit.

Çamëria, vendi ku Çamiko-ja u zhvillua e u përsos, u kurorëzua si princesha e gjithë valleve. Ajo fitoi statusin dhe trajtën e një valleje tradicionale, kërcëhej në mbarë hapësirën shqiptare, por jo vetëm... ajo u mor, apo më saktë u huazua nga grekët, edhe pse kurrë ata nuk arritën përvetësimin e saj. S'ka sesi të ish ndryshe, geni virtuoz çam që e lindi dhe e rriti, normal që do ta ngrinte në majat e lartësisë shpirtërore.... pas shumë e shumë betejave, i bëri ballë dhe i rezistoi kohërave dhe rrebesheve.

Vetëm toka e Çamërisë mund ta marrë këtë sadsifaksion dhe atribut, ndaj kjo valle mbeti kryelartë. Çamiko-ja, pra vallja çame i tregon Greqisë se me forcën që ajo mbart, është avokatja dhe mëkëmbësja e çamëve në vendin helen, këtë fakt ata nuk mundën ta fshijnë apo manipulojnë, sepse emri i saj dëshmon se Çamëria nuk vdes.

Kodi i fshehtë i kësaj valleje zbërthehet dhe merr kuptim vetëm





nën këmbët e shqiptarëve çam, vetëm atyre u ka hije ta kërcejnë këtë valle, dhe a e dini pse...? Sepse grekët e kanë vjedhur dhe mësuar shumë vonë, porse magjia dhe shija që u ka lënë kjo valle i ka bërë ta trajtojnë si (pan-helenike), rrëqethen e drithërohen kur e sodisin, ethet e kësaj valleje kanë pushtuar zemrat e tyre, ata e dashurojnë por nuk mundet ta tjetërsojnë origjinën e saj, të dehur nga pasioni, pohojnë me plot gojën e tyre se po kërcejnë Çamiko..., dhe kur i pyet se kush janë t' zotët dhe fisnikët e vërtetë të këtij margaritari..., ata ngrenë supet lart, sa keq për ta, sa keq... që nuk e dinë apo ndoshta e dinë dhe nuk u vjen përshtat ta pranojnë!

Vallja Çame flet vetëm shqip, gluha e saj është gluha e Homerit, ajo zbukurohet si një nuse në këmbët e heronjve të Trojës, fustanella është mbulesa dhe xhevahiri i saj. Vallja e lashtë Pirrike (Çamiko-ja), fustanella ilire, mitet dhe hyjnitë pellazgjikë kolonizuan mbarë Greqinë, dhe tashmë gjenden të folklorizuara dhe pan helenike... e pse do të thoni ju...?, sepse e bukura i pëlqen edhe djallit...!

Ja se si shprehen studiues, udhëtarë e kalimtarë të ndryshëm kur ndeshen me tokën epirotase, pra me tokën çame... ata u shtangën për vlerën emocionale dhe estetike të valles, për harmonizimin midis vokalit, instrumentit dhe lëvizjeve akrobatike të shoqëruara në këtë valle magjike.

1 - Autori André Barret, në librin e tij (vëzhgim rreth Greqisë) pohon se vallja Çame - Çamiko, është një valle heroike, e cila e ka origjinën e saj nga Epiri (Thesprotia).

2 - Qendra studimore e ekistikës, konkludonte në një simpozium të saj në Athinë, se ka një paralelizëm dhe një ngjashmëri shumë të madhe midis valles Çame dhe lëvizjeve të valleve Skoceze, po pse pikërisht fustanella Kelte (Skoceze) dhe vallja ka një ngjashmëri kaq të madhe...?! Sepse legjionet romake në Angli, kishin shumë ushtar iliro-epirot, të cilët ngelën atje dhe

lanë zakonet dhe veshjet e tyre.

3 - Në librin "Greqia" Paul Hellander, citohet dinjiteti dhe krenaria e valles çame...

"Vallja, shpesh herë karakterizon nuancat dhe natyrën e atyre që e kërcejnë, dhe s'ka si të ndodhë ndryshe dhe në Epir, aty ku kërcehet vallja (Çamiko) me një dinjitet dhe burrëri, thua sikur u ngjan maleve që ka përreth për nga madhështia..."

4 - Tullia Magrini, ish-profesor i antropologjisë në fakultetin e Bolonjës:

"Natyra e valles Greke virtuozë (solo), të tilla si (squats) apo hapa, të mbështetura nga personi i dytë në linjë, i ndeshim tek vallja çamiko (tsamiko), emri i së cilës buron nga shqiptarët-çamë..."

5 - Ndërsa autorja Rozana Mozaki shprehet kështu për çamët në librin e saj "Vallet greke për amerikanët": "Në kohët e sotme vallja çame është kthyer pan-helenike, ajo kërcehet si nga meshkujt ashtu edhe nga femrat, emri i kësaj valleje vjen nga Çamët, banorët që kanë jetuar në rajonin e Çamërisë pra në Epir. Ajo po ashtu quhet edhe kleftiko, sepse është kërcyer edhe nga kaçakët apo luftëtarët suljotë, të cilët kontribuan në çlirimin e Greqisë më 1821..."

6 - Nigel Allenby Jaffé në librin e tij "Folk dance of Europe" (Valle popullore të Evropës) pohon se vallja Çamiko buron nga zona e (Tsamidon-Tsamouria) pra nga Çamëria dhe u bë një valle shumë e preferuar për kaçakët dhe luftëtarët e maleve, po kështu edhe vallja legjendare e Osman Takës, ku vendlindja dhe djepi i saj ndodhet në tokën arbërore çame....

Sa më shumë vite e mote do të kalojnë aq shumë kjo valle do të mbesë, ajo është tharmi dhe palca e identitetit tonë, ky identitet i pavdekshëm i cili u ngec si një halë në fyt manipulatorëve të historisë.

Ndaj o shqiptar i mirë mësojua vallen e shqipeve gjeneratave që vijnë pas, se kjo valle na mban kokën lart e na burrëron...!

Jeta përtej dallgëve, udhëtimi biblik i shqiptarëve



32 vjet nga eksodi i shqiptarëve me anijen Vlora, brenda së cilës ndodheshin 20 mijë shqiptarë të përvuajtur të cilët trokitën në dyert e Italisë, duke i dhënë Evropës imazhet e para të një shoqërie jo vetëm të varfër por dhe të izoluar nga bota prej regjimit komunist. Për këdo që e ka jetuar këtë kalvar tranzicioni është më e kuptueshme se sa kanë ndryshuar gjërat që nga ajo kohë. Ndryshime që më së shumti i dedikohen asaj furie njerëzore që vinte nga mungesa e shpresës dhe që e kërkonte të ardhmen tek Evropa, jo thjesht si imazh begatie e mirëqenieje, por dhe si imazh i demokracisë së munduar për 50 vitesh.

Udhëtimi i 20 mijë shqiptarëve që kishin mbushur anijen “Vlora” në Durrës, i ngjante një udhëtimi biblik drejt tokës së premtuar, të cilën e ndeshën në brigjet e Barit, prej nga u mirëpritën nga një popull fisnik si italianët e që u hapi dyert dhe zemrën. Kjo dashamirësi u dëshmuar së pari nga Enrico Dalfino, kryebashkiakut të Barit në vitet 90-91, i cili zgjodhi të mirëpriste eksodin edhe pse kundërshtoi qeverinë.

Nisja e anijes Vlora drejt Puglias ishte vala e dytë e eksodit të shqiptarëve para 32 vitesh.

Vala e parë ishte ajo e ambasadave, ndërsa regjimi komunist ishte ende në këmbë. Këto ishin rrugëtimet e para të shqiptarëve drejt Evropës pas gati 50 vitesh izolimi. Ishte një rrugëtim shprese, se dhe vendi i tyre do të bëhej: me punë dhe me djersë, me dinjitet dhe drejtësi, me liri dhe të drejta, me mundësi për ta krijuar të ardhmen këtu.

Ndërsa hedhim sytë pas, nga gjithë ato energji njerëzore të ndrydhura e që shpërthyen në atë eksod masiv, shohim se ende ka shumë për të bërë që ato aspirata të bëhen realitet i pakthyesëm.

Më 8 gusht 1991, anija shqiptare e mallrave “Vlora”, mbërriti në portin e Barit, e tej mbushur me refugjatë nga Shqipëria. Emigrantët fillimisht u mbyllën në stadiumin e vjetër “Stadio della Vittoria”, dhe më pas u riadhesuan për në Shqipëri.

Anija “Vlora”, mbërrin nga Durrësi, gati pa karburant, mundohet të hedhe spirancën në Brindisi, por nuk pranohet dhe drejtohet për në Bari.

Në bord ka edhe njerëz të armatosur, përveç emigrantëve në arrati nga 45 vjet regjimi komunist, tanimë i shkërmoqur, ka dhe gra e fëmijë.

Anija kishte mbërritur në port nga Kuba, plot me sheqer, dhe shkarkimi i saj nuk kishte përfunduar akoma, kur e pa që po afrohej ky det njerëzish.

Sa njerëz ndodheshin në bord?

Gazetat e 9 gushtit 1991 shkruanin se bëhej fjalë për 11 000 persona, ndërsa në kronikat e sotme flitet për 20.000. Një gjë është e sigurt, ishte një mori njerëzish që nuk po kuptonin as vetë se çfarë po bënin dhe se çfarë i priste në anën tjetër për të cilën kishin ëndërruar shumë.

Në orën 11:30 lumi i njerëzve ndodhet në platformë. Kërkojnë bukë dhe ujë. Policia i drejton të gjithë në stadiumin e vjetër të futbollit, në pritje të vendimeve.

Kryeministri, Giulio Andreotti, dikton nga Roma këtë deklaratë: “Nuk jemi absolutisht në gjendje të mirëpresim

“Udhëtimi i 20 mijë shqiptarëve që kishin mbushur anijen “Vlora” në Durrës, i ngjante një udhëtimi biblik drejt tokës së premtuar, të cilën e ndeshën në brigjet e Barit, prej nga u mirëpritën nga një popull fisnik si italianët e që u hapi dyert dhe zemrën. Kjo dashamirësi u dëshmuar së pari nga Enrico Dalfino, kryebashkiakut të Barit në vitet 90-91, i cili zgjodhi të mirëpriste eksodin edhe pse kundërshtoi qeverinë.”

shqiptarët që po dynden në brigjet italiane dhe vetë qeveria e Tiranës është dakord me ne, që ata duhet të riadhesohen në vendin e tyre”. Në stadium plas revolta.

Më të rinjtë shkulin pllakat e shkallëve dhe hedhin gurë kundër policisë. Përleshje të ashpra zgjatën tre ditë, më të dhunshmet qenë ato të së dielës, më 11 gusht, me 40 të plagosur mes policisë dhe një numër i pacaktuar mes protestuesve.

Shqiptarëve u jepet ushqimi dhe uji nga qielli, me thasë të hedhur nga helikopterët.

Ndërkohë organizohet operacioni më i madh i riadhesimit në historinë e Republikës së Italisë. Në të marrin pjesë 11 avionë ushtarakë C130 dhe G222, së bashku me tre “Super80” të “Alitalia-s” dhe motobarka si “Tiepolo”, “Palladio” dhe “Tiziano”,

Në fillim shumë prej tyre nuk e dinin se po i kthenin. Të riadhesuarit qenë 17 mijë e 400, më shumë nga pasagjerët e Vlorës (e përsërisim sipas shifrave të asaj kohe), sepse u riadhesuan edhe imigrantë që kishin mbërritur me anije të tjera. Mbetën në Itali 1 500 vetë që kishin paraqitur kërkesë për strehim politik.

Gianni De Michelis, ministër i Punëve të Jashtme, fluturoi për në Tiranë për të ilustruar një plan italian ndihme: 90 miliardë lireta për ushqime, 60 miliardë për industrinë dhe furnizimet për hapjen në tetor të shkollave, dhe bashkëpunim në rendin publik për të parandaluar ikje të tjera.

Në Parlament pati polemika mbi metodat e rrepta, madje brutale, të këtij operacioni. Shumë më pak mbi thelbin e tij. Në një konferencë shtypi deputetët e PDS (Partia Demokratike Italiane e sotme) “megjithëse kuptojmë vendimin e dhimbshëm për riadhesimin e refugjatëve në Shqipëri”, ata denoncuan “zgjedhjen e pamenduar për të mos respektuar të drejtat e njeriut, duke u mohuar atyre një asistencë të denjë.”

Megjithatë, në ato vite, Italia në përgjithësi dhe Puglia në veçanti dhanë prova shumë të mëdha mikpritjeje.

Më pas mes Romës dhe Tiranës do të lidhet një marrëveshje model, e cila arriti të lehtësojë emigracionin e rregullt të shumë shqiptarëve.

Por historia e anijes “Vlora”, e 8 gushtit të vitit 1991, do të mbetet ëndrra e frikshme e zhegut të gushtit të largët të 32 viteve më parë.

Përfundimi i “aventurës shqiptare”

(Debat në strukturat italiane për Luftën e Vlorës të vitit 1920)



Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj

Presidenti Uillon, i nervozuar nga amendamenti

Gjatë Luftës së Parë Botërore dhe me mbarimin e saj, shteti italian bëri përpjekje të shumta në rrugën diplomatike, duke përdorur forma nga më të ndryshmet për të arritur objektivat e tij. Situata e favorshme dukej se po krijohesh me miratimin, më 9 dhjetor 1919, nga përfaqësuesit e Anglisë, Francës dhe të SHBA-së të një memorandumit, sipas të cilit i njëjti qeverisë italiane sovraniteti i plotë mbi Vlorën dhe krahinat e saj, si dhe mandati mbi shtetin shqiptar të cinguar. Por entuziazmi për këtë fitore nuk zgjati shumë. Dy muaj më vonë, presidenti Uillon i nervozuar nga ky amendament, i dërgoi një notë Londrës në të cilën, me insistim protestonte ndaj këtij copëtimi të ri të Shqipërisë që bëhej pa dijeninë dhe miratimin e qeverisë amerikane dhe në kundërshtim me protestat energjike të popullit shqiptar. Kjo ndërhyrje e vendosur e presidentit Uillon, ndikoi pozitivisht në zgjidhjen e problemit të kufijve të shtetit shqiptar. Lufta pati rëndësi të veçantë për ruajtjen e pavarësisë të Atdheut dhe ecurinë e mëtejshme të tij. Shqipëria e vendosur në pozicionin kyç e shtrirë në brigjet lindore të Adriatikut, e ndodhur afër Italisë, e në kryqëzimin e rrugëve midis lindjes dhe perëndimit, lejonte të ndërmerreshin operacione ushtarake në të dy krahët. Këto vlera strategjike që paraqiste Shqipëria përbënin faktorët themelorë të vëmendjes e të synimeve të udhëheqjes politiko-ushtarake të Italisë ndaj Shqipërisë.

Zbarkimi i trupave italiane në Vlorë në fillimet e Luftës së Parë Botërore ka shkaktuar debate ndërmjet ushtarakëve dhe personaliteteve të Ministrisë së Jashtme, nisur nga vlerësime të ndryshme strategjike. Gjenerali Kodovra, shef i Shtabit Madhor, mbështetur kryesisht në vlerësimet strategjike, dërgimin e trupave e quante një ndërmarrje të rrezikshme e me pasoja shkatërrimtare. Kjo për arsye të terrenit të vështirë dhe të përvojës e mjeshtërisë të shqiptarëve në luftën guerile. “Populli shqiptar, - theksonte Kodovra, - është luftëtar dhe mjeshtër në luftën guerile”. Vlora ishte patjetër në vëmendjen e të dy palëve, por për gjeneralin Kodovra mjaftonte të mbahej gjiri i Vlorës, detyrë kjo që mund të kryhej me anën e flotës e të aviacionit dhe të lehtësohej edhe nga zotërimi i ishullit të Sazanit. Përkundrazi në qëndrimin e ministrit të Jashtëm Sonino, mbizotëronin kryesisht vlerësimet politike.

Fillimi i “aventurës shqiptare”

Zotërimi i Vlorës dhe i krahinës së saj, veçse si një bazë e rëndësishme strategjike, sipas ministrit të Jashtëm, krijonin

terenin e përshtatshëm për arritjen e protektoratit të Shqipërisë si një objektivi i rëndësishëm i politikës italiane. Ndërkaq gjenerali Kodovra këmbëngul në bindjen e tij se ekspedita e Shqipërisë përbënte një defekt të qartë në konceptin e drejtimit ushtarak, si dhe fillimin e aventurës shqiptare. Qëllimi politik shpjegon gjenerali, që të vihet në jetë është i varur nga mundësitë ushtarake. Direktivat politike duhet të jenë të tilla që të mund të zbatohen ushtarakisht, ato duhet të jenë në përpjesëtim të drejtë me mjetet. Rrjedha e ngjarjeve dhe disfata e italianëve në Vlorë ishin një provë e pikëpamjeve të Kodovrës. Me dështimin e rrugëve diplomatike, Ministria e Jashtme italiane, duke u mbështetur në vlerat dhe dobinë e Vlorës, mbajti një qëndrim qartësisht të vendosur për pushtimin e saj nëpërmjet luftës së armatosur, pavarësisht nga vështirësitë. Ndërkohë, fillimi i luftës e vuri shtetin italian përballë situatash të paparashikuara. Plan i kryengritjes për fazën e parë të luftës u hartua nga komisioni ushtarak, organ pranë Komitetit të “Mbrotjes Kombëtare” i përbërë kryesisht nga oficerë shqiptarë që kishin mbaruar Akademitë Ushtarake. Në hartimin e planit, komisioni ushtarak mbante parasysh se lufta do të zhvillohej nga një ushtri kryengritëse e organizuar me shpejtësi, e armatosur keq, por me moral të lartë dhe e vendosur ta çonte deri në fund misionin e saj, lufta zhvillohej kundër një armiku të fuqishëm, të organizuar e të përgatitur ushtarakisht, të armatosur me teknikën luftarake më moderne të kohës. Komisioni ushtarak mbante parasysh gjithashtu se gjendja morale e ushtrisë italiane ishte e dobët, e se do të luftonte në një vend të huaj, në një territor të ashpër malor e pjesërisht kodrinor. Mbrotja e armikut, edhe pse ishte e fortifikuar, ajo mbështetej në garnizone që lejonte boshllëqe e ndërhapësira të theksuara midis tyre.

Lufta e Vlorës, luftë e shpejtë dhe sulmuese

Duke vlerësuar drejt tërësitë e këtyre kushteve, në themel të Luftës së Vlorës ishte lufta e shpejtë, sulmuese, që do të zhvillohej brenda një kohe të shkurtër e me karakter vendimtar. Efektshmëria e këtij plani u vlerësua gjerësisht, madje edhe nga autorë të huaj, studiuesi italian Beneditto Caganilia, në vlerësimin e tij për planin shkruan: “...ky plan revolucionar (kryengritës) në pamjen e tij paraqet kriterin më të mirë taktik të momentit”. Natën e 5 qershorit forcat kryengritëse kaluan në sulm të menjëhershëm e të befasishtë kundër garnizoneve italiane të shpërndara në trekëndëshin Llogora-Drashovicë-Tepelenë.

Luftimet kundër garnizoneve të armikut u zhvilluan me një teknikë tepër primitive. Forcat kryengritëse shfrytëzuan me mjeshtëri terrenin dhe sulmuan natën, pozicionet e nisjes u zgjedhën në lartësi dominuese, sulmi natën ndikoi në rritjen e befasisë së goditjes edhe në kushte kur forcat italiane ishin vënë në gatishmëri luftarake. Ndryshe nga dinamizmi dhe shpirti i lartë sulmues që karakterizonte veprimet luftarake të forcave kryengritëse, taktika mbrojtëse e italianëve u karakterizua nga pasiviteti i theksuar. Garnizonet italiane që ndodheshin jashtë Vlorës, nuk bënë asnjë përpjekje për të vendosur bashkëveprimin midis tyre. Po kështu, komanda e trupave italiane në Vlorë, u paralizua nga forca goditëse e trupave kryengritëse.



Mbështetur në rezultatet e arritura, forcat kryengritëse mbyllën perimetrin e rrethimit përqark Vlorës dhe përgatiteshin për të kaluar më 11 qershor në mësymje të përgjithshme. Ndërkohë qeveria italiane, duke e vlerësuar Vlorën, si një objekt me rëndësi të madhe strategjike, insistoi për mbajtjen me çdo kusht të saj, qoftë edhe vetëm të qytetit me bazën e saj detare, Pashalimanin. Në telegramin që ministri i Jashtëm i Italisë i dërgoi më 12 qershor komisionit të lartë italian në Shqipëri thuhet: "...ju e dini mirë pikëpamjen e qeverisë (Italiane) rreth Vlorës, kjo bazë detare përbën interesin tonë themelor në Adriatik, prandaj kësaj duhet t'i nënshtrohet politika shqiptare dhe jo anasjelltas". Mbajtja e Vlorës i jepte mundësi shtetit italian ta përdorte "si një mbështetje ku të ngrinte njërin nga kulmet e portës së Otrantos dhe në të ardhmen të vazhonte përpjekjet për të arritur protektoratin e vendit. Pra çlirimi i Vlorës si qëllimi final i kryengritjes së armatosur ishte kusht i domosdoshëm për të siguruar pavarësinë e vendit. Kujdes të veçantë i kushtoi komanda italiane fuqizimit të mëtejshëm të mbrojtjes së Vlorës. U intensifikuan punimet mbrojtëse rreth qytetit. Po mbylleshin të gjitha drejtimet me pengesa prej telash me gjemba e mina, ndërtoheshin fortifikata të reja për vendosjen e artilerisë dhe të mitralozave. Në ullishtet e Vlorës u vendosën autobllinda në prita të maskuara. Po kështu, më 11 qershor, zbarkuan me shpejtësi nga Italia reparte arditësh, përforcime me municione, armatime, autobllinda etj.

Plani i mësymjes së përgjithshme të datës 11 qershor parashikonte zhvillimin e saj në mënyrë koncentrike nga tre drejtime, me qëllim që të shpërthehej mbrojtja e fortifikuar e armikut, të copëtoheshin forcat e tij, të kapej vargu i kodrave që sundonte Vlora dhe veriu, lindja e juglindja dhe nga pozita dominuese të vijohej mësymja e vrullshme në drejtim të qytetit. Datë e 11 qershorit forcat kryengritëse kaluan në mësymje të menjëhershme gjatë gjithë perimetrit të rrethimit. Duke patur nismën taktike në duart e tyre e nëpërmjet manovrimesh, përparonin vazhdimisht. Gjatë dy ditë luftimesh të ashpra, të gjitha grupimet mundën të zënë pozicione të përshtatshme, ndërsa një grup luftëtarësh të kryesuar nga Selam Musai mbërritën rreth 100 m afër shtëpive të para të qytetit. Ndërkohë fillojnë nga veprimet luftarake edhe qytetarë të Vlorës, të cilët me goditje pas shpine shkaktojnë çrregullime e panik në forcat italiane. Sulmi i përgjithshëm i 11 qershorit, megjithëse nuk çoi në çlirimin e Vlorës, përbën në tërësi një fitore të rëndësishme për forcat kryengritëse. Sulmi tregoi se edhe në kushtet e një lufte frontale, forcat kryengritëse i kishin të gjitha mundësitë të shpërthenin mbrojtjen e fortifikuar të armikut. Arritja e objektivit

kryesor strategjik u pengua vetëm nga epërsia e theksuar e armikut në forca e sidomos në teknikë luftarake.

Sulme të befasishme dhe presion psikologjik Gjatë periudhës 40-ditëshe, ndërmjet mësymjes së parë dhe të dytë të përgjithshme 11 qershor - 23 korrik, forcat kryengritëse me grupe të vogla, kryesisht gjatë natës kryenin sulme të befasishme mbi përqendrimet e trupave italiane, duke synuar të ushtronin ndaj tyre presion psikologjik, panik e t'i mbanin në gjendje alarmi të përhershëm. Duket qartë se Lufta e Vlorës kishte marrë tipare të ndërthurjes së veprimeve guerile me luftimin frontal. Edhe pse po shkonte drejt disfatës, qeveria italiane me kokëfortësi kërkonte të mbante Vlorën. Si rrjedhojë, projekti që u paraqit nga pala italiane në

bisedimet e zhvilluara në ditët e para të korrikut, u hodh poshtë nga qeveria shqiptare. Pasi dështoi në përpjekjet e saj për të siguruar koncesione në rrugën e bisedimeve, qeveria italiane kaloi përsëri në provokime e kërcënime. Urdhrin e datës të 17 korrikut komanda italiane e pushtimit e mbyllte me fjalët provokuese: "jemi dhe do të qëndrojmë në Vlorë". Në mësymjen e 23 korrikut forcat shqiptare kaluan në mësymje të befasishme. Ky sulm për italianët ishte tërësisht i papritur. Pas pak orësh luftime të ashpra, në agimin e 23 korrikut forcat kryengritëse ishin pykëzuar thellë në mbrojtjen e kundërshtarit. Vlora ishte mbyllur në një unazë të zjarrit. Kur fitorja ishte siguruar plotësisht, forcat kryengritëse me qëllim që të shmangnin shkatërrimin e qytetit nga goditjet e artilerisë së anijeve, morën urdhër të tërhiqeshin në pozicionet e nisjes.

Sukseset e arritura në mësymjen e përgjithshme të datës 23 korrik e detyruan komandën italiane të pranonte disfatën në fushën e luftës dhe kundër vullnetit të saj të heqë dorë nga kërkesa për të qëndruar në Vlorë. Komanda italiane duke mos e vlerësuar drejt zhvillimin e luftimeve, synonte ta paraqiste mësymjen e 23 korrikut si një dështim për forcat kryengritëse, duke pretenduar, siç shkruan gjeneral Piaçentini, se "forca e armëve nuk mund të përbënte për qeverinë e Tiranës letrën fituese". Përballemi këtu me një konkluzion tërësisht të gabuar me një falsifikim të realitetit. Pala që dështoi në përdorimin e armëve ishte pala italiane, që u detyrua të tërhiqet nga përdorimi i tyre për të arritur objektivin e saj strategjik. Ishte lufta e armatosur e forcave kryengritëse që e detyroi qeverinë italiane të hynte në bisedime, të cilat përfundonin me tërheqjen e trupave italiane nga Shqipëria. Një gjykim realist na jep diplomati italian konti Guetano Munzeni, sekretar i përgjithshëm në ministrinë e Punëve të Jashtme italiane, i cili, më 26 korrik, mbërriti në Shqipëri për të përfunduar bisedimet që ishin ndërprerë. Munzeni konstaton gjendjen tepër të rëndë të trupave italiane në Shqipëri. Munzeni telegrafon në Romë se: "Situata jonë është shumë më e disfavorshme, sa ç' mund ta gjykoja unë nga Italia" dhe kërkon për të përfunduar një herë e mirë gjendja e dhimbshme. Përbën ky vlerësim një fakt tjetër bindës për fitoren që kishin arritur forcat kryengritëse shqiptare në Vlorë, fitore e rrënjësore thellë në ndërgjegjen e kombit shqiptar. Përfundoi kështu "aventura shqiptare", të cilën gjeneral Kodovra e kishte paralajmëruar qysh në fillimet e saj. Qeveria dhe Ministria e Jashtme Italiane në rrjedhën e luftës u bindën për vlerësimet e drejta të gjeneralit, përjetuan me dhimbje gabimet e tyre.

